




AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
REGULATORNI AUTORITET ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE
REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2021



AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE



Rruga Bedri Pejani, Nr. 23 - 10000 Prishtinë



info@arkep-rks.org



+383 38 212 345

HYRJJE

Të nderuar Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar lexues,

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), në zbatim të nenit 11, paragrafit 2) dhe 3) të Ligjit Nr. 04/L-109, për Komunikimet Elektronike dhe nenit 9, paragrafit 1), të Ligjit Nr. 06 /L-038, për Shërbimet Postare, i paraqet autoritetit të vet themelues, Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim, shqyrtim dhe miratim raportin e rregullt vjetor të punës për vitin 2021, të shoqëruar me raportin financiar.

Raportit vjetor i ARKEP si institucion i pavarur, ofron një panoramë të qartë në sektorët e komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare. Synimi kryesor mbetet vënia në perspektivë e dinamikave sektoriale, dhe impaktit të veprimtarisë në këta sektorë mbi përdoruesit, si dhe llogaridhënia për përmbushjen e detyrave institucionale që rrjedhin nga korniza rregullative në fuqi.

Aktivitetet e ARKEP, gjatë vitit 2021, janë përqendruar kryesisht në arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike për rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, e që si qëllim kryesor ka sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në nivel të ofrimit të shërbimeve si një nga parakushtet thelbësore për nxitjen e investimeve, sigurimin e cilësisë së duhur të shërbimeve me çmime sa më të arsyeshme dhe oferta konkurruese për përdoruesit fundor (*konsumatorët*) duke siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Për me tepër gjatë vitit 2021 janë ndërmarr edhe një sërë nismash nga ARKEP.

Me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit me Komisionin e Pavarur për Media (KPM), është arritur lirimi i brezit 800 MHz, ku prej datës; 01 Janar 2022 ky brez është liruar nga kanalet e transmetimit radio-difuzive. Këto kapacitete tani e tujte do të përdoren ekskluzivisht nga rrjetet mobile të gjeneratës së re.

Rishikimi i dokumentit për hapjene brezeve frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike të shërbimeve IMT (MFCN & 5G), është një aktivitet shumë i rëndësishëm, ku është filluar përgatitja e Planit për Hapjen e Brezeve me vlerë të posaçme ekonomike për shërbime mobile IMT & IMT 2020” si dhe dokumentit për planifikimin e brezit 3400- 3800 MHz. Dhënia e këtyre brezeve do të ketë rëndësi të veçantë sepse me këtë proces do t’u mundësohet operatorëve avancimi i shërbimeve të lëvizshme mobile me mundësi zbatimi të teknologjive të reja të teknologjisë 5G. Po ashtu është filluar me Rishikimin e Planit Kombëtar të Radio Frekuencave për Kosovë (PKRF) me tabelën e shpërndarjes dhe aplikimit të radio frekuencave në brezin 8.3 kHz deri 3000 GHz, në Republikën e Kosovës;

Implementimi i marrëveshjes së roamingut me vendet e Ballkanin Perëndimor -BP, RLAH (*Rome Like at Home*) ku sipas kësaj marrëveshjeje, nga data 01 Korrik 2021, parapaguesit gjatë qëndrimit në njërin

nga vendet e BP, nuk do të paguajnë asnjë tarifë shtesë për shërbimet e rregulluara të roamingut, thirrjet e realizuara ose pranuar, SMS të dërguar dhe të dhëna/Data të shfrytëzuara, përveç tarifës e cila aplikohet në Republikën e Kosovës RLAH. Kjo do të thotë se ofruesit e shërbimit roaming nuk mund të aplikojnë asnjë tarifë shtesë direkte ose indirekte për të mundësuar roaming-un në shtetet e BP.

Implementimi i projektit Sistemi Nacional për Monitorimin e Spektrit Frekuencore (SNMS), i cili është duke u implementuar me ndihmën e Ministrisë së Ekonomisë (ME) në kuadër të projektit 'Kosovo Digital Economy' (KODE) dhe mbështetur financiarisht nga Banka Botërore, ku bazuar në planin e implementimit të projektit, gjatë vitit 2021 është arritur të ngritën me sukses tri Stacione Fikse Monitoruese në lokacionet: Prishtinë - Zllatar, Prizren - Parku ITP, Mitrovicë - Lushtë si dhe Furnizimi me një Stacion Mobil Monitorues (*Mobile Monitoring Station-MMS*) dhe Furnizimi me një stacion Mobil Transportues (*Transportable Monitoring Station-TMS*).

Me qëllim të përshtatjes me zhvillimet e fundit teknologjike dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në aspektin e implementimit, është iniciuar procesi i rishikimit të Rregullores për Bartshmerinë e numrave. Me këtë projekt synohet rritja e konkurrencës në treg duke iu mundësuar konsumatorëve ruajtjen e numrit gjatë ndërrimit të ofruesve të shërbimeve të telefonisë fikse dhe mobile.

Është iniciuar procedura e analizës së dy tregjeve të komunikimeve elektronike, përkatësisht tregut i qasjes në nivel lokal me shumicë të ofruar në lokacion fikse (*tregu 3a*) dhe tregu i qasjes në nivel qendror me shumicë, i ofruar në lokacione fikse për produktet e tregut masiv (*tregu 3b*). Si rezultat janë përpiluar draft-raportet për tregjet përkatëse, të cilat pas shqyrtimit do të publikohen për konsultim publik.

Për sa i përket performancës dhe transparencës në funksionimin e brendshëm të institucionit, është iniciuar projekti i Digitalizimit të ARKEP (*Digit-ARKEP*), i cili ka për qëllim digjitalizimin e shërbimeve të ofruara të ARKEP për konsumatorët, operatorët, si dhe për palët e tjera të interesit, si publikun e gjerë vendim-marrësit dhe akterët e tjerë relevant në sektorin e komunikimeve elektronike dhe postare.

Që nga Janari i vitit 2019, ARKEP ka qenë pjesëmarrës aktiv në takimet e Trupit të Rregullatorëve Evropian për Komunikimet Elektronike (BEREC), si në nivelin teknik ashtu edhe në atë të Bordit të Rregullatorëve.

Në këtë kuadër, gjatë vitit raportues pra 2021, janë hartuar dhe miratuar një mori aktesh normative me karakter rregullator dhe me efekte strukturore në tregjet e rregulluara dhe të mbikëqyrura nga Autoriteti, detajet për të cilat gjenden në raportin e mëposhtëm.

Viti 2021, ka shënuar trende pozitive të zhvillimit në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare në Republikën e Kosovës, si për nga rritja e vëllimit të trafikut, të hyrat dhe po ashtu edhe për nga investimet në sektor.

Në fund të vitit 2021, numri i përdoruesve të telefonisë mobile shënon shifrën prej; 1,777,859, që krahasuar me fundin e vitit 2020, ka shënuar një rënie prej; 210,862, përdoruesish ose shprehur në përqindje paraqet një rënie prej; 10.6 %. Përkundër rënies së numrit të përdoruesve, tregu i telefonisë mobile ka shënuar rritje të trafikut të origjinuar nga rrjetet mobile prej 6.3%, përkatësisht rritje me të theksuar në trafikun e terminuar prej 28%, e cila kryesisht vjen si rezultat i rritjes përdorimit të shërbimeve në pako.

Në vitin 2021 ka vazhduar rritja e kërkesës për shfrytëzimin e shërbimeve të internetit të ofruar në lokacion fiks, të cilës u janë përgjigjur pozitivisht operatorët duke zgjeruar aktivitetin e tyre. Si rezultat i kësaj, numri i përdoruesve të shërbimeve të internetit në fund të vitit 2021 ka arritur në; 383,868 përdorues, që shënon një rritje prej; 7,423 përdorues apo rritje prej; 2 %, në krahasim me vitin e kaluar.

Në bazë të të dhënave të përpunuara nga Autoriteti, në vitin 2021, kemi pasur në total; 3,981.076, dërgesa. Krahasuar me periudhën e njëjte të vitit 2020, kemi një rritje të lehtë të numrit të përgjithshëm të volumit të dërgesave postare në vlerën; 0.59 %, përderisa 'Posta Kosovës' SHA, ka një rritje të volumit të dërgesave postare në vlerën; 1.92 %, ndërsa operatorët privat kanë një rënie në vlerën; 2.16 %. 'Posta Kosovës' SHA, si operator publik postar mbulon tregun e përgjithshëm të shërbimeve postare me; 68.20 %, kurse operatorët privat janë të përfaqësuar në vlerën; 31.80 %, të tregut të përgjithshëm.

Sipas të dhënave të prezantuara nga ana e operatoreve të shërbimeve postare gjatë vitit 2021, janë realizuar të hyra në vlere prej; 10,559,570.04 Euro, krahasuar me të dhënat zyrtare të raportuara për vitin 2020, ka pasur një rritje të të hyrave në vlerën rreth; 27.60 %. Nga të hyrat e përgjithshme të realizuara në sektori e shërbimeve postare, 'Posta e Kosovës' SHA, ka realizuar të hyra në vlere prej; 2,643,967.04 Euro, ndërsa operatorët privat kanë prezantuar të hyra në vlerën rreth; 7,915,603.00 Euro.

Për më tepër ky raport ofron një pasqyrë të detajuar të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si dhe të dhënat thelbësore për aktivitetet e rregulluara në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, raporti ofron të dhëna mbi të arriturat e deritashme dhe angazhimeve të Autoritetit në arritjen e prioriteteve, objektivave dhe qëllimeve strategjike të përcaktuara me Ligjet përkatëse dhe dokumentin e politikave të sektorit të komunikimeve elektronike.

Për informimin tuaj, ky raport vjetor i punës së ARKEP, përfshin edhe punën e Bordit të kaluar i cili ka patur mandat deri në zgjedhjen e Bordit të ri më datë 27 Maj 2021.

Me respekt,

Nazim Rahimi
Kryetar i Bordit

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
1.1 TË ARRITURAT, OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE INDIKATORËT KRYESOR TË TREGUT	7
2. KORNIZA LIGJORE DHE MIRATIMI I LEGJISLACIONIT SEKONDAR GJATË VITIT 2021	13
2.1 PËRMIRËSIMI I BAZËS LIGJORE NË PERIUdhËN RAPORTUESE	13
2.2 VËSHIRËSITË QË KA HASUR INSTITUCIONI NË PËRMBUSHJEN E MISIONIT TË VET	15
3. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR ARKEP	16
3.1 MISIONI DHE VIZIONI.....	16
3.2 KOMPETENCAT E ARKEP	16
3.3 FUSHËVEPRIMI I ARKEP DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	19
4. AKTIVITETET RREGULLATORE	23
4.1. AUTORIZIMET E PËRGJITHSHME	23
4.2. IMPLEMENTIMI I KODIT TELEFONIK 383	24
4.3. IMPLEMENTIMI I MARRËVESHJES REGJIONALE TË ROAMINGUT (WB6) DHE TARIFAT E ROAMINGUT ME SHTETET E BE-SË.....	25
4.4. Pjesëmarrja në aktivitetet e BEREC-UT.....	27
4.5. MENAXHIMI I RESURSEVE TË FUNDME – SPEKTRIT FREKUENCOR	28
4.5.1. MENAXHIMI DHE SHFRYTËZIMI RESURSEVE TË FUNDME - SPEKTRIT RADIO FREKUENCORE SI OBLIGIM I LKE-S DHE LEGJISLACIONIN SEKONDAR	29
4.5.2. PËRLLOGARITJA E PAGESAVE TË RREGULLTA VJETORE PËR RADIO FREKUENCA	31
4.5.3. LËSHIMI I LICENCAVE PËR SHËRBIMIN RADIO AMATOR NGA ARKEP	31
4.5.4. NJOFTIMET DHE SHQIPTIMI I MASAVE NDËSHKUESE	31
4.5.5. ZËNSHMËRIA E BREZIT FREKUENCOR 26 GHz, (24.5 - 26.5 GHz) DHE ZHVILLIMET E SHËRBIMEVE TE RADIO KOMUNIKIMIT NE KËTË BREZ.....	32
4.5.6. AUTORIZIMET INDIVIDUALE PËR SHFRYTËZUESIT E RESURSEVE FREKUENCORE	33
4.5.7. MODULET SOFTUERIKE PËR MENAXHIMIN E SPEKTRIT FREKUENCORE	35
4.5.9. KOORDINIMI DHE BASHKËPUNIMI I ARKEP ME KPM.....	36
4.6. AUTORIZIMET (VENDIMET) PËR SHFRYTËZIMIN E RESURSEVE NUMERIKE.....	37
4.7. MONITORIMI I KUALITETIT TË SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE	39
4.7.1. REZULTATET E KUALITETIT TË SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE PËR TRI VITET E FUNDIT	40
4.7.2. SHPEJTËSIA E SHKARKIMIT/DOWNLOAD PËR TEKNOLOGJINË 4G/LTE PËR OPERATORIN TELEKOMI I KOSOVËS.....	40
4.7.3. KUALITETI I SHËRBIMIT TË ZËRIT/THIRRJEVE TË TELEFONISË MOBILE TË TELEKOMI I KOSOVËS	40
4.7.4. SHPEJTËSIA E SHKARKIMIT/DOWNLOAD NË TEKNOLOGJINË 4G/LTE PËR OPERATORIN IPKO	41
4.7.5. KUALITETI I SHËRBIMIT TË ZËRIT/THIRRJEVE TË TELEFONISË MOBILE TË IPKO	42
4.7.6. ANALIZA E TREGJEVE RELEVANTE, IMPLEMENTIMI I DETYRIMEVE RREGULLATORE DHE MEKANIZMAVE PËR SIGURIMIN E KONKURENCËS EFEKTIVE	43

4.7.7. RAPORTIMET PERIODIKE	43
4.8. MBROJTJA E TË DREJTAVE TË KONSUMATORIT DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE NË MES OPERATORËVE	43
4.8.1. PROCESET GJYQËSORE	44
4.8.2. SANKSIONET EKONOMIKE	45
4.9. RADIO MONITORIMI DHE INSPEKTIMI I SPEKTRIT FREKUENCOR.....	45
4.9.1. NGRITJA E SISTEMIT KOMBËTAR PËR MONITORIMIN E SPEKTRIT FREKEUNCOR	47
4.10. VEPRIMTARIA E NJËSIVE TEKNIKE KOS-IX, KOS-CERT	50
4.10.1. NYJA SHKËMBYESE E INTERNETIT KOS-IX.....	50
4.10.2. NJËSIA NACIONALE PËR SIGURI KIBERNETIKE (KOS-CERT).....	52
4.11. SHËRBIMET POSTARE	56
5. PLANI I PUNËS SË ARKEP PËR VITIN 2022	59
5.1. PLANI I PUNËS PËR VITIN 2022	62
6. SFIDAT E ARKEP	72
7. PASQYRA E PËRGJITHSHME E TREGUT TË SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE.....	73
7.1. PASQYRA E TË ARDHURAVE NGA SHËRBIMET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE	74
7.2. INVESTIMET E BËRA NË RRJETE DHE SHËRBIME TELEKOMUNIKUESE	75
7.3. TELEFONIA FIKSE	76
7.3.1. INDIKATORËT E TRAFIKUT TË TELEFONISË FIKSE	77
7.4. TELEFONIA MOBILE	77
7.4.1. TARIFAT	79
7.4.2. TARIFAT E TERMINIMIT TË TELEFONISË MOBILE.....	80
7.4.3. SHËRBIMET MOBILE BREZGJERA	80
7.4.4. MBULUESHMËRIA E RRJETEVE MOBILE	81
7.5. QASJA BREZGJERË NË INTERNET NGA RRJETI FIKS	82
7.5.1. NDAJJA E TREGUT.....	84
7.5.2. TEKNOLOGJITË E PËRDORURA	84
8. PASQYRA E PËRGJITHSHME E TREGUT TË SHËRBIMEVE POSTARE	86
8.1 REGJISTRI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE POSTARE	87
9. RAPORTI FINANCIAR.....	93
9.1. TË HYRAT.....	93
9.2. REALIZIMI I BUXHETIT.....	93
10. ADRESIMI I GJETJEVE TË AUDITORIT NGA VITI PARAPRAK	95
11. LLOGARIDHËNIA E ARKEP.....	96
11.1 SIGURIMI I INTEGRITETIT	96
11.1 DEKLARATA PËR TRANSPARENCË	96
LISTA E AKRONIMEVE.....	97

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Të arriturat, objektivat strategjike dhe indikatorët kryesor të tregut

Raporti Vjetor i punës për vitin 2021, ofron të dhëna mbi të arriturat e deritashme dhe angazhimeve të Autoritetit në arritjen e prioriteteve, objektivave dhe qëllimeve strategjike të përcaktuara me Ligjet përkatëse në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

Raporti paraqet një pasqyrë të ngjarjeve dhe zhvillimeve më të rëndësishme për vitin 2021, në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si dhe të dhënat thelbësore për aktivitetet e rregulluara në këta sektor. Ndërsa në pjesën e fundit të raportit është paraqitur raporti financiar (*Pika 9*) i Autoritetit, për vitin 2021, së bashku me raportin e Auditorit (*Pika 10*).

Aktivitetet e Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*shkurt: ARKEP ose Autoriteti*) gjatë vitit 2021, janë përqëndruar kryesisht në arritjen e qëllimeve dhe objektivave strategjike për rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, në nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në nivel të ofrimit të shërbimeve si një nga parakushtet thelbësore për nxitjen e investimeve, sigurimin e cilësisë së duhur të ofrimit të shërbimeve dhe me çmime sa më të arsyeshme, oferta të ndryshme dhe konkurruese për përdoruesit fundor (*konsumatorët*) gjithnjë duke siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Krahas sukseseve të arritura në implementimin e kornizes rregullatore, ARKEP edhe gjatë vitit 2021, është ballafaquar me sfida të shumta, ku nga më kryesoret janë: pavaresia financiare, numri shumë i vogël i resurseve profesionale në dispozicion dhe nevoja e domosdoshme për rritjen e mëtutjeshme, interesim i ulët i të rinjve për t'u punësuar si pasojë e nivelit të ulët të pagave të atakuar nga niveli ndjeshëm më i lartë i pagave në sektorët që i rregullon dhe mbikëqyr dhe vlerësimin të tyre si kuadro atraktive dhe deficitare për tregun.

Të arriturat kryesore të Autoriteti për gjatë vitit 2021 ndër të tjera janë:

- Është bërë analizimi i dokumenteve ndërkombëtare për çështje të menaxhimit të spektrit frekuencor, posaçërisht vendimeve dhe rekomandimeve Evropiane të CEPT (ECC, ERO) për brezet frekuencore (pioniere) në zbatim të teknologjive 5G, që përfshin brezet 700 MHz, 3400 - 3800 MHz dhe 26 GHz (25.25- 27.5 GHz);
- Është formuar grupi punues profesional për përgatitjen dhe rishikimin e dokumentit për hapjen e brezeve frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike të shërbimeve IMT (MFCN & 5G), me qëllim të zhvillimit të dokumentit për "Rishikimi i Planit për Hapjen e Brezeve me vlerë të posaçme ekonomike për shërbime mobile IMT & IMT 2020" si dhe dokumentit për planifikimin e brezit 3400- 3800 MHz. Në bazë të planit të përcaktuar në këtë dokument, aktivitetet për hapjen e brezeve ndahen në dy faza: Faza II dhe Faza III. Faza II përfshin dhënien e të drejtës së shfrytëzimit të kapaciteteve frekuencore të brezeve 800 MHz dhe 3400- 3800 MHz, që pritet të

realizohet në gjysmën e dytë të vitit 2022 ndërsa faza III përfshin hapjen e brezeve frekuencore 700 MHz, 2100 MHz, 2.6 GHz, 26 GHz dhe kapaciteteve të mbetura në brezet frekuencore 900 MHz dhe 1800MHz.

- Është realizuar lirimi i brezit 800 MHz, në bazë të memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar me Komisionin e Pavarur për Media (KPM). Në bazë të këtij memorandum, brezi 800 MHz, prej datës 01.01.2022 është liruar nga TV transmetuesit radio-difuziv, ashtu që i është hapur rrugë shfrytëzimit të tij për shërbime mobile. Ky brez u ofron operatorëve nacional të telefonisë mobile kapacitetet e nevojshme për shtrirjen e rrjetave MFCN, duke mundësuar kështu rritjen e kualitetit dhe kuantitetit të shërbimeve të telefonisë mobile në vend por edhe zbatimin e teknologjisë 5G;
- Është zhvilluar analiza e detajuar e brezit 3.6 GHz (3400 - 3800 MHz) në aspektin e shfrytëzueshmërisë, planifikimit dhe dhënies së resurseve frekuencore për zbatimin e teknologjisë 5G. Plani është që pjesa e poshtme e këtij brezi (3400 - 3700 MHz) të dedikohet për shfrytëzim nga operatorët e telefonisë mobile në nivel nacional, ndërsa pjesa e mbetur (3700 - 3800 MHz) të dedikohet për krijimin e rrjetave private të mbyllura dhe aplikim në industri.
- Paralelisht me planifikimin për hapjen e brezeve, ka filluar edhe procesi i mbledhjes së mostrave dhe informatave relevante, me qëllim të vlerësimit të çmimit të brezeve përkatëse frekuencore. Pavarësisht kompleksitetit dhe përgjegjësisë së madhe që bart në vete ky proces, ARKEP ka marrë vendim që vlerësimi të bëhet nga ekspertët e brendshëm të ARKEP, pa angazhimin e ndonjë kompanie konsulente, me ç'rast kursethet në masë të konsiderueshme buxheti i shtetit.
- Është përgatitur drafti final për rishikimin e Planit Kombëtar të Radio Frekuencave për Kosovë (PKRF) me tabelën e shpërndarjes dhe aplikimit të radio frekuencave në brezin 8.3 kHz deri 3000 GHz, në Republikën e Kosovës;
- Implementimi i marrëveshjes së roaming-ut, për Ballkanin Perëndimor (BP) RLAH (*Rome Like at Home*). Sipas kësaj marrëveshjeje, nga data 01 Korrik 2021, parapaguesit gjatë qëndrimit në njërin nga vendet e BP nuk do të paguajnë asnjë tarifë shtesë për shërbimet e rregulluara të roamingut, thirrjet e realizuara ose pranuar, SMS të dërguar dhe të dhëna/Data të shfrytëzuara), përveç tarifës e cila aplikohet në Republikën e Kosovës (*Rome Like at Home - RLAH*). Kjo do të thotë se ofruesit e shërbimit roaming nuk mund të aplikojnë asnjë tarifë shtesë direkte ose indirekte për të mundësuar roaming-un në shtetet e BP;
- Kemi përfunduar shumicën e fazave të projektit për funksionalizimin e Sistemit Nacional të Monitorimit të Spektrit frekuencor (SNMS), projekt ky i implementuar me ndihmën e Ministrisë së Ekonomisë në kuadër të projektit 'Kosovo Digital Economy' (*shkurt; KODE*) dhe mbështetur financiarisht nga Banka Botërore.

- Është iniciuar procesi i rishikimit të Rregullores për bartshmërinë e numrave ashtu që të merren parasysh zhvillimet e fundit teknologjike dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në aspektin e implementimit. Me këtë projekt synohet rritja e konkurrencës në treg duke iu mundësuar konsumatorëve ruajtjen e numrit gjatë ndërrimit të ofruesve të shërbimeve të telefonisë fikse dhe mobile.
- Është iniciuar procedura e analizës së dy tregjeve të komunikimeve elektronike, përkatësisht: tregut i qasjes në nivel lokal me shumicë të ofruar në lokacion fikse (*tregu 3a*) dhe tregu i qasjes në nivel qendror me shumicë, i ofruar në lokacion fikse për produktet e tregut masiv (*tregu 3b*). Si rezultat janë përpiluar draft-raportet për tregjet përkatëse, të cilat pas shqyrtimit në bord do të publikohen për konsultim publik.
- Është iniciuar Projekti i Digjitalizimit të ARKEP (*Digit-ARKEP*), i cili ka për qëllim digjitalizimin e shërbimeve të ofruara të ARKEP për konsumatorët, operatorët, si dhe për palët e tjera të interesit, si publikun e gjerë, vendim-marrësit dhe akterët e tjerë relevant në sektorin e komunikimeve elektronike dhe postare.
- Janë nxjerrë një numër i konsiderueshëm i interpretimeve dhe/apo udhëzimeve për palët, kryesisht për operatorët e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe atyre postare.
- Janë lëshuar dhjetë (10) autorizime/konfirmime të njoftimeve për gjithsej njëzet (20) aktivitete, të gjitha këto për ndërmarrje të reja në tregun e komunikimeve elektronike, prej të cilave tetë (8) aktivitete të ofrimit të rrjetit publik fikse, dy (2) aktivitete të ofrimit të shërbimit të linjave me qira, tetë (8) aktivitete të ofrimit të shërbimeve të internetit dhe dy (2) aktivitete të ofrimit të shërbimeve me vlerë të shtuar.
- Janë nxjerrë gjithsej njëqind e tridhjetë e pesë (135) vendime administrative për caktim (*ndarjen*) dhe/apo rezervimin e resurseve numerike, sipas rekomandimeve të Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE);
- Janë realizuar dhe përgatitë rreth njëqind e shtatëdhjetë e nëntë (179) autorizime individuale të radio frekuencave, me 1850 kanale frekuencore, të cilat shfrytëzojnë shërbime mobile tokësore PMR (*Private Mobile Radio*), shërbime mikrovalore (*FIKSE*), linqe PTP (*Point to Point*), shërbime satelitore dhe shërbime aeronautike. Aktualisht numri i operatoreve që shfrytëzojnë resurse frekuencore brenda territorit të Republikës së Kosovës është njëqind e tetëdhjetë (180) operatorë.
- Është bërë monitorimi i kualitetit të shërbimeve (*QoS*) të komunikimeve elektronike me theks tek shërbimet e qasjes mobile në internet (*3G dhe 4G*) për operatorët ofrues të këtyre shërbimeve në nivel vendi për operatorët ‘Telekomi i Kosovës’ Sh.a., dhe ‘IPKO Telecommunications’ LLC. Me këtë rast janë realizuar afër 10.000 testime, matje të parametrave të kualitetit të këtyre shërbimeve në nivel të vendit.

- Publikimi i rregullt i raporteve periodike (*TM1 deri TM4 për tregjet e komunikimeve elektronike dhe dy raportet gjashtëmujore për tregun komunikimeve elektronike*) dhe raporteve vjetore për gjendjen e tregjeve të komunikimeve elektronike. Këto raporte rezultojnë të jenë burimi kryesor për referim nga ana e investitorëve potencial në sektor, operatorëve, institucioneve, profesionistëve, studentëve dhe qytetarëve të interesuar lidhur me zhvillimet në treg;
- Monitorimi i rregullt dhe specifik i spektrit frekuencor, për të verifikuar përmbushjen e obligimeve që kanë shfrytëzuesit e resurseve frekuencore si dhe evidentimin e shfrytëzimit të pa autorizuar. Gjatë vitit 2021 janë realizuar gjithsej gjashtëdhjet e pesë (65) matje në terren nga ekipi i Departamentit të Radio Monitorimit dhe Inspektimit (DRMI).
- Publikimi i rregullt i buletineve të sigurisë tek komuniteti i anëtarësuar në Sistemin Informativ të Njësisë Nacionale për Siguri Kibernetike “KOS-CERT”, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për publikun e gjërë dhe nevojat specifike të konstituenteve. Gjatë vitit 2021 janë publikuar në total katër mbëdhjetë (14) buletine të sigurisë.
- Koordinimi i incidenteve kibernetike me konstituentët. Gjatë vitit 2021 janë koordinuar afërsisht njëzet (20) lloje të ndryshme të incidenteve dhe kërcënimeve kibernetike, si rezultat i monitorimit të IP-ve publike në nivel nacional përmes konsultimit të të dhënave nga burimet publike. Gjithashtu janë koordinuar me palët edhe njëmbëdhjetë (11) incidente të raportuara nga CERT-ët nacional të vendeve tjera.
- Janë lëshuar gjithsej katër (4) autorizime të përgjithshme, për ofrim të shërbimeve postare;
- Janë realizuar dy (2) inspektime dhe kontrole të operatorëve postarë;
- Janë adresuar të gjitha ankesat nga operatorët postarë me përgjigje dhe interpretime konkrete rregullatore;
- Janë miratuar tarifat e reja për shërbimet universale postare (*Ref. Vendimi Nr. 1825*);
- Janë pranuar dhe administruar në mënyrë të rregullt dhe konform Rregullores Nr. 11, raportet tremujore (TM) të pranuar nga të gjithë operatorët postarë.

Për sa i përket të hyrave ARKEP gjatë vitit 2021, ka realizuar të hyra në vlerën rreth 6.4 milion Euro, respektivisht; 6,359,513.96 Euro, të cilat në mënyrë të shpalosur janë paraqitur në *Pikën 9* të raportit.

Në aspektin e avancimit të transparencës dhe llogaridhënies gjatë vitit 2021, Autoriteti ka vazhduar ta përmbush obligimin e saj ndërlidhur me publikimin e punëve dhe angazhimeve të kryera. Të gjitha informacionet dhe dokumentet relevante mbi aktivitetet e Autoritetit rregullisht dhe në kohë reale janë publikuar në ueb faqen e Autoritetit, përfshi këtu dhe jo vetëm:

- i. Publikimin e gjitha akteve rregullatore dhe vendimeve me efekt rregullator të miratuara nga Bordi Drejtues, përfshi këtu edhe vendimet administrative me efekt për palët e treta;

- ii. Zhvillimin e procedurave mbi këshillimet publike si të parapara me dispozitat e Ligjit me ç’rast edhe janë organizuar dhe mbajtur seanca të këshillimeve mbi të gjitha çështjet me rëndësi për palët e interesit;
- iii. Publikimin dhe azhurnimin e rregullt të bazës së të dhënave, gjegjësisht regjistrave të operatorëve, ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, operatorëve të shërbimeve postare, si dhe shfrytëzuesve të autorizuar të resurseve/kanaleve frekuencore dhe numerike;
- iv. Publikimin e rregullt të raporteve periodike me të dhënat statistikore të tregjeve të komunikimeve elektronike dhe postare;
- v. Publikimin e rregullt të të dhënave dhe informacioneve për shfrytëzuesit e fundmë (konsumatorët) e shërbimeve telekomunikuese dhe shërbimeve postare;

Për më tepër, zyrtarët drejtues të Autoritetit kanë qenë të hapur ndaj mediave audio-vizuele dhe të shkruara, ku në mënyrë plotësuese kanë informuar audiencën e gjerë mbi të gjitha çështjet e vlerësuara me rëndësi për/dhe mbi lëmin e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Gjithsesi, në referim të përmbushjes së obligimeve për transparencë, vlen të theksohet se në mungesë të resurseve njerëzore dhe profesionale, edhe gjatë vitit 2021, Autoriteti ka vazhduar të përballet me sfidën administrative, ndërlidhur me obligimin për publikimin e dokumenteve edhe në gjuhën serbe dhe atë angleze.

Sa i përket planit të performancës për vitin 2022, ARKEP, ka për qëllim t’i adresojë objektivat rregullatore të përcaktuara me Ligjin për Komunikimet Elektronike, Ligjin për Uljen e Kostos për Shtrirjen e Infrastrukturës së Komunikimeve Elektronike dhe Ligjin për Shërbimet Postare.

Në veçanti objektivat me fokus të përgjithshëm për vitin 2022 janë:

- I. Hapja e brezeve frekuencore me fokus në mundësimin e implementimit të rrjetave 5G, në Republikën e Kosovës;
- II. Rritja sigurisë së përdorimit efikas dhe efektiv të brezit frekuencor në kuptim të mbulueshmërisë në kohe dhe hapsirë në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- III. Ngritja e kapaciteteve për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare;
- IV. Avansimi i ARKEP-it, në Autoritet modern për sa i përket lehtësisë dhe transparencës në komunikim me palët e interesit.

Fokusi i Autoritetit do të orientohet në:

- i. Avancimi i mëtutjeshëm i konkurrencës efektive në treg, duke përfshirë shërbimet dhe rrjetat e komunikimeve elektronike, përmes harmonizimit dhe miratimit të legjislacionit sekondar dhe implementimit të projekteve përkatëse;
- ii. Nxjerrjen dhe miratimin e gjithë legjislacionit tjetër sekondar brenda periudhave kohore dhe dinamikës së veprimeve si të parapara me dokumentin e Akteve Normative të Autoritetit në zbatim të Ligjit, i publikuar në ueb faqen e Autoritetit;
- iii. Avancimi i mëtutjeshëm në përmirësimin e kushteve për shtrirjen e shërbimeve brezgjëra në tërë territorin e Republikës së Kosovës, ashtu që konsumatorëve t'u sigurohet qasje në internet me shpejtësi të lartë;
- iv. Krijimi i kushteve dhe procedurave të përshtatshme për liberalizimin dhe hapjen e brezeve shtesë për avancimin e shërbimeve brezgjëra përmes rrjeteve të komunikimeve mobile,
- v. Sigurinë dhe integritetin e rrjetave dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të rritur besimin e publikut dhe bizneseve;
- vi. Avancimi i masave mbrojtëse për përdoruesit fundorë (konsumatorët);
- vii. Krijimin e qartësisë maksimale të mjedisit rregullator, i cili do mundësojë dhe inkurajojë investimet dhe inovacionet në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare në Republikën e Kosovës.

2. KORNIZA LIGJORE DHE MIRATIMI I LEGJISLACIONIT SEKONNDAR GJATË VITIT 2021

Autoriteti veprimtarinë e vet për mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike e bazon në përputhje me Legjislacionin e paraqitur në tabelën 1.

TABELA 1. BAZA EKZISTUESE LIGJORE

Legjislacioni Primar/Ligjet,			
1	Ligji për Komunikimet Elektronike ¹	04/L-109	04 Tetor 2012
2	Ligji për Shërbimet Postare ²	06/L-038	21 Dhjetor 2018
3	Ligji për masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjetave të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë	08/L-007	6 Dhjetor 2021

Deri në fund të vitit 2021, ARKEP ka miratuar një numër të konsiderueshëm të akteve nën ligjore, të rëndësishme për përmbushjen e objektivave rregullatore dhe obligimeve të dala nga Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA). Të gjitha aktet e miratuara deri në fund të vitit 2021 i gjeni në linkun; <http://arkep-rks.org/?cid=1,8>.

2.1 Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Në periudhën raportuese janë miratuar rregullore të reja si dhe është bërë plotësim-ndryshim i akteve tjera nënligjore, si në vijim:

1. Rregullorja Nr. 50 - Plani Kombëtar i Numeracionit për Rrjetat e Komunikimeve Elektronike (Ref. Nr. Prot. 011/B/21 datë; 10/03/2021).

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është definimi i Planit Kombëtar të Numeracionit, përcaktimit të strukturës, gjatësisë dhe procedurave për dhënien e numrave për qasje në rrjetet dhe shërbimet publike të komunikimeve elektronike, si dhe identifikuesit tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike, ashtu që të:

- sigurojë strukturim dhe shfrytëzim efikas të numrave dhe serive të numrave;
- plotësojë nevojat e arsyeshme të operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike për caktim të numrave;
- sigurojë që caktimi dhe përdorimi i numrave bëhet në mënyrë të ndershme.

¹ Ky Ligj ka shfuqizuar Ligjin Nr.2002/7, mbi Telekomunikacionin,

² Ky Ligj ka shfuqizuar Ligjin Nr. 03/L-173, për shërbimet postare,

2. Rregullorja nr. 51 për “Zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së heqjes së Tarifave të Roamingut me Pakicë për vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) (Ref. Nr. Prot. 039/B/21 datë; 22/06/20210.)

Kjo Rregullore përcakton kriteret të hollësishme për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm të një politike të përdorimit të drejtë që ofruesit e shërbimit të roamingut mund të aplikojnë për konsumin e shërbimeve të rregulluara të roamingut të ofruara në nivel të çmimeve kombëtare me pakicë.

3. Rregullorja nr. 52 për llogaritjen e kostove të ofruesit të shërbimeve universale postare dhe Udhëzuesi për llogaritjen e kostove të ofruesit e shërbimeve universale postare (Ref. Ligjit Nr. 06/L-038, për Shërbimet Postare).

Rregullorja për llogaritjen e Kostove të Ofruesit të Shërbimit Universal i përcakton parimet themelore të menaxhimit të llogaritjes së kostove të ofruesit të shërbimit postar universal (*tutje referuar si - OSHU*) dhe kërkesat për sistemin e llogaritjes së kostos.

4. Rregullorja nr. 53 për llogaritjen e humbjeve të ofruesit të shërbimeve universale postare dhe Udhëzuesi për llogaritjen e humbjeve të ofruesit të shërbimeve universale postare. (Ref. Ligjit Nr. 06/L-038, për Shërbimet Postare).

Rregullorja për Llogaritjen e Humbjeve të Shërbimit Universal Postar përcakton kërkesat e përgjithshme për llogaritjen e humbjeve në sigurimin e shërbimit universal postar, procedura për identifikimin e shërbimit postar universal i cili nuk do të sigurohej nga një ofrues i shërbimit universal postar (*këtu e tutje - OSHU*) nëse ky i fundit nuk do ishte i detyruar ta bënte këtë, kërkesat për llogaritjen e humbjeve të ndodhura në ofrimin e shërbimit universal postar dhe për sigurimin e informacionit për Autoritetin.

Gjithashtu gjatë periudhës raportuese janë përgatitur edhe draft-rregulloret si ne vijim:

5. Draft- Rregullorja për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mes të ndërmarrësve.

Rregullorja për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet ndërmarrësve përcakton kërkesat për procedurën dhe kushtet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet ndërmarrësve, duke përfshirë mosmarrëveshjet ndërmjet përdoruesve të infrastrukturës dhe pronarëve të infrastrukturës në lidhje me marrëdhëniet shoqërore, të rregulluara me Ligjin për Komunikimet Elektronike, mosmarrëveshjet që lindin nga moszbatimi i Ligjit për masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe zgjidhjen e tyre me procedurë paraprake jashtëgjyqësore.

6. Draft-rregullore për analizat e tregut.

Qëllimi kryesor i kësaj rregulloreje është të implementoj Ligjin për Komunikimet Elektronike, lidhur me promovimin e investimeve dhe konkurrencën e lirë në tregun e komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës, duke krijuar një siguri ligjore përmes përcaktimit të kornizës transparente për analiza të tregut, përcaktimin e ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg dhe imponimin e detyrimeve rregullatore ‘ex-ante’.

7. Draft-rregullore për ofertën referuese për qasjen e hapur.

Rregullorja për ofertën referuese për qasjen e hapur në lakun lokal dhe qasjen në bitstream përcakton: Procedurat dhe afatet e fundit për ndërmarrjen e komunikimeve elektronike me fuqi të konsiderueshme në treg, në të cilat Autoriteti ka obliguar për shtjellimin dhe publikimin e ofertës referuese për qasje të hapur në lakun lokal apo qasje në bitstream dhe kërkesat për publikimin e informacioneve dhe informacionet që duhet të përfshihen në ofertën referuese, si dhe niveli i detajeve të këtyre informacioneve.

2.2 Vështirësitë që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet

ARKEP në vazhdimësi është duke u ballafaquar me sfida të shumta, por në veçanti po i përmendim dy çështje të cilat ndikojnë më së shumti në arritjen e objektivave të Autoritetit, e ato janë çështjet në vijim:

1. Mungesa e pavarësisë financiare si rezultat i interpretimit të kufizuar të Ligjit për Menaxhimin e Financave, respektivisht procedurës së miratimit të Buxhetit;
2. Ngritja e kapaciteteve profesionale, me fokus të veçantë ruajtja dhe rritja e resurseve profesionale/nëpunësve të ARKEP;

Këto sfida janë adresuar në vazhdimësi edhe nga Bashkimi Evropian (BE) në të gjitha takimet e mbajtura në kuadër të nën-komitetit për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politikave sociale, dhe në të gjitha Raportet vjetore të Progresit të publikuara për Republikën e Kosovës.

Për sa i përket pavarësisë financiare, ARKEPka vështirësi të mëdha në implementimin e projekteve të ndryshme dhe ruajtjen e stafit profesional. Në këtë kuptim duke iu referuar Ligjit Nr. 04/L-109, për Komunikime Elektronike, përkatësisht neni 8, paragrafi 2, i cili në mënyrë të qartë specifikon:

‘Autoriteti është person juridik, publik, vetë financues, jofitimprurës, i pavarur, i cili e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti në punën dhe në marrjen e vendimeve brenda kompetencave të tij është i pavarur’.

Ndërsa neni 81, paragrafi 1, i Ligjit specifikon;

‘Burimet e financimit të Autoritetit sigurohen nga Buxheti i Kosovës, përmes të hyrave të Autoritetit në pajtim me nenin 83 të këtij ligji’.

Pra bazuar në dispozitën e nenit 81, paragrafin 1, rezulton se në mënyrë të drejtpërdrejtë është e cenuar pavarësia financiare dhe funksionimi i Autoritetit, gjë që është potencuar edhe nga raportet dhe rekomandimet e institucioneve të BE-së.

3. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR ARKEP

3.1 Misioni dhe Vizioni

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*shkurtë; ARKEP ose Autoriteti*), është themeluar si institucion i pavarur nga Kuvendi i Kosovës, sipas nenit 142, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që të ushtroj dhe kryen rregullimin ekonomik në sektorin e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-109, për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar si: LKE*), si dhe Ligjin Nr. 06/L-038, për Shërbimet Postare (*tutje referuar si: LSHP*), si dhe me qëllimi të lehtësimit dhe nxitjes së ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë zbaton gjithashtu edhe Ligjin Nr. 08/L-007, për Masat për Uljen e Kostos së Shtrirjes së Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë.

ARKEP është autoritet nacional rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe atë të shërbimeve postare, i cili zbaton dhe mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar me ligjin për komunikimet elektronike, ligji për shërbimet postar si dhe politikat e sektorit.

Autoriteti është person juridik, publik, vetëfinancues, jofitimprurës, i pavarur, i cili e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti në punën dhe në marrjen e vendimeve brenda kompetencave të tij është i pavarur. Autoriteti udhëhiqet dhe drejtohet nga Bordi Drejtues që është njëkohësisht autoriteti ligjor dhe i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*Ref. Nr. Prot. 054/B/17*), të miratuar nga ai vet. Kuvendi cakton Kryetarin ndërmjet anëtarëve të Bordit, i cili njëkohësisht është drejtues ekzekutiv i Autoritetit.

Misioni dhe vizioni i Autoritetit është që i tërë aktiviteti dhe veprimtaria e saj të bazohet dhe dallohet në të vepruarit si një rregullator i pavarur dhe pararendës për tregjet e komunikimeve elektronike dhe postare duke kërkuar të arrij një kuadër rregullator që nxit një mjedis të favorshëm për investitorët dhe ofron zgjidhje, çmime dhe cilësi më të mirë për të gjithë përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare në Kosovë.

3.2 Kompetencat e ARKEP

Kompetencat dhe detyrat e Autoritetit janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-109, për Komunikimet Elektronike (LKE) dhe Ligjin Nr. 06/L-038, për Shërbimet Postare (LSHP). Autoriteti ushtron funksionet në përputhje me ligjet dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku aderon Republika e Kosovës.

Kompetencat e ARKEP, në fushën e komunikimeve elektronike janë të përcaktuara në nenin 10 të LKE:

- Në bashkëpunim më ministrinë përgatitë Planin Kombëtar të Radio-Frekuencave dhe punon për harmonizimin e këtij plani me politikën ndërkombëtare mbi zhvillimin e spektrit të radio-frekuencave;
- Mbledh dhe përpunon të dhënat statistikore nga ndërmarrësit që kryejnë veprimtarinë e tyre në fushën e komunikimeve elektronike;
- Publikon çdo informacion të nevojshëm për zhvillimin e një tregu të hapur dhe konkurrues;
- Miraton legjislacionin sekondar lidhur me implementimin e ligjit për komunikimet elektronike, ligjit për shërbimet postare dhe strategjitë/politikën e miratuara nga Qeveria;
- Miraton vendimet në lidhje me përcaktimin e tregjeve përkatëse, kryen analizat e tregut dhe imponimin, si dhe tërheqjen e obligimeve të rregullatorit tek operatorët me fuqi të ndjeshme tregu;
- Miraton vendimet lidhur me përcaktimin e ofruesve të shërbimeve universale dhe përcaktimin e obligimeve dhe të drejtave të tyre;
- Monitoron dhe rregullon dispozitat e komunikimeve elektronike publike të rrjetave dhe shërbimeve;
- Zgjidhë mosmarrëveshjet, duke përfshirë ato që lidhen me çështjet e përdorimit të përbashkët të faciliteteve dhe pasurive në mes të ndërmarrësve;
- Zgjidhë mosmarrëveshjet në mes të përdoruesve fundorë dhe operatorëve të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;
- Monitoron dhe rregullon përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe pasurive;
- Miraton Planin Kombëtar të numeracionit, Planin për përdorimin e Radio-Frekuencave (kanaleve) dhe planet e zhvillimit të radio komunikimit;
- Menaxhon resurset e fundme – spektrin e radio-frekuencave dhe hapësirën e numeracionit në komunikimet elektronike;
- Zbaton detyrat që lidhen me kompatibilitetin elektromagnetik, përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve, radio-monitorimin dhe eliminimin e Interferencave (ndërrhyrjeve) të Radios;
- Lëshon autorizime dhe akte të tjera në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit/ligjeve si dhe rregulloret e miratuara;
- Miraton vendimet lidhur me grantet, transferet dhe revokimin e licencave individuale për përdorimin e spektrit të radio-frekuencave në bazë të tenderit publik dhe procedurave të Ankandit publik;
- Kontribuon në përgatitjen e propozimeve të strategjive kombëtare dhe politikave;
- Brenda fushëveprimit të kompetencave të veta, bashkëpunon dhe participon në punën e organeve punuese administrative dhe ndërkombëtare, regjionale, si dhe organizatave dhe institucioneve në fushën e komunikimeve elektronike aty ku aderon Republika e Kosovës;
- Në bazë të autorizimeve të marra, lidhë marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale në fushën e komunikimeve elektronike;
- Publikon informatat/udhërrëfyes lidhur me zbatimin e ligjit brenda fushës dhe duke iu nënshtruar procedurës dhe kushteve të vendosura nga vetë Autoriteti;

- Kryen funksionet e qendrës kompjuterike për reagime emergjente me qëllim të ballafaqimit me rreziqet për sistemet publike të komunikimeve elektronike;
- Bën konsultime lidhur me zbatimin e ligjit si dhe rregulloret e nxjerra nga Autoriteti.

Kompetencat e ARKEP, në fushën e shërbimeve postare janë të specifikuara në dispozitat e nenit 7 të LSHP, dhe atë si në vijim;

- harton dhe miraton rregulloret në zbatim të këtij ligji;
- lëshon dhe tërheq autorizimet, të dhëna në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore;
- përcakton ofruesin e shërbimit universal postar sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe mbikëqyrë përmbushjen e detyrimeve të shërbimit universal postar;
- mbikëqyrë, monitoron dhe inspekton veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve postare, dhe merr masa administrative, në rast të shkeljeve të dispozitave këtij ligji dhe të akteve të nxjerra në zbatim të tij;
- mbikëqyrë respektimin e kërkesave ligjore për tarifën e shërbimeve postare dhe merr masat e nevojshme rregullatore në zbatim të këtij ligji;
- harton, kontrollon dhe mbikëqyrë standardet dhe kushtet teknike për ofrimin e shërbimit postar dhe shërbimit universal postar në përputhje me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare;
- nxit konkurrencën e lirë ndërmjet ofruesve të shërbimeve postare, për të garantuar transparencën dhe mos diskriminimin;
- mbledhë dhe përpunon të dhëna statistikore dhe financiare nga ofruesit e shërbimeve postare, në përmbushje të detyrave rregullatore, duke garantuar ruajtjen e sekretit për informacionin e dhënë;
- harton dhe miraton kushtet dhe termat e përgjithshëm të ofrimit të shërbimit universal postar;
- rregullon dhe miraton tarifën e shërbimit universal postar dhe shërbimeve të tjera specifike, të përcaktuara me këtë ligj;
- zgjidh mosmarrëveshjet midis ofruesve të shërbimit postar;
- mbron të drejtat e shfrytëzuesve të shërbimeve postare dhe zgjidhë mosmarrëveshjet ndërmjet shfrytëzuesve dhe ofruesve të shërbimeve postare;
- bashkëpunon me organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e rregullimit të shërbimeve postare;
- përfaqëson Republikën e Kosovës në organizatat ndërkombëtare rregullatore të shërbimeve postare.

Po ashtu ARKEP do të zbatojë edhe Ligjin Nr. 08/L – 007, për Masat për Uljen e Kostos së Shtrirjes së Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë, ku me anë të këtij ligji ARKEP-it, i janë vendosur kompetenca shtesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rast të refuzimit të qasjes në infrastrukturën ekzistuese fizike, si dhe kompetenca për shqiptimin e sanksioneve ekonomike në rast të mos zbatimit të këtij Ligji nga ana e operatorëve të rrjetit. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, ARKEP është në komunikim e sipër me Ministrinë e Ekonomisë për transferimin e kompetencave sa i përket krijimit të qendrës së vetme të informimit si dhe menaxhimit të atlasit elektronik për përcaktimin hartografik të infrastrukturës së komunikimeve elektronike.

3.3 Fushëveprimi i ARKEP dhe struktura organizative

Struktura aktuale organizative e Autoritetit është miratuar nga Bordi i Autoritetit përmes vendimit Nr. 309 (Ref. Nr. Prot. 002/B/13, datë; 08 shkurt 2013) dhe si e tillë paraqitet si më poshtë.

Në figurën 1, është paraqitur struktura organizative e ARKEP.




FIGURA 1. SKEMA ORGANIZATIVE ARKEP.

Bordi

Autoriteti drejtohet nga Bordi Drejtues i Autoritetit, i cili është organi më i lartë vendimmarrës në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të tij rregullatore. Bordi i Autoritetit përbëhet nga pesë (5) anëtarë të emëruar nga Kuvendi i Kosovës, prej të cilëve njëri është Kryetari i Bordit.

Mandati

Kryetari dhe anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi me mandat pesë (5) vjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandatë tjetër. Bordi aktual është zgjedhur me Vendimin Nr.08-V-012, të datës; 27.05.2021, të Kuvendit të Kosovës. Anëtari i Bordit nuk mund të shërbejë më tepër se dy (2) mandate.

Kompetencat

Bordi i Autoritetit është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e veta vetëm në bazë të ligjit, politikave të Qeverisë, statutit dhe akteve tjera normative të miratuara nga Bordi.

Anëtarët e Bordit ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë sipas ligjit dhe statutit dhe në përputhje me standardet dhe praktikat menaxhuese ndërkombëtare që zbatohen për bordet drejtuese rregullatore. Anëtarët e Bordit ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre në pajtim me parimin e ligjshmërisë, profesionalizmit, paanshmërisë, transparencës, proporcionalitetit, konfidencialitetit dhe ndershmërisë.

Ekzekutivi

Përveç ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësiave rregullatore si anëtar i Bordit, Kryetari i Bordit është udhëheqësi më i lartë administrativ, përkatësisht Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) i Autoritetit, dhe është përgjegjës për administrimin e Autoritetit në pajtim me ligjin.

Menaxhmenti i mesëm

Bordi i Autoritetit mbështetet nga menaxhmenti i mesëm të cilët janë shefat të departamenteve dhe udhëheqësit e njësive të Autoritetit të cilat menaxhojnë dikastere të veçanta brenda Autoritetit.

Njësit funksionale rregullatore:

- Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE);
- Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave (DMF);
- Departamenti për Radio Monitorim dhe Inspektim (DRMI);
- Departamenti Ligjor (DL);
- Sektori i Shërbimeve Postare (SSHP).

Njësit mbështetëse teknike:

- Zyra e Teknologjisë së Informacionit;
- Njësia për menaxhimin e ccTLD;
- Njësia e KOS-IX;
- Qendra kompjuterike e reagimit emergjente KOS-CERT;

Njësit mbështetëse Administrative:

- Departamenti i Administratës;

- Zyra e Financave;
- Zyra e Prokurimit.

Mandati

Autoriteti është përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e gjitha aktiviteteve të komunikimeve elektronike dhe postare duke u mbështetur në parimet rregullatore, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike dhe postare si dhe duke garantuar shërbimet cilësore dhe të përshtatshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Burimet Njerëzore

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në vitin raportues ka pasur të punësuar gjithsejtë tridhjetë e pesë (35) nëpunës civil, përfshirë këtu edhe pesë (5) pozita të Anëtarëve të Bordit, ndërsa të aprovuara ka patur gjithsejtë dyzet (40) pozita.

Gjatë vitit 2021, edhe përkundër tentimit të plotësimit të gjitha pozitave të lira, janë realizuar me sukses katër (4) konkurse të brendshme, ndërsa janë iniciuar për rekrutim gjithsejtë edhe tri (3) pozita të tjera të cilat për shkak të dështimit të konkurseve nuk kemi arritur ti përmbyllim brenda vitit raportues.

TABELA 2. NUMRI I STAFIT TË ARKEP

STAFI I AUTORITETIT	
Numri i përgjithshëm i stafit;	35 (Përfshirë Bordin e ARKEP)
Numri i përgjithshëm i personelit femra;	12 (ose shprehur në % = 40%)
Numri i përgjithshëm i anëtarëve të Bordit;	5 (ose shprehur në % = 40%)
Numri i përgjithshëm i shefave të Departamenteve	5 (shprehur në % = 20%)
Numri i përgjithshëm i Udhëheqësve të zyrave	5

Pra gjatë vitit në vijim (2022) është vazhduar me procedurat për rekrutimin dhe plotësimin e pozitave të lira si në vijim:

1. Zyrtar/e për Bartshmëri të Numrave (DKE);
2. Zyrtar/e për radio komunikime ndërkombëtare dhe Zhvillim Teknologjik (DMF);
3. Analist i sigurisë kibernetike (KOS-CERT) dhe
4. Zyrtar/e për trajtimin e incidenteve të sigurisë kibernetike (KOS-CERT).

Duhet potencuar se ARKEP, ka përmirësuar dukshëm përfaqësimin dhe balancin e barazisë gjinore, ndërsa sfidë mbetet punësimi i pjesëtarëve të komuniteteve jo shqiptare, edhe pse vazhdimisht e kemi potencuar në konkurse se inkurajohet aplikimi nga pjesëtarët e minoriteteve, por asnjë nga minoritarët nuk ka aplikuar, kështu që në institucionin tonë nuk kemi të punësuar ndonjë punonjës nga komunitetet tjera, e që pritet që në të ardhmen të plotësohen.

Ashtu siç është përmundur edhe më parë ARKEP ka numrin më të vogël të të punësuarve në rajon.

TABELA 3. KRAHASIMI I NUMRIT TË NËPUNËSVE ME AUTORITETET HOMOLOGE NË REGJION.

Nr.	Autoriteti /Agjensioni Shteti	Nr. i stafit	Nr. i Njësive	Nr. i stafit për Njësi	Shënim
1	ICTA, Turqia	805	15	54	9 Departamente / Sektor
2	RATEL, Serbia	105	4	26	4 Departamente të ndarë në 9 njësi
3	RAK, Bosna dhe Hercegovina	118	5	24	5 Sektor
4	HAKOM, Kroacia	170	9	19	9 Sektor
5	AEC, Maqedonia	134	10	13	5 Departamente + 5 Divizione
6	EKIP, Mali i Zi	82	6	11.50	6 Sektor
7	AKEP, Shqipëria	85	7	8.5	6 Departamente + 1 Zyrë
9	ARKEP, Kosova	40	11	3.6	5 Departamente + 7 zyra/njësi

4. AKTIVITETET RREGULLATORE

4.1. Autorizimet e Përgjithshme

Në përputhje me Rregulloren për Autorizimet e Përgjithshme, ARKEP edhe gjatë vitit 2021, ka vazhduar me dhënien e autorizimeve për ndërmarrësit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

Regjistri i ndërmarrjeve të autorizuara është i publikuar në ueb faqen e Autoritetit dhe në baza të rregullta periodike përditësohet nga Autoriteti (<http://arkep-rks.org/?cid=1,218>). I gjithë procesi i notifikimit është shumë i thjeshtë dhe realizohet përmes platformës online (<http://aplikime.arkep-rks.org/SQ>).

Me qëllim të avansimit të mëtutjeshëm të proceseve, ARKEP gjatë vitit 2021 ka themeluar komisionin e ekspertëve, të cilët kanë përgatitur dokumentet me specifikimet e nevojshme teknike për digjitalizimin e tërë procesit të brendshëm të ARKEP (*Projekti Digit-ARKEP*). Ky projekt synohet të përmbillet në vitin 2022.

Tabela e mëposhtme paraqet numrin e autorizimeve të përgjithshme të lëshuara nga Autoriteti ndaj ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2021 me përshkrimin e shërbimeve të autorizuara.

Gjatë periudhës raportuese janë lëshuar gjithsej dhjetë (10) autorizime/konfirmime të njoftimeve për gjithsej njëzet e katër (24) aktivitete, të gjitha këto ndërmarrje të reja në tregun e komunikimeve elektronike.

TABELA 4. REGJISTRI I AUTORIZIMEVE/KONFIRMIMEVE TË NJOFTIMEVE GJATË VITIT 2021

AKTIVITET E NJOFTUARA GJATË VITIT 2021		
	Ofrimi i Shërbimeve me Vlerë të Shtuar (VAS)	2
	Ofrimi i Shërbimit të Internetit	10
	Ofrimi i Rrjet Publik fiks	10
	Ofrim i shërbimeve të linjave me qira	2
	Ofrimi i Shërbimeve Publike telefonike fikse	0

Ndërsa më poshtë është paraqitur numri i autorizimeve të lëshuar nga Autoriteti përgjatë viteve 2004 deri 2021:




FIGURA 2. NUMRI I AUTORIZIMEVE TË LËSHUAR NGA AUTORITETI GJATË VITEVE 2004 DERI 2021

4.2. Implementimi i Kodit telefonik 383

ARKEP, gjatë vitit 2021, ka pasur takime të shumta me palët e interesit me qëllim që të intensifikohen përpjekjet për përmbylljen sa më të shpejt të procesit të implementimit të kodit telefonik.

Me qëllim të verifikimit të përbushjes së obligimeve rregullatore, ARKEP gjatë periudhës raportuese ka themeluar komisionin e eksperteve, të cilët kanë bërë matje të ndryshme në territorin e Republikës së Kosovës dhe jo vetëm, me fokus në çështjen e implementimit të kodit telefonik dhe pas verifikimit të gjetjeve dhe inspektimit ka ndër marr masat e parapara me Ligj.

Në ndërkohë, ARKEP edhe gjatë vitit 2021 ka pasur takime të shumta me palët e interesit me qëllim që të krijohen kushtet që sa më shpejtë të përmbyllet procesi i implementimit të kodit edhe nga ‘Telekomi i Kosovës’. Në figurën 3 është paraqitur gjendja sa i përket përdorimit të kodeve shtetërore nga operatorët.




FIGURA 3- GJENDJA E IMPLEMENTIMIT TË KODIT 383 GJATË VITIT 2021

4.3. Implementimi i Marrëveshjes Regjionale të Roamingut (WB6) dhe tarifave të roamingut me shtetet e BE-së

Me qëllim të implementimit të marrëveshjes Regjionale të roamingut (WB6)³, ARKEP edhe gjatë vitit 2021 ka realizuar takime të shumta me operatorët e telefonisë mobile si dhe kanë koordinuar aktivitetet me rregullatorët përkatës në shtetet e rajonit.

Në përmbushje të objektivave të parapara në planin e punës dhe marrëveshjen e arritur, ARKEP gjatë vitit 2021 ka përgatitur dhe miratuar aktet normative si në vijim:

- Rregulloren Nr. 51 për Zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë dhe për Metodologjinë e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së heqjes së Tarifave të Roamingut me Pakicë për Marrëveshjen e Roamingut në mes Shteteve të Ballkanit Perëndimor (BP) ⁴;
- Udhëzuesin e roamingut për operatorët, i cili është bazuar në rekomandimet e BEREC-ut ⁵;
- Udhëzuesin e roamingut për konsumatorët ⁶ së bashku me informatat shtesë, të cilat janë harmonizuar në nivel të shteteve rajonale ⁷.

Nga data 01 Korrik 2021, parapaguesit gjatë qëndrimit në njërin nga vendet e BP nuk do të paguajnë asnjë tarifë shtesë për shërbimet e rregulluara të roamingut (*thirrjet e realizuara ose pranuar, SMS-ët, e dërguar dhe të dhënat/data të shfrytëzuara*), përveç tarifës e cila aplikohet në Republikën e Kosovës (*Roam Like at Home - RLAH*).

Sidoqoftë, pas datës 1 Korrik 2021, operatorët mund të aplikojnë tarifa shtesë për parapaguesit nëse janë të autorizuar për një veprim të tillë ose në rastin kur niveli i konsumimit të të dhënave e kalon volumin e lejuar (*Fair use volume limit*), i cili është i specifikuar në kontratën me parapaguesin shih tabelën në vijim.

TABELA 5. TARIFAT SHITESË- MODELI RLAH

TARIFA SHITESË MAKSIMALE (Pa TVSH) – MODELI RLAH	
Thirrjet e realizuara	0.032 €/minut
Thirrjet e pranuar	0.016 €/minut
SMS të dërguar	0.01 €/SMS
Transferim i të dhënave (Internet)	7.7 €/GB nga data 01 Korrik 2021
	6 €/GB nga data 01 Janar 2022
	4.5 €/GB nga data 01 Janar 2023
	3.5 €/GB nga data 01 Janar 2024
	3 €/GB nga data 01 Janar 2025
	2.5 €/GB nga data 01 Janar 2026

³ Marrëveshja e nënshkruar në mes Ministrive përkatëse nga shtetet: Bosnia dhe Hercegovina, Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, dhe Serbia.

⁴ <http://www.arkep-rks.org/?cid=1,34,1272>

⁵ <http://arkep-rks.org/repository/docs/UDHEZUES%20PER%20OPERATORET%20-%20Tarifat%20e%20Roamingut%20me%20WB6.pdf>

⁶ <http://arkep->

[rks.org/repository/docs/Udhzues%20per%20Konsumatoret%20-%20Tarifat%20e%20Roamingut%20ne%20WB6%20dt.01072021.pdf](http://arkep-rks.org/repository/docs/Udhzues%20per%20Konsumatoret%20-%20Tarifat%20e%20Roamingut%20ne%20WB6%20dt.01072021.pdf)

⁷ <http://arkep-rks.org/repository/docs/FAQ%20-%20Pyetje%20t%C3%AB%20shpeshta%20p%C3%ABr%20roamingun.pdf>

Me qëllim të verifikimit të përmbushjes së obligimeve të operatorëve, ARKEP menjëherë pas hyrjes në fuqi të modelit RLAH, ka ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- 1) Verifikimi i përmbushjes së gjetjeve nga matjet paraprake:
 - 1.1) Obligimet për transparencë, respektivisht informatat që duhet dërguar parapaguesve gjatë kalimit të kufirit dhe hyrjes në njërin nga vendet e Ballkanit Perëndimor (*Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni Veriore, Mal të Zi dhe Serbi*),
 - 1.2) Intervali i faturimit.
- 2) Matjet e shërbimeve të rregulluara të roamingut (*thirrjet e realizuara, thirrjet e pranuar, SMS-ve, si dhe internet/të dhenat*) për rastet:
 - 2.1) Shërbimi Prepaid: Tarifat standarde “Pay as you go” (*tutje referuar si –PYG*);
 - 2.2) Pako me roamingun e përfshirë (*thirrje, SMS dhe DATA*);
 - 2.3) Pako vendore (*thirrje, SMS dhe DATA*).
- 3) Realizimi i testimeve të funksionimit të shërbimeve të roaming në të gjitha pikat ku është prezent operatori ‘mts’ d.o.o., për të verifikuar nëse është e mundur që të ofrohet qasja dhe ofrimi i shërbimeve nga ky operator, për operatorët tjerë të Republikës së Kosovës,
- 4) Realizimi i testimeve në zonat ku nuk ka mubulueshmëri ndërmarrja ‘mts’ D.O.O. për të verifikuar nëse është e mundur qasja në rrjetin e operatorëve vendor duke përdorur SIM kartelën e ndërmarrjes ‘mts’ D.O.O.

Bazuar në gjetjet e konstatuara, ARKEP ka kërkuar që brenda afatit të caktuar të përmbushin të gjitha obligimet e parapara me aktet normative.

Po ashtu gjatë vitit 2021 janë mbajtur gjithsejtë katër (4) takime në nivel ekspertësh të organizuara nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) në bashkëpunim me Komisioni Evropian (KE) dhe vendet e Ballkanit Perëndimor (WB6).

Gjatë viti 2021, është arritur që të finalizohet dokumenti: “*The Roadmap for Lowering Roaming Charges Between the EU and WB*”, i cili synon që të zvogëloj tarifatat në mes shteteve të Ballkanit Perëndimor (BP) dhe BE-së.

Me pjesëmarrjen dhe kontributin e ARKEP është arritur që të merren në konsideratë interesat e operatorëve vendor. Dokumenti krahas tarifave të propozuara me shumicë dhe pakicë, përmban edhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me krijimin e lehtësirave për operatorët dhe zbatimin e rekomandimeve të BE-së.

Për përmbushjen e obligimeve të parapara dhe ecurinë e zbatimit të marrëveshjes rajonale të roamingut, ARKEP raporton në RCC në mënyrë periodike.

4.4. Pjesëmarrja në aktivitetet e BEREC-ut

Edhe gjatë vitit 2021, ARKEP ka marrë pjesë aktive në takimet e Entit të Rregullatorëve Evropian për Komunikimet Elektronike (BEREC), si në nivelin teknik ashtu edhe në atë të Bordit të Rregullatorëve. Stafi profesional i ARKEP aktualisht merr pjesë në kuadër të Grupeve Punuese të ekspertëve në kuadër të BEREC-ut.

TABELA 6. PJESËMARRJE NË GRUPET PUNUESE BEREC

Grupi Punues	Aktiviteti
Fixed Network Evolution (FNE)	BEREC Report on a consistent approach to migration and copper switch-off
	BEREC Opinion on the Review of the Broadband Cost Reduction Directive
	BEREC Input to the European Commission regarding the evaluation and potential review of the EU State Aid Guidelines
Market and Economic Analysis (MEA)	BEREC Report on regulatory treatment for backhaul
	BEREC Report on the Internet Value Chain
	Report on digital platforms Market & Economic analysis (carry-over)
Open Internet (OI)	BEREC report on the implementation of the Open Internet Regulation
	Update to the BEREC Net Neutrality Regulatory Assessment Methodology
	Collaboration on the Net Neutrality Measurement tool
End User (EU)	BEREC study on consumer behavior and attitudes towards Digital Platforms (carry-over)
	Report on how to handle third-party payment charges on mobile phone bills
	End user rights – BEREC opinion foreseen in Article 123 of the EEC
Regulatory Framework (RF)	BEREC Opinion on the national implementation and functioning of the general authorization
	Reports on COVID-19 crisis – lessons learned regarding communication networks for a resilient society
	Post covid measures to close the digital divide - BEREC study
	Stock taking on the national experiences of the implementation of the EECC
Roaming (ROAM)	International Roaming Benchmark Data Report
	Transparency and Comparability of international roaming tariffs
	Inputs to any potential legislative proposals of the EC on roaming
	BEREC Input on the weighted average of maximum mobile termination rates across the EU
	Intra-EU communications Benchmark Report
Remedies (REM)	BEREC Opinion on the Review of the Access recommendation
	Internal Report on the applicability of BEREC's Guidelines for the elaboration of Opinions in Phase II cases
	Internal workshop on Art. 32/33 EECC procedures
	Report on Regulatory Accounting in practice 2021
	BEREC Report on WACC parameters 2021
Statistics and Indicators (SAI)	Report to enable comparable national broadband coverage indicators throughout Europe

	Report on the harmonized collection of data regarding OTT services (carry-over)
	BEREC Guidelines on the consistent implementation of the obligations established in Art 22 (2), 22 (3) and 22 (4) of the EECC (carry-over)
	Report on termination rates at European level
Wireless Network Evolution (WNE)	Peer Review Process
	Workshop on EMF – How BEREC can best promote science-based EMF exposure limits recommended by experts
	Workshop on NRA experiences with 5G
Planning and Future Trends (PFT)	Work on the impact of 5G on regulation (carry-over)
	Developing Work Programme 2022
	BEREC's medium-term strategy for international cooperation
	BEREC's medium-term Strategy for relations with other institutions
5G Cybersecurity (5GCS)	Ad hoc work relating to network security and cybersecurity

Po ashtu ARKEP raporton në mënyrë periodike indikatorët e tregut që kanë të bëjnë me: Roamingun, dhe tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse (FTR) dhe mobile (MTR), të cilat pastaj pas diskutimit në seancat e rregullta plenare publikohen në ueb faqen e BEREC-ut ⁸.

4.5. Menaxhimi i resurseve të fundme – spektrit frekuencor

Spektri i radio-frekuencave që menaxhohen nga ARKEP, përfshin diapazonin e frekuencave 8.3 kHz deri 3000 GHz, ku përmes valëve elektromagnetike përhapen sinjalet në hapësirë pa nevojën e linjave të veçanta. Resurset frekuencore si burim i kufizuar natyror me rendësi publike paraqet një indikator esencial në zhvillimin tregut të komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës në shumë sfera të rëndësishme si: komunikimit pa tela si WiFi ose telefonin Mobile, shfrytëzimi i resurseve të radio komunikimeve në lëmit e transportit aeronautike, hekurudhore dhe tokësore. Shfrytëzimi i resurseve të radio komunikimeve në sistemet e institucioneve të sigurisë së vendit FSK/Ushtria e Kosovës, Policia, KFOR, si në shërbimet PMR ashtu edhe në sistemet e rrjetave mikrovalore, linja MW Point to Point (PTP) në mbështetje të sistemeve të transmetimeve radio difuzive, sigurinë publike, hulumtime, mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë, shkencë, edukim etj.

Resurset frekuencore (*kanalet e radio frekuencave*) menaxhohen duke u bazuar në 'Planin Kombëtar të Radio-frekuencave' dhe 'Planin për përdorimin e radio-frekuencave' (*kanaleve*), plane të harmonizuara komfor politikave kombëtare dhe ndërkombëtare mbi zhvillimin e spektrit të radio-frekuencave si dhe duke zbatuar dispozitat e LKE-s, dhe legjislacionit sekondarë të miratuar nga ARKEP, që është obligim për nxjerrën e rregullave të qarta dhe jo diskriminues në shfrytëzimin e Radio frekuencave.

Në zbatim të Kreut VII të LKE-s, Autoriteti përmes legjislacionit sekondarë e në veçanti nxjerrjes së rregulloreve është angazhuar në vazhdimësi për heqjen e barrierave administrative në procesin e lëshimit të Autorizimeve Individuale për radio frekuencave.

⁸ <https://bereg.europa.eu/eng/document/register/>

Në vitin 2021, ARKEP me qëllim që shfrytëzimi i resurseve frekuencore të jetë sa më efikas është fokusuar në implementimin e teknologjive të reja përfshirë posaçërisht teknologjinë 5G, që tani është duke u aplikuar në shumë vende të zhvilluar të Evropës dhe ka filluar po ashtu edhe në vendet e regjionit.

Zhvillimi i teknologjisë 5G, në vitin 2021, ka pasur zhvillimet më të vrullshme në shfrytëzimin e kapaciteteve frekuencore në brezet 3.4 – 3.8 GHz, kurse në disa vende edhe brezi 26 GHz përderisa brezi 700 MHz në shumë vende të Evropës perëndimore është dhënë në shfrytëzim disa vite më herët. Sa i përket vendeve fqinje dhe disa vendeve të Ballkanit rezulton se është një aktivitet i shtuar i zhvillimit të proceduarve për shfrytëzim të brezeit frekuencore 700 MHz, 3.4-3.8 GHz dhe 26 GHz për ofrimin e shërbimeve të lëvizshme në shfrytëzim të teknologjive 5G.

Në zhvillimin e teknologjisë 5G, si breze më atraktive me kapacitete më të mëdha frekuencore janë treguar brezet :

- 700 MHz (694-790 MHz),
- 3.4 – 3.8 GHz dhe
- 24.25 – 27.5 GHz.

Gjate vitit 2021, ARKEP me kujdes ka shqyrtuar të gjitha rekomandimet dhe vendimet Evropiane për planifikimin dhe shfrytëzimin e resurseve frekuencore në brezet pioniere të teknologjisë 5G. Në brezin 3.4 – 3.8 GHz, ka përgatitur Autorizimin e parë për shfrytëzimin e resurseve frekuencore për qëllime eksperimentale në brezin 3400- 3800 MHz, me qëllim të testimit të teknologjisë 5G në vend.

Autorizimi për shfrytëzimin e radio frekuencave në brezin 3400- 3450 MHz, i është dhënë Universitetit 'UBT' në Shtator të vitit 2021, dhe po këtë vite kemi pasur kërkesë nga Universiteti i Prishtinës për shfrytëzim të kapaciteteve frekuencore në këtë brez, pra 3.6 GHz. Shfrytëzim i kapaciteteve frekuencore është dhënë në zbatimin e teknologjisë 5G, për qëllime eksperimentale shkencore dhe inovative në rrjeta të mbyllura vetëm për nevoja të studentëve dhe stafit profesional të universitetit. Kërkesë e UP-së, "Hasan Prishtina" parashtruar Autoritetit në fund të vitit 2021 është aprovuar në fillim të vitit 2022.

ARKEP mban dhe përditëson rregullisht bazën e të dhënave të spektrit të radio frekuencave që mund të përfshijë një listë të frekuencave të caktuara dhe në dispozicion të gjitha kanaleve të radio frekuencave sipas brezeve dhe përcaktimeve të tyre përmes Autorizimeve individuale të radio frekuencave.

4.5.1. Menaxhimi dhe shfrytëzimi i resurseve të fundme - spektrit radio frekuencore si obligim i LKE-s dhe legjislacionin sekondar

Autoriteti, në përputhje me procedurat dhe kushtet e paraqitura në LKE, menaxhon me resurset e komunikimeve elektronike, dhe përmes Departamentit për Menaxhimin e Frekuencave (DMF), mes tjerash është përgjegjëse për çështjet dhe proceset e përshkruara si më mëposhtme;

- ARKEP në bashkëpunim me ministrinë përgatitë 'Planin Kombëtar të Radio-Frekuencave' dhe punon për harmonizimin e këtij plani me politikat ndërkombëtare mbi zhvillimin e spektrit të radio-frekuencave.
- Përcakton Pagesat për të shfrytëzuar të drejtën e përdorimit të resurseve të komunikimeve elektronike si dhe pagesat tjera në përputhje me obligimet dhe përgjegjësit e vendosura nga LKE dhe aktet tjera juridike.
- Menaxhon resurset e fundme përfshirë spektrin e radio-frekuencave për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike.
- Përgatitë legjislacionin sekondar lidhur menaxhimin e resurseve frekuencore në përgjegjësit dhe obligimet e përcaktuar me LKE, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.
- Përgatitë 'Planin për përdorimin e Radio-Frekuencave' (kanaleve) dhe planet e zhvillimit të radio komunikimit.
- Përmes planit zhvillimor dhe nxite përdorimin efikas të resurseve frekuencore si burime të fundme, në mënyrë që procedurat dhe planet e shfrytëzimit të zbatohen dhe realizohen në atë mënyrë që i jep trajtim të barabartë të gjithë ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike por që duhet të jenë në përputhje me dokumentet standardet dhe rekomandimet ndërkombëtarë në veçanti nga dokumente për çështje të komunikimeve elektronike të përpiluara dhe nxjerra nga institucione ndërkombëtar si CEPT, ECC, ERO dhe ITU.
- Krijimin e bashkëpunimit dhe kordinimit me Komisioni i Pavarur për Media (KPM) dhe me rastin e marrjes së vendimeve në lidhje me licencimin e aktiviteteve transmetuese / ri-transmetuese radio-difuzive sipas obligimeve ligjore KPM konsultohet me Autoritetin për çështjet që kanë të bëjnë me komunikimet elektronike, si dhe me rastin e licencimit KPM njofton Autoritetin, me shkrim për çështjet që kanë të bëjnë me koordinimin e radio-frekuencave (*kanaleve*) të përcaktuara për transmetimet dhe/ose ri-transmetimet radio-difuzive tokësore të programeve radio dhe televizive por Autoritete nuk menaxhon me resurset frekuencore të dedikuara për shërbime Radio difuzeve (Broadcasting) që është në përgjegjësen e KPM.
- Përgatitjen e autorizimeve individuale të frekuencave, duke siguruar shfrytëzim efektiv të spektrit të frekuencave dhe parandalimin e interferencave të dëmshme.
- Përmes legjislacionet sekondarë, Rregulloreve dhe Vendimeve, Autoriteti ka përcaktuar rregulla e qarta për menaxhimin e resurseve frekuencore përfshirë Rregulloret, Udhëzuesit dhe Vendimet që rregullojnë procesit e shfrytëzimit të resurseve frekuencore në mënyrë efektive dhe efikase si dhe mundësojnë konkurrencën e duhur në zhvillimin e komunikimeve elektronike në vend.
- Në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin në fuqi bëhen pranimi dhe shqyrtimin e aplikacioneve dhe kërkesave për shfrytëzimin e resurseve frekuencore nga gjithë ndërmarrësit shfrytëzues të resurse frekuencore.
- Në proceset e detyrave dhe aktiviteteve si në shfrytëzimin efektiv të resurseve frekuencore, planifikimin e brezeve frekuencore dhe zhvillimin e teknologjisë janë rishikuar dhe analizuar shumë Vendime direktive dhe rekomandime Evropiane që kanë të bëjnë me

shfrytëzimin e resurseve frekuencore (*spektrit Frekuencore*) si dhe praktikat e vendeve te ndryshme evropiane dhe regionale ne shfrytëzimin efektiv dhe efikas te resurseve frekuencore si dhe kushtet e përcaktuar teknike ne zbatimin e teknologjisë 5G, në brezet pioniere.

4.5.2. Përlllogaritja e pagesave të rregullta vjetore për radio frekuenca

Për të gjitha Autorizimet Individuale të përgatitura dhe të lëshuara gjatë vitit 2021 (*përveç KFOR-it dhe EULEX-it që janë të liruar nga pagesat*) janë bërë përlllogaritjet e pagesave për shfrytëzim të radiofrekuecave. Gjithsejtë janë bërë njëqind e tetëdhjetë e një (181) përlllogaritje për pagesat e rregullta vjetore dhe taksat administrative. Shuma totale e të gjitha pagesave të kryera gjatë vitit 2021, për shfrytëzim të radio frekuecave është; 1,583,833.49 €, ku sipas shërbimeve renditen si në vijim:

- Aeronautike - 1,625.00 €,
- BWA - 7,200.00 €,
- Fiks - 529,798.29 €,
- IMT - 989,199.73 €,
- PMR - 36,121.95 €, dhe
- Satelitor - 19,888.52 €.

4.5.3. Lëshimi i Licencave për shërbimin Radio Amator nga ARKEP

Në zbatim të Rregullores Nr. 16, për Shërbimet radio amatore në Republikën e Kosovës janë shqyrtuar kërkesat e radio amatorëve vendor dhe ndërkombëtar për t'u licencuar. Gjatë vitit 2021 nga ARKEP-i janë lëshuar nëntë (9) Licenca radio amatore, ku katër (4) janë për radio amatorët vendor dhe pesë (5) janë për radio amatoret ndërkombëtar.

Me Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/89 date; 29.08.2012 është aprovuar shenja e thirrjes 'Z6', për shërbime Radio Amator në tërë hapësirën gjeografikë të Republikës së Kosovës. Mbi bazën e këtij vendimi në përcaktimin e shenjës së thirrjes 'Z6', janë hapur rrugët e zhvillimit të shërbimit Radio Amator në Kosovë, por edhe internacionalizimin e këtij shërbimi duke mbajtur edhe manifestime të ndryshme ndërkombëtare në vend si dhe pjesëmarrje në manifestime ndërkombëtare në vendet të ndryshme Evropiane.

Shoqata e Radio Amatoreve të Kosovës (SHRAK) dhe shërbimet radio amatore në Kosovë tani janë të njohura edhe nga institucionet ndërkombëtare si IARU (*Regjioni i I qe përfshin edhe Evropën*) dhe ARRL (*American Radio Relay League*) Shoqata Kombëtare për Radio Amator në SHBA e themeluar në 1914.

4.5.4. Njoftimet dhe Shqiptimi i masave ndëshkuese

Për rinovimin e Autorizimeve Individuale, një muaj para skadimit të vlefshmërisë së tij, bëhen njoftime të rregullta për të gjithë operatorët. Gjatë vitit 2021 një numër i operatorëve edhe pas skadimit të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual nuk kanë aplikuar për rinovimin e tyre, prandaj pos thirrjeve të rregullta me telefon janë bërë edhe njoftime dhe vërjetje përfundimtare në forme elektronike për rinovimin e tyre, ku janë dërguar rreth tetëmbëdhjetë (18) njoftime dhe vërjetje përfundimtare.

Gjatë vitit 2021 janë shqiptuar masat ndëshkuese për trembëdhjetë (13) operatorë dhe shuma totale e këtyre masave sanksionuese është: 93,299.76 Euro.

4.5.5. Zënshmëria e brezit frekuencor 26 GHz, (24.5 - 26.5 GHz) dhe zhvillimet e shërbimeve te radio komunikimit ne këtë brez.

Me qëllim që brezi frekuencor 26 GHz (24.25 - 27.5 GHz) në të ardhmen të mund të shfrytëzohet nga operatorët për komunikime mobile në gjeneratën 5G, është analizuar zënshmëria e brezit frekuencor 26 GHz (24.5 - 26.5 GHz) sipas Rekomandimit T/R 13-02, i cili aktualisht shfrytëzohet për shërbimin linjave fikse (PtP). Duke u bazuar në Vendimin ECC/DEC/(18)06, brezi i frekuencave 24.25 - 27.5 GHz është paraparë që të shfrytëzohet për shërbimin MFCN (Mobile/Fixed Communication Networks) me ndarje duplekse kohore TDD (Time Division Duplex). Shpërndarja e këtij brezi mund të bëhet në blloqe me gjerësi të brezit të frekuencave prej 16 x 200 MHz.

Kur krahasohen ndarjet e kanaleve sipas Rekomandimit T/R 13-02, për shërbimin fikse dhe Vendimin ECC/DEC/(18)06 për shërbimin MFCN - 5G, shihet mundësia e shfrytëzimit të këtij brezi për shërbime Fikse dhe shërbime Mobile. Prandaj nga zhvillimi i shërbimeve mobile dhe posaçërisht nga zhvillim i teknologjisë 5G, do të procedohet me aktivitetet për lirimin e këtij brezi nga shërbimet Fikse dhe planifikim/përcaktim i këtyre resurseve frekuencore për shërbime mobile.

Brezi 26 GHz rangu 24.25 - 27.5 MHz > I përcaktuar për shfrytëzim ne zbatim te teknologji 5G																
Brezi 24.25 – 26.5 GHz											26.5 -27.5 GHz – Menaxhim nga KFOR					
11 Blocks x 200 MHz = 2200 MHz											5 Blloqe frekuencore x 200 MHz					
24250	24300	24500	24700	24900	25100	25300	25500	25700	25900	26100	26300	26500	26700	26900	27100	27300
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	1	2	3	4	5
	1 x 200 MHz	Ne shfrytëzim nga Operatori IPKO për Linçe MW – P-P						4 Blloqe x 200 MHz - 800 MHz kapacitet te lira - ne dispozicion				200 MHz	200 MHz	200 MHz	200 MHz	200 MHz
GB	200 MHz	2450 - 2570 MHz = 1200 MHz						200 MHz	200 MHz	200 MHz	200 MHz	1000 MHz				

FIGURA 4. BREZI FREKUENCORE 26 GHZ NE RANGUN 24.25 – 27,5 GHZ, ZËNSHMËRIS E TIJ ME SHËRBIME FIKSE PTP DHE KAPACITET E LIRA PËR SHFRYTËZIM PËR TEKNOLOGJINË 5G.

4.5.6. Autorizimet individuale për shfrytëzuesit e resurseve frekuencore

Gjatë vitit raportues 2021, Autoriteti ka lëshuar gjithsej njëqind e shtatëdhjetë e nëntë (179) Autorizime Individuale, për shfrytëzuesit e spektrit/kanaleve radio-frekuencore me rreth 1850, kanaleve frekuencore. Kjo performancë është realizuar përmes procedimit me sukses të kërkesave dhe aplikacioneve të shfrytëzuesve të radio frekuencave si dhe planin e mbikëqyrjes efikase të regjistrimeve të të dhënave (*shënimeve*) të administruara në softuerët e menaxhimit të spektrit frekuencore dhe bazën e të dhënave teknike dhe administrative të Autoritetit.

Ndër shërbimet më të rëndësishme të autorizuara për shfrytëzim të spektrit radio-frekuencor janë:

- Shërbimet radio të lëvizshme profesionale RLP (*PMR – Professional Mobile Radio*);
- Shërbimet fikse mikro-valore PTP (*Pikë – Pikë/Point To Point*);
- Shërbimet TETRA (*Terrestrial Trunked Radio*)
- Shërbimet aeronautike;
- Shërbimet satelitore përfshirë edhe VSAT (*Very Small Aperture Terminal*).
- Shërbimet Radio Amatore.

Të dhënat e përshkruara dhe prezantuara në vijim paraqesin llojet e Autorizimeve Individuale të radio frekuencave (licencave), numrin e operatorëve në shfrytëzim të brezeve frekuencore dhe numrin e kanaleve frekuencore të autorizuara nga Autoriteti gjatë vitit 2021.

Duke marrë në konsideratë se një operator mundë të ketë më shumë se një Autorizim individual për shfrytëzimin e resurseve frekuencore, si dhe disa Autorizime individuale mundë të lëshohen edhe për periudhe kohore më të gjatë se një (1) vit deri në katër (4) vite rezulton se numri i autorizimeve dhe operatorëve është i ndryshëm.

TABELA 7: REGJISTRI I AUTORIZIMEVE INDIVIDUALE PËR FREKUENCA GJATË VITIT 2021

Nr.	LLOJI I AUTORIZIMEVE INDIVIDUALE TE RADIOFREKUENCAVE (LICENCËS)	Numri i Autorizimeve individuale te radio frekuencave lëshuar ne vitin 2021
1	Autorizime Individuale te Radio frekuencave (Licenca) për shërbime ne brezin frekuencore HF (9 kHz deri 30 MHz)	14
2	Autorizime Individuale te Radio-frekuencave për shërbimin PMR (brezi 156-174 MHz) VHF	49
3	Autorizime Individuale te Radio-frekuencave për shërbimet PMR ne breze te përbashkëta (156-174 MHz) VHF & (442-470 MHz) UHF	8
4	Autorizime Individuale te Radio-frekuencave për shërbimet PMR (brezi 442-470 MHz) UHF	71
5	Autorizime Individuale te Radio-frekuencave për shërbimet PMR ne breze te përbashkëta HF (9 kHz deri 30 MHz), (156-174 MHz) VHF & (442-470 MHz) UHF	1
6	Autorizime Individuale te Radio-frekuencave e shërbimeve fikse Mikrovalore brezi > 1 GHz (SHF)	28
7	Autorizime Individuale te Radio-frekuencave për shërbime te Aeronautikës	3
8	Autorizime Individuale te Radio-frekuencave për shërbime Satelitore	5
	Gjithsej: Autorizime Individuale të Radio frekuencave	179

Tabela në vijim paraqet numrin e gjitha kanaleve të dhëna në shfrytëzim përgjatë vitit 2021.

TABELA 8: NUMRI I KANALEVE TE RADIO-FREKUENCAVE SIPAS SHËRBIMEVE GJATË VITIT 2020

Nr.	Lloji i Shërbimit	Numri i Kanaleve
1	Shërbimi Fiks mikrovalore (Linçe Fikse Mikrovalore Pikë - Pikë - PTP)	876
2	Shërbimi PMR (Private Mobile Radio)	942
4	Shërbimi Satelitor	8
5	Shërbimi Aeronautike	24
	TOTALI	1850

Më poshtë janë prezantuar numri i autorizimeve sipas shërbimeve dhe të dhënat tjera si më të rëndësishme që përfshijnë këto autorizime.

TABELA 9: LLOJET E SHËRBIMEVE, NUMRI I KANALEVE DHE I AUTORIZIMEVE GJATE 2021

LLOJI I SHËRBIMIT	NUMRI I KANALEVE FREKUENCORE
PMR	942
FIKS	876
SATELITOR	8
AERONAUTIK	24
Numri total i kanaleve	1850

LLOJI I SHËRBIMIT	NUMRI I AUTORIZIMEVE
PMR	143
FIKS	28
SATELITOR	5
AERONAUTIK	3
Numri total i Autorizimeve	179





FIGURA 5: NUMRI TOTAL I KANALEVE DHE AUTORIZIMEVE INDIVIDUALE TË RADIO FREKUENCAVE SIPAS SHËRBIMEVE

Numri i autorizimeve të lëshuar për shfrytëzimin e radio Frekuencave të klasifikuar sipas brezeve frekuencore.

TABELA 10. NUMRI I AUTORIZIMEVE TE LËSHUARA 2021 SIPAS BREZEVE FREKUENCORE DHE MENYRA E OPERIMIT,

BREZI FREKUENCOR	NUMRI I AUTORIZIMEVE	MENYRA E OPERIMIT	NUMRI I KANALEVE
HF	14	SIMPLEKSE	763
VHF	52	GJYSEM – DUPEKSE	227
UHF	71	DUPEKSE	860
VHF & UHF	9	Numri total i kanaleve frekuencore	1,850
SHF	33		
Numri total i autorizimeve	179		




FIGURA 6: NUMRI I AUTORIZIMEVE INDIVIDUALE TE RADIO FREKUENCAVE SIPAS BREZEVE FREKUENCORE

4.5.7. Modulet Softuerike për Menaxhimin e Spektrit Frekuencore

ARKEP tani e njëmbëdhjete (11) vite, që nga viti 2009 posedon dhe shfrytëzon Softuerin për menaxhimin e spektrit frekuencore, një produkt i kompanisë së njohur në lëmin e telekomunikacionit 'LS Telcom AG' me seli në Lichtenau/Germany.

Ky sistem i Avancuar softverik dhe profesional për menaxhimin e spektrit frekuencave që DMF shfrytëzon në kuadër të ARKEP përbëhet nga katër (4) module softuerike dhe një nën-Modul funksional në kuadër të Modulit SPECTRAplus;

1. SPECRAplus
2. APEX (Application Express)
3. SPECTRAplan
4. SPECRAemc dhe
5. MONIORplus

Modulet e avancuar softuerike për menaxhimin e spektrit frekuencore paraqesin veglat e profesionale në punët e përditshëm që mundësojnë regjistrimin e të dhënave teknike dhe Administrativë të çdo shfrytëzuesi të radio Frekuencave në Kosove. Përmes këtij Sistemi softuerike

dhe moduleve të tij mundësohet mbajtja e një data bazë me saktësi të lartë teknike, përpunimi i tyre, analizat spektrale që mundësojnë përcaktimet e kanaleve frekuencore për shfrytëzim efektiv dhe efikas spektrit frekuencore (*pa interferenca*), llogaritjen automatike të pagesave për radio frekuenca për shërbime Fikse, MW-PtP dhe PMR si dhe planifikime të brezeve frekuencore në përputhje me dokumentet dhe rekomandimet evropiane për radio frekuenca.

4.5.8. Koordinimi dhe harmonizimi i shfrytëzimit të J6-KFOR - ARKEP

Koordinimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet ARKEP dhe KFOR-J6, është i domosdoshme dhe mjaft i dobishëm dhe shpesh i përcjelle me sfidat te caktuara, si ne përcaktimet e kanaleve frekuencore sipas standardit Evropian ashtu edhe ne ndarjen e brezeve për shfrytëzim për qëllime civile dhe ushtarake (*Militare*). Duhet pasur parasysh që ne kudër të KFOR përfshihet ushtria amerikane e vendosur në ‘Bondsteel’ dhe koordinimi i shfrytëzimit të resurseve frekuencore me standarde Amerika dhe Evropiane ne raste të veçanta paraqet sfida komplekse ne sistemin rregullatorë prandaj deri me tani me suksese e kemi menaxhuar duke shfrytëzuar ne mënyrë efektive resurset frekuencore, ruajtjen e raportit të ndërsjellët ne mes KFOR-J6 dhe ARKEP.

Duhet të kemi të njohur se breza të caktuar frekuencore menaxhohen nga KFOR për qëllime ushtarake dhe disa breza janë po ashtu ne përcaktuara ne shfrytëzim të përbashkët civile Ushtarake/Civile por që prioritet ka shërbime ushtarak varësisht nga nevoja e shfrytëzimit dhe sistemeve të sigurisë së komunikimeve të kontingjenteve të KFOR.

Bashkëpunimi dhe harmonizimi i shfrytëzimit të resurseve frekuencore zhvillohen gjatë tërë viti 2020. Sipas nevojës zhvillohen takime të rregulla dy palese ne raste të veçanta edhe takime shume palese ku prezantojnë edhe institucione tjera siç janë Agjencioni i Navigacionit Ajror (ASHNA), Autoritetit të Aviacionit Civil, UNMIK, KPM dhe KFOR.

Si rezultat i këtyre takimeve të ndërsjella dhe pas disa takimeve të njëpasnjëshme me përfaqësuesit e KFOR-J6, është arritur të vendoset kontakti me Organizatën e Aviacionit Civil (ICAO) që është një agjenci e specializuar për të menaxhuar administrimin dhe qeverisjen e Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar dhe ne kuadër të saj edhe menaxhimin e brezeve frekuencore që janë të përcaktuara për shërbime Aeronautike..

Gjatë vitit 2021 ne kërkesat dhe aplikacionet që KFOR ka parashtruar për shfrytëzim të radio frekuencave përmes Departamentit të Frekuencave ARKEP ka lëshuar njëzet e dy (22) Autorizime individuale të radiofrekuencave për KFOR dhe ka pranuar nga KFOR gjashtë (6) aprovime të shfrytëzimit të resurseve frekuencore nga Brezet që menaxhohen nga KFOR, të cilat pasta ARKEP i ka Autorizuar të operatorët dhe ndërmarrësit Civil të shfrytëzimit të Radio frekuencave.

4.5.9. Koordinimi dhe bashkëpunimi i ARKEP me KPM.

Koordinimin dhe bashkëpunim i ARKEP me KPM ka pasur kontinuitetin e tij edhe gjatë vitit 2021.

Gjatë vitit 2021 është realizuar lirimi i brezit 800 MHz, në bazë të memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar me Komisionin e Pavarur për Media (KPM). Me 17.12.2021 pas koordinimeve dhe takimeve bilaterale të stafit profesional të ARKEP dhe KPM është arritur memorandum i mirëkuptimit ndërmjet këtyre dy institucioneve mjaft i rëndësishëm duke hapur rrugë ARKEP-it për zhvillimin e shërbimeve mobile dhe fillimin e procesit të dhënies së shfrytëzimit të resurseve frekuencore të brezit 800 MHz rangui 790 – 862 MHz, për operatorët e telefonisë mobile.

Në bazë të këtij memorandum, brezi 800 MHz prej datës 01.01.2022 është liruar nga TV transmetuesit radio-difuziv, duke i hapur rrugë shfrytëzimit të tij për shërbime mobile. Ky brez u ofron operatorëve nacional të telefonisë mobile kapacitetet e nevojshme për shtrirjen e rrjetave MFCN, duke mundësuar kështu rritjen e kualitetit dhe kuantitetit të shërbimeve të telefonisë mobile në vend por edhe zbatimin e teknologjisë 5G;

Koordinimi dhe Analiza për gjendjen e TV transmetuesve në prag të Ri-licencimit është një nga çështjet e rëndësishme në shqyrtimet ndërmjet ARKEP dhe KPM. Mundësia që të gjithë transmetuesit si ata nacional dhe lokal që shfrytëzojnë kanalet transmetues në njërin nga brezet frekuencore 800 MHz dhe 700 MHz, të zhvendosen në brezin 470 -694 MHz, të paraparë edhe me Rekomandimet dhe Vendimet Evropiane për shfrytëzim për Shërbime Radio difuzive, dhe të mundësohet dhënia në shfrytëzim për shërbime Mobile në shtrirjen e rrjetave të teknologjive 4G dhe 5G në brezet e lartë cekura.

Bashkëpunim ndërmjet ARKEP dhe KPM është fokusuar kryesisht për planet dhe masat për vënien në dispozicion të brezit frekuencore 800 MHz (DD1) dhe brezit frekuencore 700 MHz (DD2) për shërbime mobile, por edhe në bashkëpunimin në eliminimin e interferencave që janë mjaft të shprehura në shërbime të ndryshme ndër të tjera, interferencat e radio transmetuesve difuzive të brezit 87.5 deri 100 MHz, në sistemet e transmetimit të shërbimeve Aeronautike në brezin 110 - 137 MHz.

4.6. Autorizimet (vendimet) për shfrytëzimin e resurseve numerike

Më datë 10 Mars, 2021, ARKEP ka miratuar Planin e ri të Numeracionit⁹, ku me këtë rast janë ulur edhe pagesat vjetore për operatorët në masë të konsiderueshme (shih tabelën në vijim).

TABELA 11. PLANI I NUMERACIONIT DHE ULJES SË SË PAGESËS VJETORE

Gjeografik/Fiks dhe Nomadik (2x, 3x dhe 7x)	Mobil (4x)	Shërbime të veçanta (8x)	Premium Rate (9x)	MNC	ISPC	VAS SMS (5x)	NSPC
0.025 €	0.04 €	15 €	60 €	900 €	200 €	15 €	50 €

Gjatë vitit 2021, sipas rekomandimeve të Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE) janë nxjerr mbi njëqind e tridhjetë (130) vendime administrative për caktim e resurseve numerike, në varësi të llojit të shërbimit, të cilat janë paraqitur në tabelën në vijim.

⁹<http://www.arkep-rks.org/?cid=1,48>

TABELA 12: RESURSET NUMERIKE TË CAKTUARA / REZERVUARA GJATË VITIT 2021

Seria	Lloji i shërbimit	Numrat e caktuar/rezervuar
1x	Kodet e qasjes dhe kodet e shkurta	1
5x	Kodet e shkurta për ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar	26
8x	Numeracioni jo gjeografik për shërbime të veçanta	146
9x	Numeracioni jo gjeografik për shërbime me çmim të lartë	5
Totali i numrave të caktuar/rezervuar		178

Në ueb faqen e Autoritetit, linkun; <http://arkep-rks.org/?cid=1,50> mund të shkarkohet i gjithë regjistri i numeracionit të caktuar (*ndarë*), përkatësisht rezervuar nga Autoriteti deri në datën e azhurnimit (*përditësimit*) të saj.

Në figurat në vijim është paraqitur numeracioni në dispozicion për rrjetet e telefonisë fikse dhe mobile.




FIGURA 7. NUMERACIONI NË DISPOZICION PËR RRJETET MOBILE




FIGURA 8: NUMERACIONI NË DISPOZICION PËR RRJETET FIKSE

4.7. Monitorimi i kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike

Gjatë vitit 2021 janë realizuar matje të parametrave të kualitetit të shërbimeve (QoS) të komunikimeve elektronike në tërë Kosovës, me theks tek shërbimet mobile të qasjes në internet (3G dhe 4G) për operatorët ofrues të këtyre shërbimeve në Kosovë, Telekom i Kosovës Sh.A. dhe IPKO Telecommunications LLC.

Nga mbi 4500 testime të bëra në tërë Kosovën për shërbimin e qasjes mobile në internet përmes teknologjisë 3G dhe 4G, operatori Telekom i Kosovës ka shënuar këto rezultate:

TABELA 13: TESTIMET E REALIZUARA TË OPERATORIT TELEKOMI I KOSOVËS

Telekomi i Kosovës			
Teknologjia	Shpejtësia minimale	Shpejtësia maksimale	Shpejtësia mesatare
4G	4.56Mbps	55.06Mbps	9.26Mbps
3G	0.16Mbps	7.3Mbps	1.82Mbps

Nga afro 5000 testime të bëra në tërë Kosovën për shërbimin e qasjes mobile në internet përmes teknologjisë 3G dhe 4G, operatori ipko ka shënuar këto rezultate:

TABELA 14. TESTIMET E REALIZUARA TË OPERATORIT IPKO

IPKO			
Teknologjia	Shpejtësia minimale	Shpejtësia maksimale	Shpejtësia mesatare
4G	8.6Mbps	57.3Mbps	17.0Mbps
3G	0.86Mbps	9.92Mbps	3.12Mbps

Për shërbimet e zërit/thirrjeve që realizohen përmes telefonisë mobile dhe fikse të operatorëve Telekom i Kosovës dhe IPKO, kemi këto vlera të raportuara nga operatorët për vitin 2021 për parametrat e kualitetit të shërbimeve të thirrjeve:

TABELA 15. TESTIMET E REALIZUARA TË OPERATORIT TELEKOMI I KOSOVËS DHE IPKO

Paramteri	TELEKOMI I KOSOVES		IPKO	
	Mobile	Fiks	Mobile	Fiks
	Vlera		Vlera	
Koha e vendosjes së thirrjes	<6 sekonda	<2.5 sekonda	<5.38 sekonda	<14.5 sekonda
Përqindja e thirrjeve të dështuara	<1.5%	<0.07%	<2.48%	<11.3%
Kualiteti i zërit gjatë thirrjes	>3.8 (nga 1-5)	>3.2 (nga 1-5)	>3.98 (nga 1-5)	>3.99 (nga 1-5)

Shërbimet tjera të cilat i monitoron ARKEP në kuadër të rregullimit të kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike është edhe shërbimi i direktoriumit publik dhe shërbimit të operatorit

(*ndihmës ndaj klientëve në rast të defekteve teknike*). Në vijim mund të gjeni vlerat kualitetit të këtyre shërbimeve të matura dhe realizuara gjatë vitit 2021 për operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO.

TABELA 16. TESTIMET E REALIZUARA TË OPERATORIT TELEKOMI I KOSOVËS DHE IPKO

Telekomi i Kosovës		IPKO	
Paramteri	Vlera	Paramteri	Vlera
Koha mesatare e përgjigjes së operatorit	<15.7 sekonda	Koha mesatare e përgjigjes së operatorit	<38.8 sekonda

4.7.1. Rezultatet e kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike për tri vitet e fundit

Më poshtë është paraqitur një përmbledhje e rezultateve të kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike për tri (3) vitet e fundit 2019, 2020 dhe 2021, respektivisht për shërbimin e qasjes në internet 4G/LTE dhe shërbimin e zërit/thirrjeve për telefoninë mobile për operatorët Telekom i Kosovës dhe IPKO.

4.7.2. Shpejtësia e shkarkimit/download për teknologjinë 4G/LTE për operatorin Telekom i Kosovës

Më poshtë mund të gjeni rezultatet e matjeve të bëra nga ARKEP për parametrat e kualitetit të shërbimeve të qasjes mobile në internet për teknologjinë 4G/LTE për operatorin Telekom i Kosovës për 2019, 2020 dhe 2021.




FIGURA 9. SHPEJTËSIA MESATARE NË SHKARKIM/DOWNLOAD E TELEKOM PËR 4G/LTE

4.7.3. Kualiteti i shërbimit të zërit/thirrjeve të telefonisë mobile të Telekom i Kosovës

Më poshtë mund të gjeni rezultatet e kualitetit të shërbimeve të zërit/thirrjeve të telefonisë mobile për operatorin Telekom i Kosovës sipas raportimeve të bëra nga Telekom i Kosovës gjatë viteve 2019,

2020 dhe 2021, për parametrin e raportit e thirrjeve të dështuara, kohës së vendosjes së thirrjeve dhe kualitetit të zërit/thirrjes.




FIGURA10. RAPORTI I THIRRJEVE TË DËSHTUARA DHE KOHA E VENDOSJES SË THIRJES




FIGURA 11. KUALITETI I ZËRIT/THIRRJEVE (1-5)

4.7.4. Shpejtësia e shkarkimit/download në teknologjinë 4G/LTE për operatorin IPKO

Më poshtë mund të gjeni rezultatet e matjeve të bëra nga ARKEP për parametrat e kualitetit të shërbimeve të qasjes mobile në internet për teknologjinë 4G/LTE për operatorin IPKO për 2019, 2020 dhe 2021.




FIGURA 12. SHPEJTËSIA MESATARE NË SHKARKIM/DOWNLOAD E IPKO PËR 4G/LTE

4.7.5. Kualiteti i shërbimit të zërit/thirrjeve të telefonisë mobile të IPKO

Më poshtë mund të gjeni rezultatet e kualitetit të shërbimeve të zërit/thirrjeve të telefonisë mobile për operatorin IPKO sipas raportimeve të bëra nga IPKO gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021, për parametrin e raportit e thirrjeve të dështuara, kohës së vendosjes së thirrjeve dhe kualitetit të zërit/thirrjes.




FIGURA 13. RAPORTI I THIRRJEVE TË DËSHTUARA DHE KOHA E VENDOSJES SË THIRRJES




FIGURA 14. KUALITETI I ZËRIT/THIRRJEVE (1-5)

4.7.6. Analiza e tregjeve relevante, implementimi i detyrimeve rregullatore dhe mekanizmave për sigurimin e konkurrencës efektive

ARKEP gjatë vitit 2021, ka mbikëqyrur në mënyrë efektive detyrimet e vëna për Operatorët me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT), ka realizuar takime edhe me insitucione tjera lidhur me temat e konkurrencës dhe rregullimin e tregut.

Gjatë vitit 2021 është zhvilluar analiza e tregjeve të qasjes lokale me shumicë të ofruara në një vendndodhje fikse (tregu 3a) dhe qasja e centralizuar me shumicë në vendndodhjen fikse për produktet e tregut masiv (tregu 3b). Rezultatet e dala nga kjo analizë, tregojnë se ekziston një konkurrencë efektive në këto dy tregje dhe rekomandimet janë që të bëhet derregullimi i këtyre tregjeve.

Gjithashtu është iniciuar edhe procesi i rishikimit të Rregullores për Bartshmërinë e numrave ashtu që të merren parasysh zhvillimet e fundit teknologjike dhe praktikat me të mira ndërkombëtare, në aspektin e implementimit. Me këtë projekt synohet rritja e konkurrencës në treg duke iu mundësuar konsumatorëve ruajtjen e numrit gjatë ndërrimit të ofruesve të shërbimeve të telefonisë fikse dhe mobile.

4.7.7. Raportimet periodike

Në përputhje me procedurat e përcaktuara me Rregulloren për të dhënat statistikore të operatorëve (Ref. Nr.Prot.048/B/11), ARKEP gjatë vitit 2021 ka publikuar gjithsej katër (4) raporte periodike në baza tremujore me indikatorët kryesor të tregut të komunikimeve elektronike, të cilat janë publikuar në ueb faqen e ARKEP: <http://www.arkep-rks.org/?cid=1,162>.

4.8. Mbrojtja e të drejtave të konsumatorit dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mes operatorëve

a) Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve

Aktivitetet rregullatore të Autoritetit mes tjerash shërbejnë edhe për të arritur dhe jetësuar parimet bazë ligjore dhe rregullatore si dhe objektivat e ndërlidhura me përdoruesit eshërbimeve telekomunikuese dhe postare në mënyrë që shfrytëzuesit fundor (konsumatorët), përmes inkurajimit të konkurrencës efektive, tu sigurohen shërbime sa më kualitative dhe përfitimet sa më të mira të mundshme në aspektin e çmimeve, të përzgjedhjes dhe cilësisë së shërbimeve.

Promovimi i interesave të përdoruesve arrihet në mënyrë të veçantë me anë të procedurave të mëposhtme;

- sigurimit të qasjes në shërbimet telekomunikuese dhe postare për të gjithë përdoruesit;
- siguruar qasje të lehtë dhe të garantuar dhe procedura të thjeshta për zgjidhjen e kontesteve në mes operatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve;
- nxitjen dhe promovimin e informacioneve të qarta, në veçanti ndërlidhur me transparencën e çmimeve dhe kushtet për përdorimin e shërbimeve publikisht në dispozicion;
- siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatisë; dhe
- angazhuar në krijimin e parakushteve për sigurimin e qasjes dhe shërbimeve të përshtatshme për nevojat e grupeve të veçanta shoqërore, në mënyrë të veçantë referuar përdoruesve me aftësi të kufizuara.

Gjate vitit 2021 janë pranuar gjithsej dyqind e dyzet e dy (242) ankesa të konsumatorëve ndaj operatorëve në lidhje me ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare. ARKEP i ka trajtuar të gjitha këto duke u dhënë përgjigje dhe udhëzime përkatëse.

Pas shqyrtimit të ankesave Autoriteti ka dhënë rekomandime dhe sipas bazueshmërisë së ankesës një numër i konsiderueshëm i përdoruesve fundor (*konsumatorëve*) është kompensuar nga operatorët.

Autoriteti, ka vazhduar edhe më tutje të mbikëqyrë zbatimin e rregulloreve përkatëse lidhur me të drejtat e përdoruesve fundor (*konsumatorëve*).

ARKEP ka në dispozicion numrin (0)800 10 100, i cili është PA PAGESË për parashtrimin e ankesave të përdoruesve fundor (konsumatorëve).

b) Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet operatorëve të rrjeteve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pranuar asnjë kërkesë për zgjidhje të mosmarrëveshjes në mes operatorëve. Sidoqoftë, ARKEP përmes rregullimit ex-ante, të tregut të komunikimeve elektronike në vazhdimësi është duke krijuar një ambient të përshtatshëm për zhvillim të aktiviteteve dhe hyrësit e rinj në treg.

4.8.1. Proceset Gjyqësore

Në aspektin e proceseve gjyqësore, përgjatë vitit 2021 kryesisht janë trajtuar lëndë gjyqësore të cilat janë iniciuar dhe zhvilluar ndër vite. Procese të fituara në vitin 2021 janë:

1. Aktgjykim AA nr.66-2021, (ARKEP Ref. Nr. 195/2/21 dt: 24.06.2021);
2. Aktgjykim AA nr.313.2019, (ARKEP Ref. Nr. 175/2/21 dt: 07.06.2021);
3. Aktgjykim ARJ NR. 76.2021, (ARKEP Ref. Nr. 253/2/21 dt: 30.08.2021);
4. Aktgjykimi Rev. E. Nr. 84/2020, (ARKEP Ref. Nr. 308/2/21 dt; 08.10.2021).

4.8.2. Sanksionet Ekonomike

ARKEP me qëllim të mbikqyrjes së tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, si masë të fundit ka shqiptuar sanksionet ekonomike për mos zbatim të Ligjit të Komunikimeve Elektronike dhe Ligjit për Shërbimet Postare si në vijim:

- Për ofruesit e rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike janë shqiptuar gjithsejtë katërbëdhjetë (14) sanksione ekonomike në shumë prej; 2,800.00 €, për mos raportin të pasqyrave financiare;
- Për ofruesit e shërbimeve dhe shfrytëzuesit e radio frekuencave janë shqiptuar gjithsejtë dymbëdhjetë (12) sanksione ekonomike në shumë prej; 93,337.90 €, për mos renovim të autorizimit për të drejtën e shfrytëzimit të radio frekuencave;
- Për ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shfrytëzuesve të resurseve numerike janë shqiptuar dyzet (40) sanksione ekonomike në shumë; 2,550.00 €;
- Për ofruesit e shërbimeve postare janë shqiptuar nëntë (9) sanksione ekonomike në shumë prej 1,800.00 €, për mos raportim të pasqyrave financiare, si dhe
- Për mos zbatim të vendimeve të ARKEP janë shqiptuar dymbëdhjetë (12) snaksione në vlerë; 60,000.00 €.

4.9. Radio monitorimi dhe Inspektimi i spektrit frekuencor

Departamenti i Radio Monitorimit dhe Inspektimit (DRMI) me qëllim të përmbushjes së detyrave lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e shfrytëzimit të spektit Radio-frekuncor nga operatorët e autorizuar dhe në përputhje me Ligjin për Komunikimet Elektronike, në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit 2021, ka kryer monitorime në terren. Monitorimet janë realizuar me qëllim të verifikimit të përmbushjes së kushteve të përgjithshme teknike si të përcaktuara me Autorizime të Përgjithshme dhe Individuale për operatorët e autorizuar nga ARKEP.

DRMI, ka monitoruar brezet frekuencore të alokuara bazuar në Planin Kombëtar të Shpërndarjes dhe Shfrytëzimit të Spektrit Radio Frekuencor dhe ka mbajtur të informuar në vazhdimësi Departamentin e Menaxhimit të Frekuencave lidhur me shfrytëzueshmerine e këtyre brezeve.

Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit 2021 në kuader të monitorimit/mbikëqyrjes së përdorimit të spektrit radio frekencor janë:

- Monitorimi dhe kontrolli i parametrave teknik të stacioneve transmetues;
- Detektimi, identifikimi dhe lokalizimi i transmetueseve të pa-autorizuar;
- Identifikimi dhe eliminimi i interferencave;
- Matja me qellim të verifikimit të mbulueshmerise me sinjal të telefonisë mobile për teknologjitë GSM, UMTS dhe LTE në tërë territorin e Kosovës;
- Mbikëqyrja e zbatimit të Rregullores Teknike për Radio Pajisje

Gjatë vitit 2021, DRMI ka kryer monitorime të rregullta dhe specifike të spektrit radio frekuncor në tërë territorin e Republikës së Kosovës në përputhje me planin e punës, duke shfrytëzuar kapacitetet profesionale si dhe ato teknike që aktualisht ka në dispozicion. Numri i përgjithshëm i daljeve/matjeve të realizuara në teren gjatë vitit 2021 është gjithsejtë; gjatëdhjetë e pesë (65), prej tyre janë:

- Njëzet e pesë (25) matje në brezet frekuencore 900/1800 dhe 2100 MHz, breze këto në shfrytëzim nga operatorët e autorizuar të telefonisë mobile për teknologjitë 2G/3G dhe 4G (mbulueshmëri dhe interferenca),
- Katërbëdhjetë (14) matje në brezet frekuencore VHF dhe UHF për shërbimet PMR (*verifikim i kanaleve frekuncore dhe interferenca*).
- matje në brezin SHF për shërbimet PTP,
- tetë (8) matje në teren lidhur me përmbushjen e kushteve të percaktuara në marrëveshjet teknike me shtet fqinje;
- Gjashtëbëdhjetë (16) matje për Interferenca në breze të ndryshme frekuencore.

Të gjitha kontrollet dhe monitorimet e kryera të spektrit radio frekuncor janë realizuar në përputhje të plotë me Rekomandimet relevante ndërkombëtare të ITU-R dhe CEPT.

DRMI gjatë vitit 2021 ka realizuar;

- Monitorimin dhe Inspektimin e shërbime PMR në brezet frekuencore VHF dhe UHF në tërë territorin e Republikës së Kosovës, verifikimin e shfrytëzimit të spektrit frekuncor nga subjektet ekzistues, të rinj dhe ata që kanë deklaruar ndërprerjen e aktivitetit, duke mundësuar në këtë mënyrë edhe përditësimin e bazës së të dhënave të disponuar dhe administruar nga Autoriteti.
- Identifikimin dhe eliminimin e interferencave të shkaktuara në brezet frekuncore të alokuara për operatorët e Autorizuar,
- Monitorimin e shfrytëzueshmërisë së resurseve të kufizuara frekuencore, me kujdes të veçant ka bërë mbikëqyrjen e vazhdueshme të implementimit të Marrëveshjes së Telekomunikacionit të arritur në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e BE-së. Në kuadër të saj ka vazhduar mbikëqyrja e plotë e përdorimit të spektrit frekuncor për operatorin e përkohshëm ‘mts’ D.O.O, i autorizuar për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile nën infrastrukturën e kufizuar.
- Monitorimin e shfrytëzueshmërisë së brezeve frekuencore SHF (*Point to Point*) në përdorim nga operatorët e autorizuar.
- Shqyrtimin e të gjitha kërkesave nga kompanitë e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare
- lidhur me vendosjen e Radio Pajisjeve në tregun e Kosovës, në përputhje me Rregulloren Teknike për Radio Pajisje.

4.9.1. Ngritja e Sistemit Kombëtar për Monitorimin e Spektrit Frekueuncor

Gjatë vitit 2021 ka filluar implementimi i projektit Sistemi Nacional për Monitorimin e Spektrit Frekuencor (SNMS) me rëndësi të veçantë për ARKEP, projekt ky që është duke u implementuar edhe me ndihmën e Ministrisë së Ekonomisë (ME) në kuadër të projektit ‘Kosovo Digital Economy’ (KODE) dhe mbështetur financiarisht nga Banka Botërore.




FIGURA 15. PROJEKTI I SNMS

Bazuar në planin e implementimit të projektit SNMS, është arritur që gjatë vitit 2021 me sukses të ngritën tri (3) Stacione Fikse Monitoruese në lokacionet:

- Prishtinë - Zllatar,
- Prizren - Parku ITP,
- Mitrovicë - Lushtë si dhe
- Furnizimi me një Stacion Mobil Monitorues (*Mobile Monitoring Station-MMS*) dhe
- Furnizimi me një stacion Mobil Transportues (*Transportable Monitoring Station-TMS*).

Ndërsa pika e 4 që është paraparë në Shashkoc (*maja e Veletinit*) pritet të përfundohet gjatë vitit 2022.

Stacioni Fiks Monitorues në Prishtinë RFMS-1:

- Brezi frekuencor 9kHz – 8.5 GHz,
- Sistemi Monitorues i Spektrit-TCI, MODEL 739,
- Instantaneous Bandwidths, Dual 10/80 MHz,
- Demodulimi AM, USB, LSB, and FM,
- DF Antena me Polarizim Dual VHF/UHF/SHF,
- Antena Omnidirectional HF-Model 7031,
- Sistemi i monitorimit te spektrit frekuencor ne pajtueshmeri me rekomandimet e ITU-R.
- DF bearing accuracy 10 r.m.s, in a reflection-free environment, per ITU-R SM.2125.
- Softuer-Scorpio.



Stacioni Fiks Monitorues në Mitrovice RFMS-2,



Stacioni Fiks Monitorues në Prizren RFMS-2,



Stacioni Mobil Monitorues MMS,



Stacioni Mobil Transportues-TMS,

- Brezi frekuencor 20 kHz – 8.5 GHz,
- Sistemi Monitorues i Spektrit-TCI, MODEL 739,
- Instantaneous Bandwidths, Dual 10/80 MHz
- Demodulimi AM, USB, LSB, and FM,
- DF Antena me Polarizim Dual VHF/UHF/SHF,
- Sistemi i monitorimit të spektrit frekuencor në pajtueshmeri me rekomandimet e ITU-R.
- Softueri-Scorpio.



Po ashtu është bërë edhe furnizimi me pajisje përcjellëse portabile:

- Power meter,
- Spectrum analyzer, Anritsu Field Master Pro™ MS2090A, rangi frekuencor 9 kHz to 43.5 GHz;
- Portable - Narda Signal Shark 3310, rangi frekuencor 8 kHz-8 GHz etj.

Me ngritjen edhe të Stacioni të katërt Fiks Monitorues në Prishtinë - Shashkoc, dhe furnizimi me pajisje të tjera portabile gjatë vitit 2022, siç janë specifikuar në termet e referencës, do të bëhet i mundur monitorimi i shfrytëzueshmërisë së resurseve frekuncore 24/7, identifikimi dhe zbulimi i burimeve të interferencave, ngritja e nivelit të sigurisë nacionale, okupimi i brezeve të caktuara frekuncore etj, në qytetet e Prishtinë - Aeroportin Ndërkombëtar Adem Jashari, Mitrovicë, Prizren etj. Projekti në fjalë është duke u implementuar nga kompania Amerikane ‘TCI Internacional’, e cila ka një eksperiencë të gjatë në fushën e monitorimit të spektrit frekuncor.

Implementimi i projektit të lartpërmendur do të bëjë që edhe vendi ynë të ketë sistemin e tij nacional për monitorimin e spektrit frekuencor si çdo vend tjetër Evropian dhe më gjerë. Po ashtu implementimi i këtij projekti do të krijoj një ambienti sa me të përshtatshëm dhe të favorshëm për të gjithë operatorët e Autorizuar si dhe ata potencial për të investuar në të ardhmen në fushën e komunikimeve elektronike.

4.10. Veprimtaria e Njësive teknike KOS-IX, KOS-CERT

4.10.1. Nyja shkëmbyses e internetit KOS-IX

Njësia funksionale KOS-IX, ka përmbushur obligimet e përcaktuara me Rregullore gjatë vitit 2021, si dhe ka koordinuar veprimet e nevojshme në lidhje me çështjet teknike me përfaqësuesit e operatorëve të kyçur, për tu mundësuar shkëmbimi i pandërprerë i trafikut. Gjatë këtij viti me qëllim të mirëmbajtjes, përmirësimit dhe rritjes së shërbimeve në KOS-IX janë realizuar disa projekte. Aktualisht në KOS-IX, bëjnë shkëmbimin e trafikut pesë (5) operatorë që posedojnë rrjete autonome sipas tabelës në vijim:

TABELA 3 KAPACITETET E KANALIT KOMUNIKUES PËR SECILIN OPERATOR

OPERATORI	Numri Autonom (ASN)	Kanali komunikues (kapaciteti)
Telekomi i Kosoves SH.A.	AS8661	10 Gbps
IPKO Telecommunications LLC	AS21246	10 Gbps
Kujtesa Net Sh.p.k.	AS29170	10 Gbps
ARTMOTION SH.P.K.	AS33983	10 Gbps
TelKos L.L.C	AS206262	10 Gbps

Gjatë këtyre tre viteve, pra që nga viti 2019 kemi ndryshime evidente të trafikut maksimal (*peak traffic*) të shkëmbyer që është si rezultat që secili operator shkëmben trafikun në kanal komunikues me kapacitet të caktuar. Trafiku që shkëmbehet nëpër KOS-IX, matet, monitorohet dhe regjistrohet në baza ditore, dhe për vitin 2021, kemi vlerat e trafikut të shpërndara sipas muajve të paraqitura në tabelën e mëposhtme ku vërehet, në përgjithësi se gjatë muajve kemi lëvizje të vlerave maksimale të trafikut nga 5 Gbps deri në 8.6 Gbps.

Ndryshimi i trafikut nga viti 2019, 2020 është i ndryshëm nga viti 2021 për këto arsye:

- Kalimi nga platforma e vjetër në atë aktuale, e kjo ka ndodhur në Korrik të vitit 2020, me ç’rast deri sa janë kalibruar dhe testuar sensorat e logging-ut ka pasur resetim të Databazës së IXP edhe Couterave;
- Në fillim të implementimit të platformës së IXP Menager e cila operon në 64bit, nuk janë monitoruar të gjitha portet me real data, deri sa sistemi eshte funksionalizuar edhe kalibruar;
- Në vitin 2019 dhe deri në Korrik të vitit 2020 nuk ka qenë IXP Manageri i cili është funksionalizuar në mënyrë të plotë me datë 13 Korrik të vitit 2020;
- Pra viti 2021 mund tëllogaritet si vit në të cilin është realizuar logging komplet i platformës së IXP Manager me kapacitetet sa janë raportuar gjegjësisht gjeneruar nga IXP në switch nga operatorët telekomunikues.

Nisur nga këto fakte të mësipërme, kemi një pasqyrim mbi ndryshimin e trafikut të shkëmbyer të Internetit nga ISP përgjatë këtyre viteve për të cilat jemi referuar.




FIGURA 16. TRAFIKU MAKSIMAL SIPAS MUAJVE PËR VITIN 2019, 2020 DHE 2021 NË GBPS

Trafiku maksimal krahasuar që nga fillimi i punës së nyjës shkëmbyese të Internetit (viti 2013) e deri në vitin 2021 është paraqitur në foton e mëposhtme, ku vërehët që në çdo vit kemi ndryshim në rritje të trafikut maksimal e sidomos në vitin 2019 ku edhe të gjithë operatorët kanë kaluar në shpejtësinë 10Gbps të Internetit.




FIGURA 17. TRAFIKU MAKSIMAL SIPAS VITEVE 2013-2021 NË GBPS

Bazuar në marrëveshjen e anëtarësimit të KOS-IX me EURO-IX10, Autoriteti në baza periodike gjatë vitit 2021 ka raportuar tek EURO-IX rreth trafikut që shkëmbehet. Duhet të theksohet se EURO-IX çdo vit organizon forume dhe konferenca ndërkombëtare ku KOS-IX është anëtare me të drejta të barabarta.

4.10.2. Njësia Nacionale për Siguri Kibernetike (KOS-CERT)

Njësia Nacionale për Siguri Kibernetike (KOS-CERT) për të përmbushur misionin në sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2021, ka vazhduar me kryerjen e funksioneve me fokus parandalimin dhe reagimin ndaj kërcënimeve dhe incidenteve të sigurisë kibernetike. Me qëllim që të ndihmoj dhe mbështesë komunitetin që në mënyrë efektive të përballet me sfidat e sigurisë kibernetike janë kryer aktivitetit si më poshtë:

- Ngritja e vetëdijes për publikun e gjerë dhe nevojat specifike të konstituentëve;
- Koordinimin e incidenteve dhe kërcënimeve në nivel nacional, regional dhe ndërkombëtar
- Bashkëpunimi me institucionet vendore, regionale dhe ndërkombëtare.

Ngritja e vetëdijes për publikun e gjerë dhe paralajmërimet e sigurisë për nevoja specifike të konstituentve

Ngritja e vetëdijes për publikun e gjerë dhe nevojat specifike të konstituentëve është aktivitet i cili është kryer përmes sistemit informativ të KOS-CERT, duke bërë publikimin dhe shpërndarjen e buletinit me informacionet më të fundit të sigurisë kibernetike që kanë ndodhur në vend, rajon dhe në nivel global. Janë përgatitur dhe publikuar gjithsejtë katërbëdhjetë (14) buletine të sigurisë kibernetike. KOS-CERT në vazhdimësi mban të informuar komunitetin e TI-së në nivel nacional përmes paralajmërimeve të sigurisë për nevoja specifike të konstituentëve, ku gjatë kësaj periudhe, janë

¹⁰ Shoqata Evropiane e Shkëmbimit të Internetit (Euro-IX), u formua në maj 2001 me synimin për të zhvilluar, forcuar dhe përmirësuar komunitetin e Internet Exchange Point (IXP). Një numër IXP-sh njohën nevojën për të kombinuar burimet e tyre në mënyrë që të koordinojnë standardet teknike, të zhvillojnë procedurë të përbashkëta, të ndajnë dhe publikojnë statistika dhe informacione të tjera të dobishme. Kjo do t'u jepte të gjitha palëve të interesuara një pasqyrë më të mirë në botën e IXP-ve.

përgatitur dhe dërguar gjithsejtë dhjetë (10) paralajmërime të sigurisë me informacione të avancuara teknike të bazuara në rekomandimet dhe praktikat ndërkombëtare.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur përqindja e hapjes dhe klikimit të materialeve të publikuara në buletin informativ ku vërejmë një përqindje relativisht të ulët të klikimit në informatat specifike të dhe një trendi në rritje të përqindjes së hapjes së buletineve të dërguara. Po ashtu, nga të dhënat të cilat KOS-CERT posedon, krahasuar me vitin paraprak kemi pasur një rritje të lehtë të numrit të anëtarëve të regjistruar në sistemin informativ të njësisë KOS-CERT. Mbetet nevojë rritja e numrit të anëtarëve për të marr informacione nga ky shërbim.




FIGURA 18. PËRQINDJEN E HAPJES DHE KLIKIMIT TË MATERIALEVE INFORMATIVE RRETH SIGURISË KIBERNETIKE TË DËRGUARA NGA NJËSIA KOS-CERT PËRMES BULETINEVE

Më 28 Janar 2021 në ditën ndërkombëtare të privatësisë së të dhënave KOS-CERT, ka implementuar kampanjën e titulluar "SYTË KATËR", me qëllim të vetëdijesimit të qytetareve dhe bizneseve në mbrojtjen nga rreziqet që vijën nga hapësira kibernetike. Kjo kampanje ka zgjatuar deri në fund të muajit Mars ku përmes rrjeteve sociale janë shpërndarë materiale të ndryshme vetëdijësuese. Kjo kampanje është mbështetur nga projekti regional që implementohet nga DCAF "Good Governance in Cybersecurity in the Western Balkans" financuar nga United Kingdom Government's Foreign and Commonwealth Office (FCDO).



FIGURA 19. KAMPANJA “SYTË KATËR”

Koordinimi i incidenteve dhe kërcënimeve

Koordinimi i incidenteve dhe kërcënimeve të sigurisë kibernetike është aktivitet që KOS-CERT e kryen duke monitoruar IP-të publike në nivel nacional përmes konsultimit të të dhënave nga burimet publike. Në total afërsisht 20 lloje të ndryshme të incidenteve dhe kërcënimeve janë koordinuar me konstituentet. Në përgjithësi këto incidente dhe kërcënime kanë qenë pajise të infektuara me softuer me qëllim të keq, ueb faqe phishing, sulme DDoS si dhe shërbime që kanë qenë të cënueshme si pasojë e konfigurimeve jo të duhura dhe dobësive të sigurisë në aplikacione dhe sisteme. Derisa gjithsejtë 11 incidente janë raportuar nga CERT nacional të vendeve tjera të cilat janë koordinuar me palët.

Me poshtë janë paraqitur disa nga llojet e softuerëve me qëllim të keq që kanë afektuar shërbimet në IP adresë publike. Këto rezultate bazohen në të dhënat e konsultuara nga burimet publike që KOS-CERT mbledhë me qëllim të përcjelljes së situatës së përgjithshme. Vërehet se në periudhën kohore Shkurt – Qershor kemi pas rritje të varianteve të softuerëve me qëllim të keq të llojeve Mirai dhe Mozi dhe në koordinim me konstituentet janë marrë masat e nevojshme për eliminim.

Po ashtu kemi pas edhe disa raportime nga shtetet tjera ku burime e sulmeve kanë rezultuar nga disa IP adresë që i takojnë Kosovës.

Duhet të theksohet se gjatë vitit 2021 globalisht është njoftuar për dobësitë që afektojnë Microsoft Exchange Server. Gjithsejtë janë identifikuar 50 IP publike ku ky shërbim ka qenë i cënueshëm dhe janë njoftuar palët që të marrin masat e nevojshme për përditësim.




FIGURA 20. NUMRI I IP ADRESAVE PUBLIKE TE AFEKTUARA NGA DISA LLOJE TË SOFTUERËVE ME QELLIM TË KEQ

Si rezultat i problemeve të ndryshme të sigurisë bazuar në të dhënat publike të grumbulluara nga KOS-CERT, gjatë vitit 2021 sipas muajve me poshtë janë të paraqitura numri i IP adresave publike që kanë qenë të përfshira në listat e bllokimit.




FIGURA 21. NUMRI I IP ADRESAVE PUBLIKE QE KANE QENE TE PËRFSHIRA NE LISTAT E BLOKIMIT

Bashkëpunimi me institucionet vendore, regionale dhe ndërkombëtare

Më qëllim të koordinimit me institucionet vendore, KOS-CERT ka qene e përfaqësuar ne grupin punues për hartimin e “Strategjisë Nacionale për Siguri Kibernetike dhe Planin e Veprimit 2020-2025”, si dhe ka marr pjese ne një numër te konsiderueshëm te punëtorive te organizuara nga institucionet vendore për hartimin e politikave dhe udhëzimeve administrative ligjore ne fushën e sigurisë kibernetike.

Gjatë vitit 2021, KOS-CERT po ashtu ka qenë pjesë e një numri të caktuar të aktiviteteve në kuadër të projekteve regionale qe implementohen me qëllim të ngritjes së kapaciteve në fushën e sigurisë kibernetike, të organizuara nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare. Konferencat, punëtoritë dhe trajnimet në të cilat kemi marr pjesë me qëllim të përfaqësimit/prezantimit janë si më poshtë:

- “Business analysis and development of guidelines and procedures on sharing of data by CERT with criminal justice authorities”, punëtori e organizuar nga projekti iPROCEEDS-2 i financuar nga Këshilli i Evropës, 3 – 5 Shkurt 2021;
- “Cyber resilience and cybersecurity capacity building the Western Balkans”, konferenca regionale e nivelit të lartë organizuar nga DCAF, 3 – 5 March 2021;
- “Online practical exercise for developing skills on cooperation on cybercrime and electronic evidence for judicial, police and cybersecurity authorities with service providers”, punëtori e organizuar nga projekti iPROCEEDS-2 i financuar nga Këshilli i Evropës, 7-9 Shtator 2021;

Bazuar në Nenin 8 të rregullores mbi “Standardet Teknike dhe organizative për Sigurinë dhe Integritetin e Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” operatorët që ofrojnë rrjete dhe shërbime të Komunikimeve Elektronike janë të obliguar që çdo 2 vite të bëjnë auditimin e rrjeteve dhe shërbimeve te komunikimeve Elektronike sipas kriterëve të specifikuara ne ANEKS-in 3 të rregullores. ARKEP gjatë vitit 2021 ka pranuar raportet nga operatorët në lidhje me auditimin e dytë me radhë prej kur rregullorja ka hyrë në fuqi, derisa auditimi i parë është bërë gjatë vitit 2018.

Avancimi i kapaciteteve humane dhe profesionale konsiderohet një nder aspektet dhe sfidat kryesore ne këtë fushe. Gjate kësaj periudhe KOS-CERT edhe me tutje ka operuar me resurse minimale njerëzore dhe profesionale përkundër kërkesave te vazhdueshme për rritjen e stafit. Kjo nuk ka qene e mundur edhe gjate vitit 2021.

4.11. Shërbimet Postare

Në përmbushje të obligimeve ligjore që dalin nga Ligji Nr. 06/L-038, për Shërbimet Postare, Autoriteti është fokusuar në hartimin dhe nxjerrjen e akteve nënligjore që dalin si detyrim për Autoritetin, në avancimin dhe rregullimin e tregut të shërbimeve postare, si dhe monitorimin, mbikëqyrjen e respektimi të rregullave të ofrimit të shërbimeve postare në përgjithësi. Në vazhdim të këtij dokumentit, në mënyrë të përmbledhur paraqesim një raport të aktiviteteve, angazhimeve dhe punëve të cilat Sektori i Shërbimit Postar i ka realizuar gjatë vitit 2021.

Sektori i Shërbimit Postar, si njësi e veçantë funksionale brenda Autoritetit (ARKEP), konform autorizimeve dhe kompetencave që ka, sipas Ligji Nr. 06/L-038 për shërbimet postare, me përgjegjësi të plotë dhe me sukses është angazhuar në përmbushjen dhe realizimin e të gjitha objektivat dhe detyrat e saja të planifikuara dhe parapara me 'Planin e Punës për vitin 2021.

Objektiv dhe synimi kryesor i Sektorit të Shërbimeve Postare, është rregullimi dhe avancimi i tregut të shërbimeve postare, krijimi i një ambienti të përshtatshëm rregullator për ofruesit e shërbimeve postare, duke lehtësuar rregullat dhe duke krijuar lehtësira praktike në ofrimin e shërbimeve postare për operatorët, krijimin e një konkurrencë të drejtë në treg, mbrojtje të operatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve postare etj.

Në bazë të të dhënave të përpunuara nga Autoriteti, në vitin 2021, kemi patur në total; 3,981.076, dërgesa. Krahasuar me periudhën e njëjte të vitit 2020, që kishte rreth; 3,957,898 dërgesa, rezulton se kemi një rritje të lehtë të numrit të përgjithshëm të volumit të dërgesave postare në vlerën; 0.59 %, përderisa 'Posta Kosovës' SHA, ka një rritje të volumit të dërgesave postare në vlerën; 1.92 %, ndërsa operatorët privat kanë një rënie në vlerën; 2.16 %. 'Posta Kosovës' SHA, si operator publik postar mbulon tregun e përgjithshëm të shërbimeve postare me; 68.20 %, kurse operatorët privat janë të përfaqësuar në vlerën; 31.80 %, të tregut të përgjithshëm.

Ndërsa indikatorët e tregut të shërbimeve postare në vitin 2021, krahasuar me vitin 2019, tregojnë po ashtu një rënie të volumit të përgjithshëm të dërgesave postare në vlerën; 3.57 %.

Nga numri i përgjithshëm i dërgesave postare, rreth; 71.94 %, janë letër dërgesa postare, ndërsa rreth 28.06 % janë dërgesa të pako/kolipostës ose pako postare. Nga numri i përgjithshëm i dërgesave rreth; 82.25 % e dërgesave postare janë të pranuar dhe shpërndara në trafikun e brendshëm, pra janë postë vendore, ndërsa rreth 17.25 % janë postë ndërkombëtare, pra dërgesa që janë dërguar dhe janë pranuar nga trafiku ndërkombëtar.

Në kuadër të objektivave dhe aktiviteteve të parapara vitin 2021, Sektori i Shërbimeve Postare (SSHP) ka realizuar detyrat e paraqitura si në vijim:

Objektiv dhe synimi kryesor i Sektorit të shërbimeve postare, është rregullimi dhe avancimi i tregut të shërbimeve postare, krijimi i një ambienti të përshtatshëm rregullator duke krijuar rregulla dhe lehtësira praktike në ofrimin e shërbimeve postare për operatorët, konkurrencë të drejtë në treg, mbrojtje të operatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve postare etj. Realizimi i këtyre objektivave është i shprehur përmes aktiviteteve të shpalosura dhe të realizuara gjatë vitit 2021, ku ato më kryesoret janë paraqitura si në vijim:

- Në përputhje me kërkesat ligjore Autoriteti, konform Rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare, janë pranuar dhe ka lëshuar katër (4) Autorizime të Përgjithshme, për ofrim të shërbimeve postare;
- Janë realizuar gjithsejtë; dy (2) inspektime dhe kontrole të operatorëve postar, dhe atë:
- Janë pranuar gjithsejtë; një (1), ankesa dhe kërkesa nga përdoruesit e shërbimeve postare, të cilat janë administruar dhe adresuar brenda afateve ligjore duke u dhënë zgjedhje konkrete dhe efikase të gjitha ankesave;

- Është pranuar; një (1) ankesë nga operatorët postar, e cila i është drejtuar Autoritetit, për të cilat Autoritetit ka dhënë përgjigje dhe interpretime rregullatorë;
- Janë pranuar dhe administruar në mënyrë të rregullt dhe konform Rregullores Nr. 11, të gjitha raportet tremujore (TM) të pranua nga të gjithë operatorët postar të cilët ofrojnë shërbime postare;
- Është hartuar drafti i 'Rregullores për llogaritjen e kostove të ofruesit të shërbimeve universale postare dhe Udhëzuesi për llogaritjen e kostove të ofruesit të shërbimeve universale postare;
- Është hartuar drafti i Rregullorja për llogaritjen e humbjeve të ofruesit të shërbimeve universale postare dhe Udhëzuesi për llogaritjen e humbjeve të ofruesit të shërbimeve universale postare,
- Është përgatitur 'Plani i Punës për vitin 2022'.

5. PLANI I PUNËS SË ARKEP PËR VITIN 2022

Qëllimi i përgjithshëm i ARKEP-it, sa i përket synimeve, objektivave dhe aktiviteteve, përcaktohet nga korniza rregullatore për komunikimet elektronike dhe postare. Në kuadër të objektivave të përcaktuara, ARKEP duhet të hartoj Planin e saj të Punës duke specifikuar qartë aktivitetet në përgjigje të nevojave të tregut të komunikimeve elektronike dhe postare.

Njëra nga sfidat kryesore me të cilën ballafaqohen ndërmarrjet, të cilat ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike dhe atyre postare është pa dyshim i ashtuquajtimi 'Parashikim Rregullator' (*Predictability*), respektivisht ekzistimi i një plani rregullator me veprime konkrete rregullatore, të cilat priten të adresohen. Prandaj, në përgjigje të kësaj nevoje, ARKEP ka hartuar Planin e Performancës për vitin 2022, i cili do të kontribuoj në rritjen e sigurisë rregullatore dhe ka për qëllim të ndihmoj në promovim të investimeve, rritje të konkurrencës dhe inovacionit në tregun e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në Republikën e Kosovës. Ky plan ka për qëllim t'i adresoj objektivat rregullatore të përcaktuara me Ligjin për Komunikimet Elektronike dhe atë të Shërbimeve Postare, ne veçanti objektivat si ne vijim:

- Hapja e brezave frekuencore me fokus në mundësimin e implementimit të rrjetave 5G, në Republikën e Kosovës
- Rritja sigurisë së përdorimit efikas dhe efektiv të brezit frekuencore në kuptim të mbulues mërisë në kohë dhe hapësirë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
- Ngritja e kapaciteteve për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare.
- Avancimi i ARKEP-it në Autoritet modern për sa i përket lehtësisë dhe transparencës në komunikim me palët e interesit.

Prioritetet e ARKEP për vitin 2022, si përmendur në objektivat më larte, do të realizohen përmes aktiviteteve të përmbledhura si në vijim;

Detyrat prioritare;

- Inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim të brezeve frekuencore për shërbime Mobile (IMT) dhe shtrirjen e rrjetave MFCN, duke përfshirë zbatimin e teknologjisë 5G;
- Monitorimi implementimit të plotë të kodeve të caktuara nga ITU dhe përzgjedhja e operatorit ekonomik për implementimin e projektit të bartshmërisë së numrave;
- Mbikëqyrja e implementimit të marrëveshjeve të Roamingut;
- Implementimi i plote i Sistemit Nacional të Monitorimit të Spektrit Radio Frekuencor;
- Hartimi dhe përditësimi i Planit Kombëtar të Radio Frekuencave,
- Analiza e pagesave për mbikëqyrje dhe të drejtën e përdorimit të radio frekuencave.
- Amandamentimi (ndryshimi) i rregullores së 'Pagesave të mbikëqyrjes së shfrytëzimit të Radio frekuencave';
- Plotësim ndryshimi i rregullores për "Dhënien dhe shfrytëzimin e Radio frekuencave" Nr. 22;
- Plotësim ndryshimi i rregullores për licencimin (Autorizimin) e Radio pajisje në mjetet ajrore;

- Harmonizimin dhe përpilimi i Marrëveshjeve teknike për planifikimin dhe shfrytëzimin e radio-frekuencave në zonat kufitare për shërbimet IMT, për brezet frekuencore 800, 900, 1800, 2100 MHz;
- Lehtësimi i masave për reduktimin e kostos për shtrirjen e rrjetave brez gjera dhe shfrytëzimi i përbashkët i infrastrukturës (Rregullimi simetrik);
- Pjesëmarrja e vazhdueshme në nivelet e grupeve punuese dhe takimet e niveleve të larta të Trupit të Rregullatorëve Evropian (BEREC), si dhe përafrimi me organet kryesore ndërkombëtare (ITU, UPU, ERGP, CEPT, ERG);
- Avancimi i mëtutjeshëm i mbrojtjes së konsumatorit, përmes përmirësimit të kualitetit të shërbimeve (QoS) dhe monitorimit të vazhdueshëm të parametrave të neutralitetit të rrjetit.


Aktivitetet e vazhdueshme;

- Paraqitja e statistikave lidhur me indikatorët e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, për t'i informuar konsumatorët në bërjen e zgjedhjeve të pavarura dhe për të nxitur konkurrencën e mëtejshme;
- Analiza e rregullt e tregjeve për të rishikuar tregjet, marrja e vendimeve për të zhvilluar konkurrencë më efektive në treg (*Rregullimi ex-ante përmes vendosjes së detyrimeve rregullatore*);
- Pranimi i aplikacioneve dhe kërkesave të operatorëve shfrytëzues të resurseve frekuencore, përcaktimi i pagesave dhe përgatitja e Autorizimeve individuale
- Përgatitja e dokumenteve për konsultim publik për resurse frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike dhe ku kapacitetet frekuencore janë të kufizuar posaçërisht në shërbime Mobile dhe shtrirjen e rrjeteve MFCN duke përfshirë ndër të tjera edhe zbatimin e teknologjisë 5G;
- Përditësimi dhe mirëmbajtja e data bazës së resurseve frekuencore të dhanë në shfrytëzim përmes moduleve softuerike profesionale të menaxhimit të spektrit frekuencor;
- Monitorimi i vazhdueshëm i spektrit radio frekuencor;
- Monitorimi i radio frekuencave dhe rritja e efikasitetit në eliminimin e interferencave në zonat kufitare;
- Koordinimi i sigurisë dhe integritetit të rrjeteve të komunikimeve elektronike;
- Vazhdimi i azhurnimit të kornizës rregullatore të Kosovës në përputhje me Direktivat e BE-së;
- Trajnimi, shkëmbimi i njohurive, profesionalizmi dhe ngritja e kapaciteteve të vazhdueshme të ARKEP.

Orientimi strategjik në të ardhmen;

- Promovimi i shtrirjes së shërbimeve brez gjëra me shpejtësi të lartë në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- Monitorimi i spektrit frekuencor përmes stacioneve fikse të Radio Monitorimit, në kuptim të mbulueshmërisë në kohe dhe hapësirë në tërë territorin e Republikës së Kosovës;
- Sigurimi i pavarësisë së plotë financiare dhe rritja e efikasitetit rregullator.

Korniza e Planit të së Ardhmes të ARKEP: Përmbledhje e objektivave dhe prioriteteve kryesore rregullatore



5.1. Plani i Punës për vitin 2022

Në vijim është paraqitur Plani i ARKEP për vitin 2022, , i cili përfshinë gjithsejtë; 12 Synime, 48 objektiva dhe mbi 125 aktivitete.

SYNIMI I: AVANCIMI DHE MBROJTJA E KONKURENCËS EFEKTIVE NË TREGUN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE		
NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
1	Analiza e tregjeve të Komunikimeve Elektronike	Analiza e tregjeve: - Qasja lokale me shumicë e ofruar në lokacion fiks (tregu 3a) - Qasja në nivel qendror me shumicë e siguruar në lokacionin fiks për produktet e tregut masiv (tregu 3b); - Qasja me shumicë e kualitetit të lartë të ofruar në lokacionin fiks ¹¹
		Hartmi dhe konsultimi me palët e interesit të raportit dhe draft vendimeve për tregjet e analizuara
2	Rregullimi i shërbimeve të operatorëve të komunikimeve elektronike	Miratimi i detyrimeve rregullatore për tregjet e analizuara
		Zbatimi detyrimet rregullator për Kontroll të çmimeve për OFNT në tregun “Terminimi i thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara në një lokacion fiks” - përcaktimi i çmimit FTR
		Mbikëqyrja e detyrimeve rregullatore <i>ex-ante</i> për OFNT nga tregjet e analizuara (<i>Fikse dhe Mobile</i>)
3	Avancimi i mëtutjeshëm i Kornizës rregullatore	Rishikimi dhe miratimi i Rregullore për Analizen e Tregut në përputhje me dispozitat e Kodit të Komunikimeve Elektronike (EU) dhe Rekomandimeve të Komisionit Europian.
		Mbikëqyrja e zbatimit të Rregullores për Politikën e Përdorimit të drejtë (FUP) dhe për metodologjinë e vlerësimit të qëndrueshmërisë së heqjes së tarifave të roamingut me pakicë për marrëveshjen e roamingut në mes shteteve të Ballkanit Perëndimor
		Pjesëmarrja aktive në finalizimin e dokumentit “Roadmap” për uljen e tarifave të roamingut në mes Vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së dhe ndërmarrja e aktiviteteve për zbatimin e tij
4	Implementimi i Rregullores për Bartshmërinë e Numrave	Analizimi modeleve të ndryshme në vendet rajonale dhe Evropiane për implementimin e bartshmërisë së numrave
		Rishikimi i Rregullores për bartshmërinë e numrave dhe aktet tjera normative teknike
		Implementimi i projektit për bartshmërinë e numrave (Krijimi i Bazës Qendrore Referente e të Dhënave – CRBD) ¹²

¹¹ Zbatimi i këtij aktiviteti është i ndërlidhur me mbështetjen nga Projekti KODE i Ministrisë së Ekonomisë

¹² Implementimi me sukses i këtij projekti varet edhe nga faktorët tjerë të jashtëm si p.sh, ecuria e implementimit të kodit telefonik, rritja e kapaciteteve të stafit.

SYNIMI I: AVANCIMI DHE MBROJTJA E KONKURENCËS EFEKTIVE NË TREGUN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE		
NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
5	Raportimi i të dhënave	Plotësimi dhe ndryshimi i rregullores për raportimin e të dhënave statistikore
		Shqyrtimi i raporteve periodike të operatorëve; Përgatitja dhe publikimi i Indikatorëve kryesor të komunikimeve elektronike në baza tremujore
6	Autorizimet e përgjithshme	Rishikimi i Rregullores për autorizimet e përgjithshme
		Trajtimi i aplikacioneve për hyrjen në treg të Ofruesve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, si dhe dhënia e autorizimeve, respektivisht vendosja në regjistër e ndërmarrjeve, të cilat kanë kryer procesin e notifikimit, si dhe verifikimi i aktiviteteve në regjistrin zyrtar

SYNIMI II: AVANCIMI I SHËRBIMEVE DHE RRJETAVE BREZGJËRA TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE		
NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
1	Zbatimi i kornizës Rregullatore për shërbimet universale (USO)	Rishikimi i Rregullores USO ne përputhje me kërkesat e Kodit të Komunikimeve Elektronike (drafti fillestar)
2	Avansimi i mëtutjeshëm i Kornizës rregullatore	Miratimi i Rregullores për qasjen e hapur në infrastrukturën e komunikimeve elektronike
		Miratimi i Rregullores për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve
3	Promovimi dhe mbikëqyrja e shtrirjes së infrastrukturës së komunikimeve elektronike	Koordinimi i aktiviteteve me institucionet qendrore dhe komunale dhe akterët tjerë lidhur me zbatimin e Ligjit për uljen e kostos (Cost Reduction Directive), dhe rregullores për shtrirjen dhe shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës/faciliteteve shoqëruese
		Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në mes operatorëve të infrastrukturës (Komunikimeve elektronike, si dhe infrastrukturat tjera)

SYNIMI III: SIGURIA DHE INTEGRITETI I RRJETAVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE		
NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
1	Ngritja e Vetëdijesimit	Publikimi i buletineve dhe paralajmërimeve për situatën e Sigurisë Kibernetike
		Popullimi i ueb faqes dhe rrjeteve sociale me informacione të sigurisë kibernetike
		Dhënia e rekomandimeve teknike në lidhje me veprimet/masat e sigurisë për nevojat specifike të konstituentve
2	Draftimi, zbatimi dhe implementimi i bazës Ligjore	Mbikëqyrja e implementimit të “Rregullores mbi Standardet Teknike dhe organizative për Sigurinë dhe Integritetin e Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”

SYNIMI III: SIGURIA DHE INTEGRITETI I RRJETAVE DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE		
NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
		Analizimi, përmbledhja dhe përpunimi i rezultateve nga raportet e auditimit mbi masat minimale të sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të KEs
		Adaptimi, draftimi dhe miratimi i politikave procedurale ligjore në lidhje me reagimin dhe menaxhimin e incidenteve dhe shkëmbimin e informacionit
3	Koordinimi dhe reagimi ndaj incidenteve kibernetike	Koordinimi dhe reagimi ndaj incidenteve kibernetike të pranuar përmes platformës online, email apo telefonit
		Draftimi i Manualit Operacional Teknik dhe procedural për menaxhimin e incidenteve për konstituentet
		Krijimi i Grupit teknik me përfaqësuesit e CERT-ve sektorial, përfaqësuesit nga ISP-te edhe ekspertet tjere të sigurisë
		Vendosja e kontakteve zyrtare mire të definuara me administratorët/ekspertet e sigurisë që menaxhojnë me rrjete në kuadër të numrave autonom (AS Numbers) që operojnë brenda Kosovës
		Shkëmbimi i të dhënave në lidhje me kërcënimet, incidentet dhe dobësitë e rrjetave dhe shërbimeve publike të KEs bazuar në të dhënat nga burimet publike
4	Planifikimi dhe Avancimi i Infrastrukturës Teknike	Përshtatja / automatizimi i platformës për pranimin, regjistrimin dhe koordinimin e kërcënimeve/incidenteve të sigurisë kibernetike
6	Anëtarësimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	Pjesëmarrja në aktivitetet e projekteve me karakter regjional dhe me gjere të implementuara nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare
		Anëtarësimi në FIRST (Forum of Incident Response and Security Teams)
7	Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet tjera në nivel Nacional	Pjesëmarrja në grupin punuese me qëllim të hartimit të politikave të sigurisë kibernetike
		Pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Nacional për Siguri Kibernetike
8	Ngritja e kapaciteteve të resurseve humane	Rekrutimi i anëtarëve të rinjë në KOS-CERT
		Ngritja e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve

SYNIMI IV: RITJIA E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT TË SHËRBIMEVE DHE PAJISJEVE		
NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
1	Mbiqëqyrja e Kualitetit të shërbimeve të Komunikimeve Elektronike	Hartimi i Planit për matjet e Kualitetit të shërbimeve (QoS) të Komunikimeve Elektronike
		Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për monitorimin e kualitetit të shërbimeve të komunikimeve elektronike
		Realizimi i matjeve të parametrave të kualitetit të shërbimeve të Komunikimeve Elektronike

SYNIMI IV: RITJIA E MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT TË SHËRBIMEVE DHE PAJISJEVE

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
		Implementimi i serverit të ri për platformën për monitorimin e parametrave të QoS të shërbimit të zërit si dhe ceshtjet që kanë të bëjnë me Mirëmbajtje të platformës për monitorimin e kualitetit të shërbimit (QoS) të Zërit
		Përgatitja e specifikacioneve teknike për implementimin e kodit të BEREC Nettet-it për NetNeutralitet dhe adaptimi i tij në platformën ARKEP Nettet me shërbim të mirëmbajtjes prej tri (3) viteve
		Analizimi i deklarave/raporteve të operatoreve mbi kualitetin e shërbimeve (QoS) të Komunikimeve Elektronike si dhe hartimi i Raporteve periodike (Mujore dhe Vjetore) lidhur me QoS
2	Radio Pajisjet	Mbikëqyrja e implementimit të rregullores për radio pajisjet Publikimi i standardeve dhe rekomandimeve të aplikueshme për radio pajisje
3	Mbikëqyrja e përmbushjes së detyrimeve financiare të operatorëve	Implementimi i Rregullores për Pagesat e mbikëqyrjes në tregut si dhe marrja e masave për operatorët, të cilët nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore.
4	Inspektimi i Ndërmarrjeve	Inspektimi i ndërmarrësve të rrjeteve dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike dhe atyre postare

SYNIMI V: MENAXHIMI I RESURSEVE TË FUNDME FREKUENCORE

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
1	Avancimi dhe menaxhimi efikas dhe efektiv i spektrit frekuencor	Pranimi i Aplikacioneve, kërkesave të Operatoreve shfrytëzues të resurseve frekuencore, kalkulimi i pagesave dhe përgatitja e Autorizimeve individuale për të gjithë Brezet përfshirë edhe Brezet frekuencore ku Numri i Autorizimeve është i kufizuar
		Koordinimi me KFOR dhe institucionet vendore në harmonizimin dhe shfrytëzimin e resurseve frekuencore.
		Trajtimi i Aplikacioneve dhe përgatitja e Licencave për radio Amatore, dhe sipas kërkesave të SHRAK, organizimi i provimit të certifikimit të aftësisë së radio Amatoreve të rij.
		Planifikimi i brezit frekuencor 2600 MHz me rangun 2500-2690 MHz për teknologjitë dhe shërbime brezgjera, ku numri i Autorizimeve është i kufizuar.
		Planifikimi i brezit 24.25 – 27.5 GHz për shërbime Mobile në teknologjinë 5G. Përcaktimi i kapaciteteve frekuencore brenda brezit 24,25 – 27,5 GHz për Autorizime për shfrytëzim Nacional dhe nivel Lokal dhe aplikim në industri.
		Azhurnimi dhe mirëmbajtja e data bazës përmes moduleve softuerike; SPEKTRA (SPECTRAplan, SPECTRAplus, SPECTRAemc) në menaxhimin efektiv të spektrit frekuencor.

SYNIMI V: MENAXHIMI I RESURSEVE TË FUNDME FREKUENCORE

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
2	Funksionaliteti dhe Operacionalizimi i menaxhimit të spektrit frekuencor	<p>Analiza e pagesave për mbikëqyrje dhe te drejtën e përdorimit të radio frekuencave. Amandamentimi i rregullores së “Pagesave të mbikëqyrjes së shfrytëzimit të Radio frekuencave”.</p> <p>Rishikimi dhe përgatitja e draft rregullore për “ Dhënie dhe shfrytëzimin e Radio frekuencave” Nr. 22</p> <p>Planifikimi i të hyrave nga Radio Frekuencat për vitin 2022 në funksion të analizës së shfrytëzuesve dhe Autorizimeve individuale të radio frekuencave dhe procesit të hapjes së brezeve frekuencore</p> <p>Rishikimi dhe përgatitja e një draft rregullore për licencimin (Autorizimin) e Radio pajisje në mjetet ajrore.(nëse app P-i Ri)</p>
3	Përcjellja e trendëve evropiane në fushën e radio komunikimeve	<p>Hartimi dhe Përditësimi i Planit kombëtar të Radio Frekuencave dhe tabelës së shpërndarjes dhe shfrytëzimit të radio frekuencave.</p> <p>Analiza e zënshmërisë e brezeve frekuencore nga 22- 38 GHz për shërbime fikse MW PtP, si dhe brezeve 6-15 GHz të përshtatshme për ngritjen e rrjetave të reja backbone (kurrizore) si kërkesë e domosdoshme e operatoreve të rij të shërbimeve mobile (IMT),</p> <p>Analiza e zhvillimeve të reja teknologjike në fushën e radio komunikimeve me qëllim të njohjes së karakteristikave të tyre, me theks të veçante, trendët e zhvillimit të teknologjisë 5G në brezet 700 MHz, 3,4-3.8 GHz dhe 26 GHz në vendet Evropiane dhe të regjionit, Përfshirja e Rekomandimeve dhe Vendimeve të reja (të amendamentuara) të CEPT /ECC për aplikimin e teknologjisë 5G për breze frekuencore të shërbimeve të lëvizeshim në rrjetat MFCN</p> <p>Analiza dhe zbatimi i versioneve të reja (të amendamentuara) të Rekomandimeve, Vendimeve dhe Raporteve evropiane për shfrytëzimin e radio frekuencave për shërbimet Fikse MW PtP, Satelitore dhe mobile GSM-R.</p>
4	Bashkëpunimi dhe koordinimi në nivel ndërkombëtar për Radio frekuenca	<p>Analizat spektrale për vlerësimin e nivelit të mbulueshmerisë me sinjal nga transmetuesit e Stacioneve bazë (SB) të Rrjetave për komunikime mobile/fikse (MCFN) në zonat kufitare.</p> <p>Aktivitet për takime Bilaterale dhe Multilaterale për harmonizimin dhe Hartimin e Marrëveshjeve teknike për planifikimin dhe shfrytëzimin e radio- frekuencave në zonat kufitare për shërbimet IMT. 4 Breze frekuencore 800, 900, 1800, 2100 MHz.</p>

SYNIMI V: MENAXHIMI I RESURSEVE TË FUNDME FREKUENCORE

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
5	Hapja e brezeve frekuencore të shërbimeve IMT	<p>Fazës së II-të, e Hapjes së brezeve frekuencore të shërbimeve IMT për resurse frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike, brezi 800 MHz rangu frekuencore 790 – 862 MHz, dhe brezi 3400- 3800 MHz</p> <p>Përgatitja e dokumenteve për konsultim publik me operatorët ofrues të shërbimeve të komunikimit elektronik dhe shfrytëzimin e kapaciteteve frekuencore për shërbime të lëvizshme të rrjetave MFCN</p> <p>Aplikimi i teknologjisë 5G në brezin 3400- 3800 MHz për shërbime të lëvizshme (mobile) të rrjetave MFCN me nivel nacional dhe Lokal duke përfshirë posaçërisht aplikimin në Industri.</p> <p>Përanditja e dokumentit për Planin e përdorimit të brezit 3400 – 3800 MHz.</p> <p>Përcaktimi i kapaciteteve frekuencore të brezit 3400- 3500 MHz për Autorizime në nivel lokal dhe aplikime në industri, dhe përcaktimi i kapaciteteve frekuencore të brezit 3500- 3800 MHz për Autorizime dhe shfrytëzim të resurseve frekuencore në nivel nacional nga Operatorët e telefonisë Mobile.</p> <p>Koordinimi me KPM për lirimin e brezave frekuencave nga shërbimet radio difuzive që përfshihen në dividenten e I dhe II gjegjësisht brezave 790 – 862 MHz e quajtur Dividentia e I dhe brezit 700 MHz diapazoni 694- 790 MHz e quajtur Dividentia II dhe planifikimi i tyre për shërbim të mobile.</p> <p>Ndikimi i Ligjit për dixhitalizim në procesin e lirim të brezave frekuencore 800 MHz dhe 700 MHz për shfrytëzim për shërbime Mobile dhe rrjeta MFCN dhe koordinimi me KPM për lirimin e brezit 700 MHz nga Operatorët TV transmetimeve radio difuzive. Zbatimi i MoU ARKEP –KPM.</p>

SYNIMI VI: MENAXHIMI I RESURSEVE TË FUNDME NUMERIKE

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
1	Implementimi i kodeve të caktuara nga ITU	<p>Mbikëqyrja e implementimit të kodit telefonik</p> <p>Koordinimi i aktiviteteve me operatorët dhe palët tjera të interesit</p>
2	Implementimi i Rregullores për Planin Kombëtar të Numeracionit	<p>Caktimi/rezervimi i resurseve numerike dhe kodeve tjera identifikuese sipas kërkesës së palëve, hartimi i raporteve lidhur me përqindjen e shfrytëzimit.</p>

SYNIMI VII: MONITORIMI I SHFRYTZUESHMËRISË SË RESURSEVE TË FUNDME FREKENCORE

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
1	Mbikqyrja e kushteve teknike të përcaktuara ne Autorizime Individuale	Monitorimi i operatoreve te Autorizuar dhe verifikimi i përmbushjes së kushteve teknike të përcaktuara nga ARKEP për teknologjinë: 2G-GSM, 3G (UMTS) dhe 4G LTE në brezin 1800 MHz, 2100 MHz si dhe 5G ne brezin 3.4-3.8 GHz
		Monitorimi i operatoreve të autorizuar nga ARKEP për përdorim të resurseve frekuencore, si dhe respektim të përmbushjes së kushteve të përcaktuara me autorizime për shërbimet: Private Mobile Radio - PMR në brezin VHF dhe UHF
		Monitorimi dhe mbikëqyrja e përmbushjes së kushteve të autorizimeve individuale në brezin SHF të alokuar për linjat mikrovalore Pikë-Pikë
2	Monitorimi /Identifikimi i përdorimit te paautorizuar te spektrit Radio Frekeuncor	Monitorimi/Identifikimi i interferencave të paraqitura sipas njoftimeve nga operatorët apo palët tjera.
		Monitorimi i marrëveshjeve teknike me shtetet fqinje lidhur me harmonizimin e përdorimit të brezeve frekuencore për teknologji GSM/UMTS/LTE në zonat ndërkufitare
3	Rritja e efektivitetit të Radio Monitorimit	Funksionalizimi i plotë i Sistemit Nacional te Monitorimit te Spektrit Frekuencor
		Monitorimi i brezeve frekuencore nga distanca përmes Qendres Kryesore të Kontrollit të vendosur në ARKEP, në qytetet: Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë, përmes Stacioneve Fikse Monitoruese.
		Futja në përdorim e Stacionit Mobil Monitorues (MMS) dhe Stacionit Transportues (TMS) si dhe pajisjeve portabile për monitorimin e spektrit frekuencor nga 20 MHz deri 40 GHz.
		Hartimi i specifikacioneve teknike për përditësimin e pajisjes ekzistuese Drive Test Tools me qëllim të monitorimit edhe të teknologjisë 5G.
4	Mbikëqyrja e zbatimit te Rregullores Teknike për Radio pajisje	Trajtimi i kërkesave lidhur me konformitetin e Radio Pajisjeve
		Verifikimi i përmbushjes së kërkesave teknike të radio pajisjeve pas vendosjes në treg, shërbim nga operatorët ekonomik.

SYNIMI VIII: RREGULLIMI DHE AVANCIMI I TREGUT TË SHËRBIMEVE POSTARE

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
1	Krijimi i ambientit të përshtatshëm ligjor dhe rregullator për ofrimin e Shërbimeve Postare në Republikën e Kosovës	Rregullore për Cross Border Parcel Delivery
		Rregullore për raportimin e të dhënave statistikore te ofruesve te shërbimeve postare
2	Pranimi dhe trajtimi i Aplikimeve për dhënien e Autorizimit të përgjithshëm	Pranimi i Aplikimeve,
		Mbështetja ne dizajn si dhe përdorimi i platformës së aplikimit ‘Online’ për dhënien e Autorizimit të Përgjithshëm
3	Monitorimi dhe mbikëqyrja e tregut të shërbimeve postare	Hartimi planit të inspektimit
		Inspektimi i Operatorëve postar

SYNIMI VIII: RREGULLIMI DHE AVANCIMI I TREGUT TË SHËRBIMEVE POSTARE

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
4	Publikimi i të dhënave statistikore mbi tregun e shërbimeve postare	Pranimi i Raporteve periodike tremujore Përpunimi i të dhënave statistikore të tregut të shërbimeve postare, dhe publikimi i raportit
5	Monitorimi i cilësisë së realizimit të shërbimeve universale postare,	Monitorimi i matjes së cilësisë së realizimit të shërbimeve postare,
6	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes operatoreve dhe trajtimi i ankesave të konsumatorëve të shërbimeve postare	Pranimi i ankesave dhe trajtimi i tyre, brenda afateve ligjore,

SYNIMI IX: AVANCIMI I MËTUTJESHËM I SHËRBIMEVE DHE MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË KONSUMATORËVE

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
1	Avancimi i mëtutjeshëm i kornizës rregullatore	Përgatitja dhe miratimi i Rregullores për shqyrtimin e ankesave të parapaguesve Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Kontratat, Transparencën dhe Publikimin e Informatave dhe masave tjera mbrojtëse për përdoruesit fundorë për ofrimin e rrjetave dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike
2	Avancimi i mbrojtjes së të drejtave të parapaguesve	Mbikëqyrja e kontratave të operatoreve për ofrimin e shërbimeve të Komunikimeve Elektronike dhe atyre Postare Shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve
3	Krijimi i aplikacionit për aplikime online	Implementimi i projektit për “Aplikimi online”, i cili ka për qëllim që tu mundësoj palëve që të aplikojnë online për resurse numerike, shërbime postare, shqyrtimin e ankesave, etj.

SYNIMI X: INTENSIFIKIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR, ANTARËSIMI NË INSTITUCIONE DHE SIGURIMI I KODEVE SHTETËRORE

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
1	Bashkëpunimi dhe Anëtarësimi në institucionet relevante ndërkombëtare	Përgatitja e kërkesave për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare për telekomunikacion dhe shërbime postare ITU, UPU, CEPT/ECC, ERG, ERGP, Pjesëmarrja aktive në kuadër të grupeve punuese/teknike të BEREC, ECC, ETSI, EUROIX, EFIS.
2	Zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare	Pjesëmarrja aktive në Grupin Teknik të Ekspertëve në nivel rajonal për mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes së Roamingut në mënyrë të Ballkanit perëndimor (WB6) Kordinimi i aktiviteteve lidhur me zbatimin e MoU të nënshkuara në me QeK dhe Shteteve tjera (SHBA, Ballkani Perëndimor, Shqipëria) lidhur me Rrjetet 5G.

SYNIMI X: INTENSIFIKIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR, ANTARËSIMI NË INSTITUCIONE DHE SIGURIMI I KODEVE SHTETËRORE

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
3	Bashkëpunimi dhe koordinimi në nivel ndërkombëtar për Radio frekuenca	Aktivitet për takime Bilaterale dhe Multilaterale për harmonizimin dhe rishikimin e Marrëveshjeve teknike për planifikimin dhe shfrytëzimin e radio- frekuencave në zonat kufitare për shërbimet IMT.

SYNIMI XI: MODERNIZIMI I MËTUTJESHËM I TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
1	Modernizimi i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit	Modernizimi i infrastrukturës së IT-së (server, storage dhe backup)
		Modernizimi i kapacitetit të rrjetës (switch, router dhe clearpass)
		Renovimi i server room-it në Autoritet dhe në Kos-IX (klimatizimi në server room, sistemi i kamerave dhe alarmeve ne Kos-ix)
		Implementimi i projektit – “Digit-ARKEP”
		Avancimi i shërbimeve të komunikimit pa tela (wLAN) brenda Autoritetit
		Shtimi dhe ridizajnimi i raporteve ekzistues dhe ndërtimi, analizimi i kërkesës për ndërtim të në platforme me të thjesht raportuese si pjesë e portalit SharePoint.
		Zhvillimi i një data baze për menaxhimin e pushimeve vjetore për stafin e ARKEP
2	Përditësimi i infrastruktures TIK	Përditësimi i Infrastrukturës së Softuer-it - Sistemet Operative : -Implementimi i sistemit për menaxhim System Center (Implementimi i System Center (Modulet relevante për system)
		Administrimi i procedurave të sigurisë së punës: - Planet e kthimit të sistemeve; - Procedurat e kthimit te sistemeve.
		Siguria punës së sistemeve Qendra e Rimekembjes (backup)

SYNIMI XII: BUXHETI PËR VITIN 2022

NR.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
1	Planifikimi i kërkesave buxhetore për vitet 2023-2025	Përgatitja e planit të rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2022,
		Përgatitja e pasqyrave financiare për vitin paraprak 2021 për Thesar dhe Kuvendi e Kosovës,
		Përgatitje e Dokumentit KASH 2023-2025,
		Përgatitja e Qarkoreve Buxhetore I,II
		Rishikimi i Buxhetit për periudhën gjashtë mujore 2022

SYNIMI XII: BUXHETI PËR VITIN 2022		
Nr.	OBJEKTIVI	AKTIVITETET
		Ekzekutimi i Buxhetit ne harmoni me Ligjin mbi financat Publike dhe rregulloreve financiare
2	Ekzekutimi i Buxhetit-Mbështetja financiare e të gjitha aktiviteteve të ARKEP ne realizimin e misionit.	Zotimi i mjeteve sipas kërkesave nga departamentet dhe njësit e kërkesave, Kryerja e të gjitha transaksioneve financiare, me transfer dhe para te gatshme me qellim te kryerjes se obligimeve ndaj furnitorëve me kohe; Përgatitja e raporteve periodike te shpenzimeve sipas kategorive ekonomike; Faturimi i të hyrave, Regjistrimi dhe barazimi me Banka komerciale dhe BQK,
3	Menaxhimi me pasurit e Autoriteti	Evidentimi kontabël i aseteve – pasurisë , Mirëmbajta dhe regjistrimi i pasurisë së ARKEP,

6. SFIDAT E ARKEP

Krahas sukseseve të arritura në implementimin e kornizës rregullatore, ARKEP edhe gjatë vitit 2021, është ballafaquar me sfida të shumta, ku nga më kryesoret janë:

Krahas sukseseve të arritura në implementimin e kornizës rregullatore, ARKEP edhe gjatë vitit 2021, është ballafaquar me sfida të shumta, ku nga më kryesoret janë:

- Pavarësia financiare dhe kapacitetet e ARKEP, referuar mungesës së pavarësisë financiare që po ndikon negativisht në nevojën urgjente për rekrutimin e stafit dhe eliminimit të diskrepancave dhe defekteve në strukturën organizative të ndikuar nga interpretimi i kufizuar i LMF-së, respektivisht procedurave dhe miratimit të buxhetit. Pavarësia financiare është kërkesë e vazhdueshme e Komisionit Evropian në raportet e progresit;
- Rritja dhe ruajtja e resurseve profesionale/nëpunësve të ARKEP, është një nga sfidat kryesore, me të cilën jemi ballafaquar që nga themelimi i institucionit, marrë parasysh këtu edhe nivelin e ndryshëm të pagave me sektorin, të cilin ARKEP e rregullon. Sipas statistikave të dhëna për gjithë rregullatorët e vendeve fqinje dhe të rajonit, ARKEP posedon numrin më të vogël të punëtorëve, duke përfshirë në veçanti stafin profesional që të nevojshëm arrijen e objektivave të Autoritetit. Po ashtu, marrë parasysh se është miratuar ligji i ri për Shërbimin Postar si dhe Ligji mbi masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, me çka janë rritur në masë të madhe përgjegjësitë e ARKEP, paraqitet nevojë urgjente për rritjen e stafit në sektorët relevantë.
- Anëtarësimi në organizatat relevante ndërkombëtare dhe sigurimi/marrja e kodeve shtetërore ccTLD, sipas ISO 3166;
- Zhvillimi i mëtutjeshëm i rrjeteve dhe shërbimeve brez gjëra të komunikimeve elektronike dhe arritja e objektivave të Agjendës Digjitale;
- Procesi i rritjes së konkurrencës në tregun e telefonisë mobile dhe hyrja e operatorëve të rinj në ofrimin e shërbimeve IMT dhe ofrimi i resurseve frekuencore për operatorë të rij duke u ofruar përdoruesve fundorë kualitet në ofrimin e shërbimeve mobile. Mundësitë e operatorëve ekzistues për marrjen e kapaciteteve frekuencore në breza ku zbatohet teknologjia 5G, si shkak i ndërlidhur me mundësitë e investimeve në pajisje për arritjen e kualitetit të shërbimeve mobile deri te përdoruesi fundor;
- Sfidë për ARKEP është zbatimi i memorandumit të mirëkuptimit me KPM, për lirimin sa më të shpejtë të brezit 700 MHz (694 - 790 MHz). Procesi është i ndërlidhur me digjitalizimin e TV transmetuesve Radio-difuzive dhe varet nga mundësitë e operatorëve dhe KPM për të zhvilluar procesin e lirimit të këtij brezi gjatë vitit 2022.
- Rritja e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;
- Avancimi i mëtutjeshëm i mbrojtjes së të drejtave të përdoruesve fundor (konsumatorëve);
- Implementimi i mekanizmave që garantojnë mbrojtje të konkurrencës;
- Rekrutimi i stafit të kualifikuar në fushat profesionale që bien në domenin e përgjegjësive të Autoritetit, me fokus të veçantë të njësia teknike KOS-CERT për shkak të pagave jo-konkurrense në treg që ofron Autoriteti;
- Procedurat e Prokurimit të cilat udhëhiqen nga AQP.

7. PASQYRA E PËRGJITHSHME E TREGUT TË SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Viti 2021 shënon trende pozitive të zhvillimit për sa i përket shfrytëzimit të komunikimeve elektronike. Ky trend pozitiv i referohet rritjes së investimeve në zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të rrjetave (*infrastrukturës telekomunikuese*) dhe ofrimin e shërbimeve të gjeneratave të reja përmes teknologjikeve mobile brezgjëra 3G & 4G.

Numri i operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve që janë autorizuar dhe regjistruar nga Autoriteti për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike në fund të vitit 2021 ishte dymbëdhjetë (12) me gjithsejtë njëzet e katër (24) aktivitete.

Në fund të vitit 2021, numri i përdoruesve të telefonisë mobile shënon shifrën prej; 1,777,859, që krahasuar me fundin e vitit 2020, është shënuar një rënie prej; 210,862, përdoruesish ose shprehur në përqindje paraqet një rënie prej; 10.6 %. Përkundër rënies së numrit të përdoruesve, tregu i telefonisë mobile ka shënuar rritje të trafikut të origjinuar nga rrjetet mobile prej; 6.3%, përkatësisht rritje me të theksuar në trafikun e terminuar prej; 28%, e cila kryesisht vjen si pasojë e rritjes përdorimit të shërbimeve në pako.

Telefonia fikse, përgjatë vitit 2021, ka treguar trend negativ për sa i përket numri të përdoruesve ku në fund të vitit ka shënuar; 72,833 shifrën prej; 76,371 përkatësisht; 3,538 përdoruesish më pak, në krahasim me vitin 2020.

Në vitin 2021 ka vazhduar rritja e kërkesës për shfrytëzimin e shërbimeve të internetit të ofruar në lokacion fikse, të cilës u janë përgjigjur pozitivisht operatorët duke zgjeruar aktivitetin e tyre. Si rezultat i kësaj, numri i përdoruesve të shërbimeve të internetit në fund të vitit 2021 ka arritur në; 383,868 , që shënon një rritje prej; 7,423, apo rritje prej; 2 %, në krahasim me vitin e kaluar

Qasja në internet përmes rrjetit mobil (*Mobile Broadband*) 3G dhe 4G vazhdimisht është duke u rritur, ky numër në fund të vitit 2021, ka arritur në; 1,442,058 përdorues aktivë, e që shënon një rritje në vlerën; 1,3 % krahasuar me vitin 2020.

Investimet e bëra nga operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike për vitin 2021 arrijnë vlerën afër 26.2 milion €, që shënon një rritje prej 65 % në krahasim me vitin e kaluar. Pjesën më të madhe të investimeve e përbëjnë investimet në infrastrukturën fikse prej; 58.1%, të cilat përdoren për ofrimin e shërbimeve telefonike fikse, qasje në internet dhe TV kabllor, pastaj investimet në segmentin e telefonisë mobile përbëjnë rreth: 41.9% të investimeve totale të tregut të komunikimeve elektronike.

Në tabelën në vijim janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur disa nga indikatorët kryesor të shërbimeve të komunikimeve elektronike për vitin 2021 si dhe krahasimet e këtyre indikatorëve me periudhën e mëhershme, gjegjësisht vitin 2020.

TABELA 18. INDIKATORËT KRYESOR TË TREGUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE 2020-2021

Nr.	Përshkrimi	2021	2020	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Numri i përdoruesve të telefonisë fikse	72,833	76,371	▼ 5%
1.2.	Penetrimi i telefonisë fikse (%)	4.01%	4.2%	
2	Numri i përdoruesve të telefonisë mobile në fund të vitit	1,777,859	1,988,721	▼ 10.60%
2.1.	Penetrimi i telefonisë mobile (%)	97.92%	109.5%	
3	Numri i përdoruesve të internetit në fund të viteve – qasja fikse	383,868	376,445	▲ 2 %
3.1.	Penetrimi i shërbimeve të internet-it (%)	21.14%	20.7%	
4	Numri i përdoruesve të internetit në fund të viteve- Qasja Mobile	1,442,058	1,423,010	▲ 1,3%
5	<u>Të hyrat (€)*</u>	143,427,252.12	117,020,565	▲ 22.56%
5.1.	Telefonia fikse	4,432,461.2€	4,729,426 €	▼ 6.27%
5.2.	Telefonia mobile	93,804,720 €	76,280,567 €	▲ 23.0%
5.3.	Linjat me qira	992,925 €	824,475€	▲ 20.4%
5.4.	Qasja në internet	44,983,005.07€	35186097€	▲ 27.8%
6	Investimet (€)	26,204,496€	15,884,498€	▲ 65 %

Në përgjithësi, viteve të fundit tregu është duke u bërë më efektiv, më eficient dhe efikas si rezultat i rritjes së vëllimit të trafikut, rritje të bashkë shfrytëzimit të infrastrukturës pasive dhe rënie të të ardhurave të përgjithshme nga komunikimet elektronike.

7.1. Pasqyra e të ardhurave nga shërbimet e komunikimeve elektronike

Të ardhurat nga shërbimet e komunikimeve elektronike për vitin 2021 arrijnë vlerën prej; 143.4 mil.€, që në krahasim me vitin 2020 , rezulton se kemi një rritje të konsiderueshme në vlerën prej; 22.6 %. Operatorët e telefonisë mobile dhe ofruesit e shërbimeve të internetit zotërojnë pjesën më të madhe të tregut të komunikimeve elektronike me rreth; 90% të të ardhurave. Vetëm të ardhurat e operatorëve mobilë përbëjnë rreth; 65% të të ardhurave të gjithë tregut, duke u percjellur nga ofruesit e shërbimeve të internetit me; 30%, ndërsa operatorët fiks zotërojnë rreth; 4%. Figura 23, në vijim e pasqyron një krahasim të qartë të strukturës së të ardhurave nga komunikimet elektronike në mes të viteve 2021 dhe 2020.

- Të hyrat për vitin 2021 nuk janë nga pasqyrat financiare por janë marrë nga raportet statistikore periodike të deklaruara nga operatorët .




FIGURA 22. SHPËRNDARJA E TË HYRAVE SIPAS VEPRIMTARISË

7.2. Investimet e bëra në rrjete dhe shërbime telekomunikuese

Investimet e bëra nga operatorët e shërbimeve telekomunikuese për vitin 2021 kapin shifrën prej 26.2 milionë €, që paraqet rritje të konsiderueshme të vëllimit të investimeve prej; 64.8% në krahasim me vitin e kaluar (2020), kur investimet ishin; 15.8 milionë €.

Në figurën 24 janë paraqitur investimet e ndara për segmente të tregut të komunikimeve elektronike. Siç shihet edhe nga figura, gjatë vitit 2021 pjesën më të madhe të investimeve e përbëjnë investimet në zgjerimin e infrastruktures për ofrimin e shërbimeve të telefonise fikse dhe të internetit.




FIGURA 23. INVESTIMET NË RRJETET DHE SHËRBIMET TELEKOMUNIKUESE

Edhe gjatë vitit 2021 operatorët kanë orientuar investime të konsiderueshme në ndërtim dhe modernizim të rrjetit si fiks ashtu edhe mobil, përkatësisht në rritjen e shtrirjes së rrjetit të qasjes në shërbimet brezgjëra përmes rrjeteve të gjeneratës së ardhme (*ang. Next Generatina Access- NGA*), kalimin në teknologjitë e reja DOCSIS, shtrirjen e fibrave optik në rrjetin e qasjes (*FTTH, FTTB*) me

topologji të ndryshme, varësisht nga kërkesa potenciale P2P dhe GPON, si dhe rritjen e mbulueshmërisë së shërbimeve mobile brezëgjera 3G dhe 4G, të cilat mundësojnë ofrimin e shërbimeve të reja dhe më cilësore për përdoruesit fundorë.

Kosova paraqet një situatë të veçantë, ku operatorët kabllorë kanë qenë tradicionalisht mjeti i preferuar i lidhjes për qasje në Internet, të gjithë operatorët ofrojnë shërbime të bazuara në infrastrukturën vetanake.

7.3. Telefonia Fikse

Shërbimet telefonike fikse në Kosovë ofrohen nga katër (4) operatorë të cilët ofrojnë shërbime bazuar në infrastrukturën vetanake.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga operatorët për vitin 2021, rezulton se numri i përdoruesve të telefonisë fikse gjendet në nivelin prej 72 mijë linja aktive, që paraqet rënie rreth 4.23% në raport me vitin 2020. Norma e penetrimit të telefonisë fikse është pothuajse e njëjtë me vitin e kaluar.

Tabela në vijim paraqet numrin e përdoruesve ndër vitet e fundit.

TABELA 19.4 NUMRI I PËRDORUESVE TE TELEFONISE FIKSE (2016 – 2021)

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Individual	34,082	44,292	37,568	33,923	28,860	25,699
Bizneset	18,929	19,524	22,470	21,902	47,195	47,134
Totali	53,011	63,816	60,038	55,825	76,055	72,833

Në figurën 25, është paraqitur ndarja e tregut ndërmjet operatorëve të rrjetit dhe ofruesve të shërbimeve telekomunikuese fikse, në bazë të parapaguesve.




FIGURA 24. NDARJA E TREGUT PËR VITET 2020-2021

7.3.1. Indikatorët e trafikut të telefonisë fikse

Në tabelën në vazhdim janë paraqitur indikatorët e tregut të telefonisë fikse.

TABELA 20. KRAHASIMI I INDIKATORËVE TË ORIGJIMIT TË TRAFIKUT TË TELEFONISË FIKSE (2020-2021)

Nr.	Përshkrimi	2021	2020	Ndryshimi 2021-2020 (%)
1	Totali i trafikut të origjinuar nga telefonia fikse	31,788,859	34,316,807	-7.36%
1.1	Origjinimi dhe terminimi i thirrjeve në rrjetin e vet (On net Calls)	11,573,514	13,377,920	-13.48%
1.2	Origjinimi i thirrjeve drejt rrjeteve të tjera të fikse calls)	434,108	478,264	-9.23%
1.3	Origjinimi i thirrjeve drejt rrjeteve mobile (Fixed to Mobile outgoing calls)	14,681,843	14,516,942	1.13%
1.4	Origjinimi i thirrjeve drejt rrjetit ndërkombëtare (International outgoing calls)	5,099,395	5,943,681	-14.20%

TABELA 21. KRAHASIMI E INDIKATORËVE TË TERMINIMIT TË TRAFIKUT TË TELEFONISË FIKSE (2020-2021)

Nr.	PËRSHKRIMI	2021	2020	NDRYSHIMI 2021-2020 (%)
1	Trafiku total i terminuar në rrjetet e telefonisë fikse	27,368,777.65	30,906,863	-11.44%
1.1	Terminimi i thirrjeve nga rrjetet tjera fikse (incoming off net calls)	220,680	520,836	-57.62%
1.2	Terminimi i thirrjeve nga rrjetet celulare (Mobile to Fixed incoming)	15,461,226.53	17,075,810	-9.45%
1.3	Terminimi i thirrjeve nga rrjetet ndërkombëtare (International incoming calls)	11,686,871	13,310,810	-12.20 %

7.4. Telefonia Mobile

Tregu i telefonise mobile në vitin 2021 ka shënuar rënie në numrin e përdoruesve ndërsa rritje në të hyra. Të hyrat totale nga shërbimet e komunikimeve mobile në vitin 2021 janë rritur në vlerën; 93 milionë €, një rritje prej prej; 21.9 % në krahasim me vitin 2020.




FIGURA 25. TË HYRAT NGA TELEFONIA MOBILE 2016-2021

Në fig. 27 në vijim, janë paraqitur të dhëna rreth numrit të përdoruesve të shërbimeve me zë, ku me kalimin e viteve, e posaçërisht viti 2021 tregon se është një numër i vogël që nuk përdorin shërbimet e internetit mobil nga numri i përgjithshëm nga numri i total i përdoruesve të telefonisë mobile.




FIGURA 26. PËRDORUESIT E SHËRBIMEVE MOBILE 2016 DERI NË 2021

Në figuren në vijim është paraqitur penetrimi i shërbimeve të telefonisë mobile dhe shërbimet e internetit në mobil- “MBB”.




FIGURA 27. PENETRIMI I SHERBIMEVE MOBILE 2016-2021

Nga të dhënat në tabelë vërejmë se përkundër rënies së penetrimit të telefonisë mobile, shërbimet MBB kanë treguar një rritje dinamike të qëndrueshme gjatë periudhës 2016-2021.

Në paraqitjen grafike të më poshtme janë dhënë detajet e ndarjes së tregut të operatorëve mobilë sipas përdoruesve për periudhën 2016 - 2021.




FIGURA 28. NDARJA E TREGUT TË TELEFONISË MOBILE SIPAS PËRDORUESVE 2016-2021

7.4.1. Tarifat

Operatorët e telefonisë mobile (MNO dhe MVNO) gjatë viti 2021 kanë vazhduar me plane të ndryshme tarifore për grupe të caktuara përdoruesish, të cilat përveç minutave të komunikimit për thirrjet on-net, off-net dhe SMS, në pako përfshijnë dhe shërbime të qasjes në internet 3G&4G.

Në qershor të vitit 2019 me vendim të ARKEP të gjithë operatorët mobilë kanë filluar implementimin e marrëveshjes së për uljen e tarifave të roamingut me Republikën e Shqipërisë si dhe atë me vendet e Ballkanit Perëndimor. Me këtë vendim tarifa standarde për shërbimet mobile në roaming janë ulur ndieshëm në krahasim me ato paraprake.

7.4.2. Tarifat e terminimit të telefonisë mobile

Sa i përket tarifave të terminimit të telefonisë mobile, përkatësisht terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale, aktualisht është në fuqi vendimet 1642 dhe 1643, dhe 1644 të Bordit drejtues të ARKEP, të datës datën 21/10/2020, me të cilat ka përcaktuar ndërmarrjet Telekom i Kosovës Sh.A, IPKO Telecommunications LLC dhe mts d.o.o si ofrues me fuqi të ndjeshme në tregun e terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale dhe ju ka vendos obligime për kontrollin e çmimeve. Si rezultat i analizës, Bordi ka vendosur që tarifat për MTR të ulen në mënyrë të përshkallëzuar, siç paraqitur në figurën 47, dhe të jenë sipas niveleve dhe afateve kohore. Pas zvogëlimit gradual në 3 faza, duke filluar nga 1 tertori 2020, në fazën e fundit, nga 1 janar 2022 e tutje tarifa e terminimit të telefonisë mobile është; 0.00846 €cent/min.

Në figurën 9, është paraqitur shkalla e zvogëlimit të MTR në Kosovë nga viti 2015 deri në janar 2022;




FIGURA 29. SHKALLA E ZVOGËLIMIT TË TARIFAVE TË TERMINIMIT TË THIRRJEVE MOBILE NË KOSOVË 2015-2022

Ky zvogëlim i MTR në Kosovë bënë të kuptojmë se kemi të bëjmë me një treg i cili prej ditës në ditë po lëvizë drejt pjekurisë dhe konkurrencës së shëndoshë, duke hapur rrugë paraqitjes së ofertave/produkteve të reja nga të cilat përfitues nuk janë vetëm operatorët por edhe konsumatorët fundorë.

7.4.3. Shërbimet mobile brez gjëra

Numri i përgjithshëm i përdoruesve aktivë të shërbimeve mobile brezgjërë ishte; 1.76 mil, duke rezultuar me një rritje prej; 23.5% në krahasim me vitin 2020. Penetrimi shërbimeve mobile brezgjërë (rrjetet 3G / 4G) në fund të vitit 2021 ka arritur në; 96.8% e popullsisë, ky tregues në vitin 2020 ishte; 79%. Kjo tregon për një nivel shumë të lartë të shërbimeve mobile brezgjërë në vendin tonë.




FIGURA 30. PËRDORUESIT E SHËRBIMEVE TE INTERNETIT MOBIL 3G DHE 4G, 2016 – 2021

Në figuren në vijim është paraqitur trafiku 'data' nga periudha 2016 deri 2021 në të cilën vërehet një rritje e konsiderueshme e këtij shërbimi. Kjo vjen si rezultat i rritjes së përdorimit të telefonave të mençur 'smartphone' nga konsumatorët dhe mbulueshmëria me rrejt 3G dhe 4G nga operatorët. Siç vërehet në figurë, është pesëfishuar trafiku i të dhënave.




FIGURA 31. TRAFIKU DATA 2016 - 2021

7.4.4. Mbulueshmëria e Rrjeteve Mobile

Aktualisht, sipas deklarimeve të operatorëve mbulueshmëria sa i përket shërbimeve të teknologjisë GSM ka arritur nivelin në rreth 100% të popullsisë në nivel vendi dhe rreth 94% sa i përket territorit.

Krahas teknologjisë GSM, me liberalizimin e brezit që nga viti 2013 operatorët në vazhdimësi kanë investuar në teknologji të njohura ndryshe si 3G&4G dhe rritjen e mbulueshmërisë për ofrimin e shërbimeve mobile brezgjëra në brezet 900 MHz dhe 1800MHz.




FIGURA 32. MBULUESHMËRIA E OPERATORËVE MOBIL

7.5. Qasja Brezgjerë në internet nga rrjeti fiks

Qasja në broadband internet ofrohet nga mbi pesëdhjetë (50) ndërmarrje të autorizuar, gjashtë (6) prej tyre kanë qasje të drejtpërdrejtë në daljet ndërkombëtare ‘International Gateway’, të cilat ofrojnë qasje në internet për ISP-të më të vogla, e që veprojnë në rajone të ndryshme të Kosovës.

Si në vitet tjera edhe gjatë vitit 2021, shërbimet brez-gjera ‘broadband’ të Internetit vazhdojnë të kenë rritje të numrit të përdoruesve.




FIGURA 33. NUMRI I PËRGJITHSHËM I PËRDORUESVE TË INTERNETIT 2015 – 2021

Sipas të dhënave zyrtare më të fundit të vitit 2021, të raportuara nga operatorët, penetrimi i qasjes në internet brezëgjere me bazë ekonomitë familjare është afërsisht; 129.23%. Bazuar në këto të dhëna, penetrimi i internetit në vitin 2021 për banorë rezulton të jetë rreth; 21.14%.

Në figurën në vijim është paraqitur ecuria e numrit të përdoruesve dhe penetrimi i shërbimeve brezgjera përmes rrejteve fikse.




FIGURA 34. PENETRIMI I SHËRBIMEVE TË INTERNETIT 2015 – 2020

Krahasuar me vendet rajonale, Kosova ka një rritje të te qendrueshem të penetrimit të shërbimeve brez-gjëra.

Në figuren e mposhtme është paraqitur shpërndarjen e përdoruesve të linjave brezgjere në internet në rrjetet fikse sipas shpejtësisë të përdorura për vitet 2020 dhe 2021. Viteve të fundit ka pasur një rritje të të përdoruesve në shfrytëzimin e linjave me kapacitet më të shpejt. Në vitin 2021, mbi 44 % të përdoruesve përdorin linja me shpejtësi mbi 100 Mbps në krahasim me 30% sa ishte më 2020.

Në anën tjetër është zvogëluar përdorimi i linjave m shpejtësi deri në 40 Mbps, nga 51% (2020) në 29%, më 2021.




FIGURA 35. SHPËRNDARJA E PERDORUESVE TE QASJES BREZGJERE FIKS SIPAS SHPEJTËSISË 2020 – 2021

7.5.1. Ndarja e tregut

Për dallim nga shtetet tjera rajonale dhe të BE-së, shumica e tregut të internetit në Kosovë zotërohet nga operatorët alternativë. Në figurat e mëposhtme, është paraqitur ndarja e tregut për vitet 2016-2021.




FIGURA 36. NDARJA E TREGUT TË SHËRBIMEVE TË INTERNETIT FIKS SIPAS PËRDORUESVE 2016-2021

Në vitin 2021, IPKO zotëron rreth; 28%, Telekom i Kosovës zotëron rreth; 7%, Kujtesa.NET; 18%, Artmotion; 26%, AE Holding; 4%, ndërsa pjesa tjetër rreth; 17% e përbëjnë ISP lokal.

7.5.2. Teknologjitë e përdorura

Teknologjia kryesore për ofrimin e qasjes në internet në rrjete fikse edhe gjatë vitit 2021 është përmes modemit kabllor e cila vazhdo të dominojë në treg me rreth 77% e pasuar nga teknologjia FTTX e cila ka shënuar një rritje të ndieshme prej 3 p.p. në krahasim me vitin 2020, gjersa qasja përmes teknologjisë xDSL ka rënë në 6%.

Teknologjia pa tela 'wireless' kryesisht përdoret në zonat të thella rurale, ku shfrytëzohen brezet e pa-liçensuara frekuencore 2.5 GHz dhe 5 GHz.




FIGURA 37. SHPËRNDARJA E LINJAVE TE INTERNETIT SIPAS TEKNOLOGJISË SE RRJETIT TE QASJES

Nga të dhënat në figurë vërehet se një numër i konsiderueshëm i lidhjeve brez-gjera u ofrohet përdoruesve nga operatorët përmes kombinimit të kabllor koaksiale apo linjë bakri. Një ndryshim cilësor vërehet në trendin e rritjes së ofrimit të shërbimeve të qasjes në internet përmes fibrës optike FTTH duke përdorur teknologjinë GPON.

Si ofrues kryesor të internetit përmes kabllor koaksiale janë; IPKO dhe KujtesaNET dhe ARTmotion ndërsa operator të cilët ofronjnë qasjen në internet për përdoruesit fundor kryesisht përmes teknologjisë xDSL është Telekom i Kosovës dhe operatori mts d.o.o.

Gjatë vitit 2021 kanë vazhduar ndryshimet cilësore në ofrimin e qasjes brez-gjerë në Internet, ku pjesa dërmuese e operatorëve kanë vazhduar rritjen kapacitetit të ofrimit të qasjes në internet.

8. PASQYRA E PËRGJITHSHME E TREGUT TË SHËRBIMEVE POSTARE

Në bazë të të dhënave të përpunuara nga Autoriteti, në vitin 2021, kemi patur në total; 3,981.076, dërgesa. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, që kishte rreth; 3,957,898 dërgesa, rezulton se kemi një rritje të lehtë të numrit të përgjithshëm të volumit të dërgesave postare në vlerën; 0.59 %, përderisa 'Posta Kosovës' SHA, ka një rritje të volumit të dërgesave postare në vlerën; 1.92 %, ndërsa operatorët privat kanë një rënie në vlerën; 2.16 %. 'Posta Kosovës' SHA, si operator publik postar mbulon tregun e përgjithshëm të shërbimeve postare me; 68.20 %, kurse operatorët privat janë të përfaqësuar në vlerën; 31.80 %, të tregut të përgjithshëm.

Ndërsa indikatorët e tregut të shërbimeve postare në vitin 2021, krahasuar me vitin 2019, tregojnë po ashtu një rënie të volumit të përgjithshëm të dërgesave postare në vlerën; 2.96%. Nga numri i përgjithshëm i dërgesave postare, rreth; 71.94 %, janë letër dërgesa postare, ndërsa rreth 28.06 % janë dërgesa të pako/kolipostës ose pako postare. Nga numri i përgjithshëm i dërgesave rreth; 82.25 % e dërgesave postare janë të pranuar dhe shpërndara në trafikun e brendshëm, pra janë postë vendore, ndërsa rreth 17.25 % janë postë ndërkombëtare, pra dërgesa që janë dërguar dhe janë pranuar nga trafiku ndërkombëtar.

Sipas të dhënave të pranuar nga operatorët postar, tregu i shërbimeve postare në Republikën e Kosovës, vërehet se edhe gjatë vitit 2021, krahasuar me vitin 2020, regjistrojnë një rritje të numrit të letër dërgesave postare, ndërsa kemi rënie të numrit të pako – kolive postare'.

Trendi i lëvizjes së volumit të Letërdërgesave dhe Pakove 2019- 2021




FIGURA 38. TRENDI I LËVIZJES SË VOLUMIT TË DËRGESAVE POSTARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, 2019 - 2021

Nga figurat më lartë, vërejmë se edhe në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, rritja e volumit të letër dërgesave postare ishte në vlerën; 3.64 %, ndërsa ka patur një rënie të numrit të dërgesave të pako – kolive postare në vlerën; 6.95 %.

Po ashtu indeksi i lëvizjes së volumit të letër dërgesave postare dhe pako – kolive postare, nga viti 2019 deri 2021, paraqet qartë rritje e volumit të letër dërgesave postare në vlerën; 2.81%, dhe rënie të volumit të pako – kolive postare, në vlerën; 0.08 %, e numrit të përgjithshëm të dërgesave.




FIGURA 39. INDEKSI I LËVIZJES SË VOLUMIT TË DËRGESAVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, 2019 - 2021

8.1 Regjistri i ofruesve të shërbimeve postare

Sipas legjislacionit aktual, Autoriteti, është institucioni i vetëm i autorizuar të lëshoj dhe tërheqë autorizimet, të gjithë atyre të cilët dëshirojnë të ofrojnë shërbime postare në Republikën e Kosovës.

Autoriteti, mbanë dhe azhurnon regjistrin e operatorëve postar të autorizuar për ofrimin e shërbimeve postare, ndërsa deri në fund të viti 2021, në regjistrin e operatorëve të regjistruara, janë të evidentuar gjithsejtë dyzet e gjashtë (46) operatorë postar, të cilët janë aktiv dhe ofrojnë shërbime postar, shih linkun <http://arkep-rks.org/?cid=1,158> :

8.2 Ndarja e tregut të shërbimeve postare,


Numri i përgjithshëm i dërgesave postare të pranuar dhe shpërndarë nga operatorët postar, në vitin 2021, në total është; 3,981,076 , dërgesa postare, prej të cilave 'Posta e Kosovës' SHA, ka pranuar dhe shpërndarë gjithsejtë; 2,714,979, dërgesa postare, ndërsa operatorët privat kanë pranuar dhe shpërndarë gjithsejtë; 1,266,097 , dërgesa postar.

TABELA 22. NUMRI I DËRGESAVE POSTARE NDARË SIPAS OPERATORËVE DHE TRAFIKUT TË DESTINIMIT, 2021

Ndërmarrja/Subjekti		Postë Vendore	Postë Ndërkombëtare	Total
1	Posta e Kosovës SHA	2,195,500	519,479	2,714,979
2	Operatorët Privat	1,079,073	187,024	1,266,097
Totali 2021		3,274,573	706,503	3,981,076

Nga numri i përgjithshëm i dërgesave postare, dërgesat postare që kanë pasur për destinim, përkatësisht janë pranuar dhe shpërndarë në trafikun e brendshëm, postë vendore në total është; 3,274,573, dërgesa postare, ndërsa numri i dërgesave postare të cilat janë dërguar ose janë pranuar nga trafiku ndërkombëtar, në total është; 706,503, dërgesa postare.

Ndarja e tregut sipas volumit të dërgesave 2021



Ndarja sipas llojit të dërgesave 2021




FIGURA 40. NDARJA E TREGUT SIPAS VOLUMIT DHE LLOJI TË DËRGESAVE, 2021

Nga figura më lartë vërejmë se në vitin 2021, 'Posta e Kosovës' SHA, si operator publik postar në Republikën e Kosovës, ka patur një mbulueshmëri të tregut të përgjithshëm të shërbimeve postare në vlerën; 68.20%, ndërsa operatorët privat kanë patur një mbulueshmëri të tregut të shërbimeve postare në vlerën; 31.80 %.

Shikuar sipas llojit të dërgesave postare, rreth; 72.36 %, e dërgesave postare janë letërdërgesa postare, pra dërgesa të korrespondencës (siç janë dërgesat e thjeshta postare dhe me shërbime të veçanta), përkatësisht rreth; 27.64 %, janë pako postare – kolipostë.

Ndarja e tregut sipas volumit të dërgesave viti 2021




FIGURA 41. NDARJA E TREGUT SIPAS VOLUMIT TË DËRGESAVE DHE OPERATORËVE, 2021

Operatori publik postar 'Posta e Kosovës' SHA, i cili gjatë vitit 2020, ka dominuar tregun e përgjithshëm të shërbimeve postare në vlerën; 67.39 %, gjatë vitit 2021, ka një dominim në treg dhe atë në vlerën; 68.20 %, pra vërehet se ka një rritje të vogël të prezencës dhe dominimit në treg në vlerën; 0.81 %.




FIGURA 42. NDARJA E TREGUT SIPAS %, PK SHA DHE OPERATORËT PRIVAT, 2019 – 2021




FIGURA 43. NDARJA E TREGUT POSTË VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE, 2021

Figurat më lartë pasqyrojnë të dhënat e ndarjes së tregut të dërgesave krahasimi për postën vendore dhe postën ndërkombëtare. 'Posta e Kosovës' SHA., zotëron një treg prej; 67.05 %, të tregut të dërgesave të postë vendore, ndërsa operatorët privat kanë patur një treg rreth; 32.95 %, të postës vendore. Ndërsa në trafikun ndërkombëtar vërehet gjithashtu se 'Posta e Kosovës' SHA, ka zotëruar një treg prej; 74 %, përderisa operatorët privat kanë zotëruar një treg në vlerën; 26 %, të dërgesave postare, pra trafikut ndërkombëtar në shkuarje dhe ardhje.




FIGURA 44. NDARJA E TREGUT OPERATORËT PRIVAT, 2021

Për sa i përket konkurrencës vetëm tek operatorët privat, ndarjes së tregut vetëm tek operatorët privat, vërehet se '3P' SHPK, ka një dominim në tregun postar në vlerën; 16.90 %, e ndjekur nga 'Postman SHPK, me; 15.25 %, 'Express Posta' LLC me; 15.14 %, dhe 'Speed Posta' SHPK me; 13.93 %, kurse të gjithë operatorët tjerë janë në vlerën; 38.78 %.

8.3 Të hyrat e sektorit postar

Sipas të dhënave zyrtare të raportuara nga operatorët postar, Autoriteti ka arritur të regjistroj të hyrat në sektorin e shërbimit postar për vitin 2021, ku në total është evidentuar një qarkullim dhe bilanc i të hyrave të përgjithshme vjetore në vlerën prej; 10,559,570.04 Euro.

Krahasuar me të dhënat zyrtare të raportuara për vitin 2020 (Ref. 'Raporti i ARKEP-it, për vitin 2020, dërguar Kuvendit të Republikës së Kosovës'), ku totali i të hyrave të përgjithshme të sektorit postar ishin në vlerën; 7,645,437 Euro, vërehet se sektori i shërbimit postar në vitin 2021, ka pasur një rritje të të hyrave të përgjithshme nga ofrimi i shërbimeve postare, në vlerën; 27.60 %.




FIGURA 45. LËVIZJA E TË HYRAVE NË SEKTORIN POSTAR, 2019 - 2021

Gjatë vitit 2021, nga hyrat e përgjithshme të realizuara në tregun e shërbimeve postare, 'Posta e Kosovës' SHA., ka realizuar rreth; 25.04 %, të të hyrave në sektorin e shërbimeve postar, ndërsa operatorët privat kanë realizuar të hyra në vlerën rreth; 74.96 %, të të hyrave në sektorin postar.




FIGURA 41. NDARJA E TREGUT SIPAS TË HYRAVE, 'PK' SHA DHE OPERATORËT PRIVAT, 2021




FIGURA 47. NDARJA E TREGUT SIPAS TË HYRAVE, 'PK' SHA DHE OPERATORËT PRIVAT, 2019-2021

Në figurën më lartë është paraqitur ndarja e tregut sipas të hyrave nga shërbimet postare, nga viti 2019– 2021, ku gjatë viteve të fundit vërehet se operatorët privat kanë krijuar rritje të theksuar në të hyrat. Ne konsiderojmë se rritja e të hyrave të operatorëve privat ka të bëjë jo vetëm me tarifat më të larta që kanë, por edhe me rritjen e kërkesave të bizneseve për shitjen e produkteve 'Online', ku operatorët privat kanë krijuar një dominojnë në këtë sferë. Edhe për kundër infrastrukturës që ka 'Posta e Kosovës' SHA, nuk ka arritur të shfrytëzoj avantazhin e saj infrastrukturor dhe njerëzor për të rritur qasjen dhe joshjen e bizneseve për të ju ofruar shërbimin e bartjes dhe transportit të produkteve të cilat bizneset i shesin përmes internetit.

8.4 Të dhënat mbi resurset njerëzore dhe infrastrukturën

Nga të dhënat e pranuar rezultojnë se në sektorin postar të angazhuar në ofrimin e shërbimeve postare janë gjithsejtë rreth 1433, persona. Në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, kemi një rritje në vlerën; 4.68 %.

Ndarja e Sektorit Postar sipas të punësuarve viti 2021




FIGURA 48. NDARJA E SEKTORIN POSTAR' SIPAS NUMRIT TE PUNËSUARVE, 2021

Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve 'Posta e Kosovës' SHA, ka numrin më të madh të punësuarve me rreth; 938, punëtorë – zyrtar, dhe dominon në vlerë; 65.46 %, të punësuarve në sektorin postar, ndërsa në sektorin privat, operatorët privat kanë gjithsejtë rreth; 495, të punësuar, përkatësisht me rreth; 34.54 %, të numrit të përgjithshëm të punësuarve në sektor.

Infrastruktura dhe rrjeti postar është i një rëndësi të veçantë në funksionimin e ofrimit të shërbimeve postare, ofrimit sa më cilësor të shërbimeve postare. Prandaj nevoja për krijimin e një infrastrukture sa më të mirë dhe moderne është më se e nevojshme për të krijuar një sistem sa më efikas të funksionimit të ofrimit të shërbimeve postare në sektorin postar, qasje të lehtë në pikat e qasjes të rrjetit, me këtë qasje edhe në shërbimet postare.

'Posta e Kosovës' SHA, aktivitetin e saj postar e zhvillon duke u mbështetur në infrastrukturën dhe rrjetin e saj postar në: 130 zyra – pika postare aktive (sepse 41 sosh i kemi jo-aktive meqë janë të mbyllura/uzurpuara) të organizuara në shtatë (7) regjione, nga të cilat 97 zyra – pika postare gjenden në zona urbane – qytete, ndërsa 33 zyra/pika në zona rurale – fshatra, me gjithsejtë: 293 sportele (të gjithat të automatizuara), dhe 560 kuti postare të vendosura në hyrje të zyrave – pikave postare dhe vende të ndryshme publike (Ref: Raporti i PK SHA - TM4 2021). Po ashtu 'Posta e Kosovës' SHA, në kuadër të zyrave postare, pikave të saj posedon edhe rreth; 2901 Kutitë – Fahë Postare (PO Boxes) në tërë rrjetin e saj. Në kuadër të këtij rrjeti, funksionon edhe 'Qendra Transite Postare' (QTP) e cila bënë përpunimin, sortimin dhe bartjen – transportin (shkëmbimin) e dërgesave postare për trafikun e brendshëm – posta vendore dhe trafikun ndërkombëtar.

Ndërsa, operatorët privat postar, aktivitetin dhe veprimtarin e tyre postare e kanë të shtrirë kryesisht në Prishtinë, dhe kanë numër më të vogël të zyrave – pikave postare, përkatësisht rreth; 20, pika të ndryshme, të cilat janë me nga një sportel të pranimit të dërgesave postare, ndërsa disa prej tyre aktivitetin e tyre e zhvillojnë edhe në disa nga qytetet kryesore të vendit përmes agjentëve të tyre postar të cilët janë të njohur për Autoritetin.

9. RAPORTI FINANCIAR

Autoriteti financohet nga Buxheti i Kosovës përmes të hyrave të Autoritetit, në pajtim me Ligjin për Komunikimet Elektronike, Kreu XII, neni 83, përkatësisht nga pagesat lidhur me veprimtarinë e Autoritetit si;

- pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare;
- pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave;
- Pagesat për caktimin e numrave dhe serive numerike;
- Pagesat nga sanksionet ekonomike; dhe
- Çdo pagesë tjetër të paraparë me aktet e aplikueshme (*tarifat rregullative*) që mblidhen nga operatorët e licencuar që operojnë në sektorin e komunikimeve elektronike dhe postare.

9.1. Të hyrat

Të gjitha të hyrat e mbledhura nga Autoritetit janë krijuar në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjit për Komunikime Elektronike, Ligjit për Shërbime Postare dhe Rregulloreve financiare në fuqi depozitohen në llogarinë zyrtare të Autoritetit të krijuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit në BQK.

Gjatë vitit 2021, Autoriteti ka planifikuar të hyra në vlerë; **6,574,282.95 Euro**, ndërsa shuma e të hyrave të realizuar është: **6,359,513.96 Euro**, apo shprehur në përqindje rreth; **96.73 %**, në raportin me planifikimin final të cilat janë prezantuar sipas tabelës në vijim:

TABELA 23. RAPORTI I TË HYRAVE – 2021

	Të hyrat	Planifikimi	Realizimi	%
1	Pagesa Vjetore për Mbikëqyrjen e Tregut të Komunikimeve elektronike	600,000.00 €	329,438.11 €	54.91
2	Pagesta Vjetore për caktim/shfrytëzim të Radio Frekuencave	2,176,000.00 €	1,561,272.07 €	71.75
3	Pagesa Vjetore për caktim/shfrytëzim të Numeracionit	255,000.00 €	311,347.50 €	122.10
4	Pagesa Vjetore për Mbikëqyrjen e Tregut të shërbimeve Postare	37,000.00 €	55,332.79 €	149.55
5	Gjitha Pagesat Tjera (Taxat Administrative, gjobat, qendra KOSIX, radio amatorët etj)	12,000.00 €	44,371.12 €	369.76
6	Pagesë e njëhershme për Autorizime Individuale (one of fee)	3,494,282.95 €	4,057,752.37 €	116.13
	Totali	6,574,282.95 €	6,359,513.96 €	96.73

9.2. Realizimi i Buxhetit

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me Ligjin Nr;07/L-041, për Ndarjet Buxhetore për vitin 2021, ka miratuar buxhetin e Autoritetit në lartësi prej; **1,308,092.00 Euro**, i ndarë në kategoritë kryesore ekonomike si në tabelën e paraqitur si në vijim;

TABELA 24. BUXHETI I AUTORITETIT I APROVUAR NGA KUVENDI

PËRSHKRIMI	BUXHETI
Paga dhe mëditje	445,843 €
Mallra dhe shërbime	347,549 €
Shpenzime komunale	14,700 €
Shpenzime kapitale	500,000 €

Buxheti i ARKEP ka pësuar ndryshime konform procedurave të rregullta Ligjore:

1. Vendimi i Qeverisë Nr. 10/46 i datës 30.11.2021;
2. Vendimi i Qeverisë Nr. 02/48 I datës 15.12.2021;
3. Vendimi i Qeverisë Nr. 21/50 I datës 23.12.2021;
4. Vendimi i Qeverisë Nr. 11/52 I datës 29.12.2021 .

me çka edhe buxheti final i alokuar brenda sistemit SIMFK ishte në lartësi prej; 735,450.69 Euro, i ndarë sipas kategorive paraqitet si në vijim;

TABELA 25. BUXHETI FINAL NË SIMFK

PËRSHKRIMI	BUXHETI
Paga dhe mëditje	391,053.35 €
Mallra dhe shërbime	257,354 €
Shpenzime komunale	14,700 €
Shpenzime kapitale	72,343.34 €

Ndryshimet e buxhetit brenda vitit fiskal dhe realizimi i buxhetit final në masë prej; 694,053.17 €, apo shprehur në përqindje prej; 97.37 %, është treguesi dhe indikatori më i mirë për nevojën e konsolidimit të procedurave për jetësimin e pavarësisë financiare dhe operacionale të Autoritetit.

Fakti i pa mohueshem në shkallen e realizimit të buxhetit është shfaqja e pandemisë COVID-19, gjë që ka ndikur në masë të madhe në mos mundësin e realizimit të shumë aktiviteteve.

Po ashtu heqja e të drejtës për zhvillimin e procedurave të prokurimit i përcaktuar përmes Ligjit të prokurimit ka ndikur në mase të madhe në realizimin e buxhetit përfshi edhe implementimin e projekteve kapitale.

TABELA 26. REALIZIMI I BUXHETIT SIPAS KATERIGOVE EKONOMIKE

PËRSHKRIMI	REALIZIMI €
Paga dhe mëditje	391,053.35
Mallra dhe shërbime	226,628.67
Shpenzime komunale	13,750.81
Shpenzime kapitale	62,620.34

10. ADRESIMI I GJETJEVE TË AUDITORIT NGA VITI PARAPRAK

ARKEP me datë; 17.06.2022 ka pranuar Raportin e Auditimit për vitin 2021, nga Zyra Kombetare e Auditimit, me Nr.Prot; 248/2/22. Opinioni i dhënë në raport është si në vijim;

Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit - 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore.

Gjetjet dhe rekomandimet

Përmes raportit Auditori ka theksuar se nevojiten përmirësime sa i përket regjistrimit të pasurive dhe pranimit të tyre nga komisioni përkatës, të cilat janë paraqitur më poshtë në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ky raport ka rezultuar me dy rekomandime:

Çështja A1 – Pranimi i pajisjeve pa komision të pranimit.

Çështja A2 – Mos regjistrimi i pasurive në sistemin e-pasuria.

ARKEP ka përgaditur planin e implemetimit për permbushje të rekomandimeve dhe në bashkëpunim edhe Institucionet përgjegjëse do të përmbushë me sukses regjistrimin e pasurive në sistemin e-pasuria, sistem i cili menaxhohet nga ASHI.

Për me shumë informata referojuni Raportit të Auditimit të vitit 2021, gjegjësishtë faqes nr. 7 dhe 8.

11. LLOGARIDHËNIA E ARKEP

11.1 Sigurimi i integritetit

Bordi i Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, përmes kësaj deklaratë siguron Kuvendin e Republikës së Kosovës, tek i cili Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare raporton, se informacionet e paraqitura në Raportin Vjetor të Punës për vitin 2021, përfshi këtu Pasqyrat Financiare, janë të sakta, të besueshme dhe objektive si dhe lehtësisht të verifikueshme.

11.2 Deklarata për Transparencë

Me këtë ne ju sigurojmë se veprimtaria e Autoritetit gjatë vitit 2021, është zhvilluar në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjeve burimore, politikave të sektorëve që i rregullon dhe mbikëqyrë Autoriteti, kornizës së akteve rregullatore (legjislacionit sekondar) dhe Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*Ref. Nr. Prot. 054/B/17*).

LISTA E AKRONIMEVE

ADSL	Teknologjia e linjave dixhitale asimetrike ('Asymmetric digital subscriber line')
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
ARPU	Të hyrat mesatare për përdorues ('Average Revenue per User')
BWA	Qasja pa tela brezgjërë përmes internetit ('Broadband Wireless Access')
Brezet GSM/DCS	Brezet frekuencore për operimin e telefonisë mobile GSM në brezet 900 MHz dhe 1800 MHz
BTS	Stacioni Bazë Transmetues ('Base Transceiver Station')
ccTLD	Kodi shtetëror i Internetit - domeni i nivelit më të lartë ('Country code top-level domain')
DKE	Departamenti për Komunikime Elektronike, ARKEP
DMF	Departamenti për Menaxhimin e Frekuencave, ARKEP
EDGE	Teknologjia e telefonisë mobile që mundëson transmetim të përmirësuar të të dhënave të GPRS ('Enhanced Data rates for GSM Evolution (EDGE)')
FTR	Tarifat e terminimit të telefonisë fikse ('Fixed Termination Rates')
FWA	Teknologjia që lidh dy lokacione përmes pajisjeve ose sistemeve pa-tela ('Fixed Wireless Access')
GPRS	Teknologjia e paketave dhe shërbimeve të dhënave të gjeneratave 2G dhe 3G ('General Packet Radio Service')
gTLD	Kodi gjenerik i i nivelit më të lartë të Internetit ('Generic top-level domain')
IANA	Autoriteti brenda ICANN për ndarjen e numrave për ndarjen e numrave të Internetit ('Internet Assigned Numbers Authority')
ICANN	Korporata ndërkombëtare për ndarjen e emrave dhe numrave ('Internet Corporation for Assigned Names and Numbers')
ISP	Ofrues i Shërbimeve të Internetit (Internet Service Provider)
ITU	Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve ('International Telecommunication Union')
KE	Komunikime Elektronike
KOS-IX	Nyja Shkëmbyese e Internetit të Kosovës ('Kosovo Internet Exchange Point')
LKE	Ligji për Komunikime Elektronike Nr. 04/L/109
LSHP	Ligji për Shërbimet Postare Nr. 03/L-173
LTE / 4G	Teknologjia e gjeneratës së katërtë të telefonisë mobile për komunikime të shpejta pa tela 4G ('Long-Term Evolution')
LLU	Bashkëshfrytëzim i Plotë dhe i Përbashkët i Lakut Lokal ('Local Loop Unbundling')
MMS	Shërbim multimedial me porosi ('Multimedia Messaging Service')
MNO	Operatori mobil i rrjetës ('Mobile Network Operator')
MTR	Tarifat e terminimit të telefonisë mobile ('Mobile Termination Rates')
MVNO	Operatori virtual mobil i rrjetës ('Mobile Virtual Network Operator')
NGN	Gjeneratat e reja të rrjetave ('Next Generation Network')
NP	Bartshmëria apo Portabiliteti i Numrave ('Number Portability')
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik ('Organisation for Economic Co-operation and Development')
SMP	Operator me Fuqi të Ndjeshme në Treg – OFNT (ang. 'Significant Market Power')

PMR	Shërbimet radio të lëvizshme profesionale (<i>'Professional Mobile Radio'</i>)
'Post-paid'	Përdorues me kontratë
'Pre-paid'	Përdorues me parapagim
PTP	Shërbimet fikse mikro-valore Pikë në Pikë (<i>'Point-to-Point'</i>)
PVPE	Plani për Veprim dhe Partneritet Evropian
QoS	Kualiteti i Shërbimit (<i>'Quality of Service'</i>)
R&TTE	Pajisjet terminale apo fundore të radio dhe telekomunikimeve (<i>'Radio and Telecommunications Terminal Equipment'</i>)
SMS	Shërbim i porosisë së shkurtër (<i>'Short Message Service'</i>)
TAIEX	Instrumenti për Asistencë Teknike dhe Shkëmbim të Informacioneve të Komisionit Evropian (<i>'Technical Assistance and Information Exchange instrument'</i>)
Tarifat 'off-net'	Tarifat në drejtim të rrjeteve tjera fikse ose mobile
Tarifat 'on-net'	Tarifat brenda rrjetit
TETRA	Kontrollin dhe monitorimin e brezeve frekuencore për shërbime të aeronautikës dhe shërbimeve (<i>'Terrestrial Trunked Radio'</i>)
TSMQ	Pajisja për matjen e kualitetit të shërbimeve të telefonisë mobile (<i>'Drive test Tool'</i>)
UMTS / 3G	Teknologjia e gjeneratës së tretë të telefonisë mobile 3G (<i>'Universal Mobile Telecommunications System'</i>)
USO	Obligimet për Shërbimet Universale (<i>'Universal Service Obligation'</i>)
VAS shërbime	Ofruesit e Shërbimeve me Vlerë të Shtuar (<i>'Value Added Service'</i>)
VOIP	Teknologjia për transmetimin e komunikimeve me zë përmes protokolleve të Internetit <i>'Voice over IP'</i>
Web GIS	Sistemi Gjeografik Informativ përmes Ueb-it
Operator	Një ndërmarrje që është e autorizuar të ofrojë shërbime të rrjetave publike telekomunikuese
Thirrje	Një linjë e vendosur me qëllim të realizimit të komunikimit dy-drejtimësh duke shfrytëzuar rrjetin publik komutues telefonik në kohë reale
Linjat me qira	Fasilitetet telekomunikuese të cilat mundësojnë transmetim transparent të kapaciteteve në mes pikave terminuese të rrjetave dhe të cilat nuk përfshijnë komutim sipas kërkesës (funksione komutuese të cilat përdoruesit mund t'i kontrollojnë si pjesë të dispozitave të linjave me qira).

AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ARKEP – 2021